

DOSJA E DËNIMIT
DHE RISHIKIMI

DEPU- TETËT *volehje*

10 TETOR 2017

70-VJETORI I EKZEKUTIMIT
TË DEPUTETËVE OPOZITARË

DEPU- TETËT



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

**“DEPUTETËT
PËR
DEPUTETËT”**

**10 TETOR 2017
70-vjetori i ekzekutimit
të deputetëve opozitarë**

PARATHËNIE

Botimi i akteve të aktivitetit të organizuar nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, në nderim të grupit të deputetëve të pushkatuar nga regjimi komunist, është një akt mirënjohje e thellë nga ana e Kuvendit të Shqipërisë në nderim të veprës së tyre, të cilët kërkuan demokracinë dhe si përgjigje morën ekzekutimet dhe dënimet. Kujtimi i kësaj ngjarjeje le të shërbejë si një thirrje për të reflektuar mbi përgjegjësinë tonë, si përfaqësues të popullit, se liria dhe demokracia duhet të jenë preokupimi ynë i përditshëm.

Se diversiteti i ideve dhe pikëpamjeve nuk duhet të jenë sinjale ndarjeje dhe armiqësie, por faktorë të fuqishëm në funksion të ndërtimit të shtetit të së drejtës. Ishte një kohë që diversiteti dhe opozicioni shikoheshin si tradhëti dhe dënoheshin me vdekje. Na takon ne që t'i rikthehemi atyre idealeve demokratike, për të cilat luftuan ata deputetë, të cilët ne po i nderojmë dhe po i kujtojmë sot.

Ne duhet të punojmë në krijimin e kushteve sa më të mira për dëgjimin e tjetrit dhe formimin e një qytetari të përgjegjshëm dhe të aftë për refleksion personal dhe analizë kritike të njerëzve dhe të ngjarjeve, me qëllim që të realizojmë “të jetuarit së bashku” në kontekste komplekse, të ndryshueshme dhe zhvillimeve të paparashikuara.

Ne duhet ta bëjmë kujtesën dhe historinë një instrument

të formimit të qytetarit në shoqërinë demokratike duke angazhuar shkollën, institucionet kërkimore dhe mjetet e komunikimit masiv. Ne duhet t'i mësojmë gjeneratave të reja të vërtetën e të kaluarës tonë të afërt, me qëllim që ajo të mos përsëritet.

Ne duhet të inkurajojmë kooperimin ndërdisiplinar brenda shkollës ndërmjet mësimit të historisë, letërsisë, filozofisë, gjuhës, shkencave sociale dhe ekonomike në mënyrë të tillë, që ato të kontribuojnë në edukimin e qytetarit të shoqërisë demokratike.

Ne duhet të punojmë që rezolutat e Këshillit të Europës rreth dënimit të krimeve të regjimit totalitar komunist, rreth mësimdhënies së historisë, të marrin formë konkrete në sistemin e ri demokratik. Për këtë ne duhet ta nxitim qeverinë për të siguruar një financim të vazhdueshëm dhe të mjaftueshëm, për kërkime në fushën e kujtesës dhe të historisë, që synojnë jo vetëm nxënësit, por gjithë shoqërinë.

Edukimi dhe kuptimi i të kaluarës duhet të jenë në zemër të politikave edukative. Sipas Rekomandimit 1283 (1996) të Këshillit të Europës, çdo individ ka të drejtë të njohë të kaluarën e tij, ta pranojë dhe ta kritikojë atë. E drejta e nxënësve për të shqyrtuar në mënyrë kritike gjithçka që shikojnë dhe dëgjojnë rreth tyre është bërë thelbësore në kushtet e zhvillimeve të reja teknologjike. Të kuptuarit e kompleksitetit të situatave të kaluara dhe të tashme duhet të bëhet në mënyrë të lirë dhe në frymë kritike.

Le ta shikojmë këtë ngjarje në kujtim të persekutimit të grupit të deputetëve si një homazh të munguar për veprën e tyre dhe si çast të thellë reflektimi.

Gramoz Ruçi

Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë



SHUMË
TOJMË
URËN,
MIRË I
FORMË
KRACISË

70 VËRTORI EKZERCIMET
TE "GJURIMT TE DEPUTETEVE"
**DEPU-
TETËT
PËR
DEPU
TETË**

HYRJE

Një ditë kujtесе dhe mendimi

Në datën 10 Shtator 2017, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit zhvilloi një aktivitet në sallën e Kuvendit të Shqipërisë, në kujtim të martirizmit të grupit të deputetëve të pushkatuar nga regjimi komunist. Kjo ngjarje, mbetur e mbuluar për një kohë të gjatë, duhet të na shërbejë për një reflektim të thellë, jo thjesht për të nxjerrë të vërtetën e asaj ngjarjeje, por për të reflektuar për lirinë.

U quajtën “grupi klandestin i deputetëve” me qëllim që t’i bënin të besueshme akuzat ndaj tyre. Kështu, grupi i parë i deputetëve, të quajtur si grupi i Shefqet Bejës, morën dënimin kapital 16 deputetë dhe intelektualë. Më 10 Tetor 1947, nga 16 të akuzuarit, tre u dënuan me varje, Shefqet Beja në Tiranë, Sulo Klosi në Rubik dhe Riza Alizoti në Kuçovë, 13 të tjerë me pushkatim, ndërsa Kolë Kuçali vdiq në hetuesi më 30 Maj 1947 nga torturat, por zyrtarisht e shpallën të vetëvarur në spitalin ushtarak të Tiranës. Regjimet totalitare mendojnë se duke zhukur njerëzit do të zhdukën dhe gjurmët e krimit të tyre, por harrojnë se, edhe një fjalë e hedhur në këtë botë nuk mbetet pa gjurmë dhe pasoja. Kështu, Agim Musta, i dënuar politik, na sjell një dëshmi mjaft tronditëse për këtë gjyq, që ia kishte treguar në burg Foto Bala, i cili i kishte mbaruar studimet për filozofi në Monpelje, që ia vlen të jepet i plotë për të kuptuar atë mekanizëm që u bë

paradigma juridike dhe politike e regjimit. Në dëshminë e tij Foto Bala thotë:

“Më 1945 më caktuan profesor në gjimnazin e Gjirokastrës, duke më survejuar natë e ditë, derisa më arrestuan nga mesi i vitit 1946. U akuzova se kishim krijuar grupin e Neoballistëve, se ishim lidhur me misionet anglo-amerikane dhe plot marrëzira të këtij lloji, që jo vetëm s'i kishim bërë, por as në ëndërr s'i kishim parë. Më dërguan në Tiranë. Në fillim më trajtuan butë, por kur unë nuk pranova të pohoja ato që më servirin, hetuesit xhahilë filluan torturat nga Mihallaq Ziçishti, Stavri Xhara, Kadri Hazbiu e të tjerë, që tmerrohëm dhe sot kur i kujtoj. U thashë se isha gati të pranoja çfarë të donin, vetëm t'i ndalonin torturat. U ndritën sytë dhe filluan menjëherë të mbushnin procesverbalet. Duke shkruar se isha anëtar i kryesisë së komitetit neoballist, se isha agjent anglo-amerikan-francez, se do të vritnim gra, pleq dhe fëmijë, madje edhe Krishtin dhe Muhametin po të ishin gjallë dhe plot marrëzira të neveritshme, që vetëm mendja e komunistëve mund të shpikë. I ndjeri Enver Sazani, me të cilin qëndrova disa ditë në qeli, më tregoi se hetuesi Mihallaq Ziçishti i kishte djegur dhe sytë me cigare, gjersa i kishte marrë pohimin se ishte agjent anglo-amerikan-francez. Doktor Sazani më tregonte ato ditë të fundit të jetës së tij se hijena Mihallaq i kishte pasë thënë se këto pohime i donin shokët jugosllavë për të demaskuar imperializmin ...”¹.

Në fakt, ky nuk ishte thjesht një gjyq politik, por edhe lufta që mediokriteti i shpalli dijes. Pasoja ishte depersonalizimi dhe dehumanizimi i shoqërisë, prandaj njohja e kësaj të kaluarë të afërt nuk merr vetëm një rëndësi shkencore, por duhet të shërbejë si një thirrje për një përsosje morale të shoqërisë tonë të sapodalë nga një regjim totalitar.

Në një kohë që karakterizohet nga mbisundimi i një fryme

1. Marrë nga parathënia e studimit të përgatitur nga Leka Ndoja dhe Alvin Sraçi, “Akte gjyqësore politike”, Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Tirana, 2016, f. 9.

afarizmi dhe merkantilizmi, në një kohë të bjerrjes së vlerave humane dhe një krize të thellë shpirtërore, nuk mund të mos kujtojmë një “profeci” të Hyserlit, pikërisht në prag të Luftës II Botërore, që ai shtroi para Europës në veprën “Krizja e shkencave europiane dhe fenomenologjia transcendentale”, por që vlen për çdo shoqëri, aq më tepër për shoqëritë në tranzicion: “Krizja e ekzistencës europiane ka vetëm dy zgjidhje: ose rënien e Europës, që është bërë e huaj me kuptimin e saj racional të jetës, rënien në urrejtjen shpirtërore dhe barabari, ose rilindjen e Europës duke u nisur nga fryma e filozofisë, në sajë të një heroizmi të arsyes që e kapërcen përfundimisht natyralizmin»². Përballë optimizmit se me zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë bota bëhet më rationale, Hyserli tregoi se edhe në kulmin e shkencës dhe teknologjisë mund të futet irracionalizmi. Shpikja e fabrikave të vdekjes, a nuk ishte shenja më e lartë e irracionalizmit? Shkurt, të kujtuarit dhe të menduarit e të kaluarës, bëhet një imperativ ekzistencial për të njohur veten tonë dhe për të tashmen dhe të ardhmen tonë dhe për gjeneratat e reja, me qëllim që ata të mos bien në një barbari të re. «Të mendosh dhe të kujtohesh, - shkruante Hannah Arendt, - është mënyra humane për të hedhur rrënjë, të zesh vendin tënd në një botë ku ne arrijmë të gjithë si të huaj. Atë që ne zakonisht e quajmë një person ose një personalitet, në kundërshti me faktin e të qenurit një qenie e thjeshtë ose të jesh askushi, në realitet derivon nga ky proces rrënjëzimi përmes mendimit»³. Puna e mendimit është një kusht i domosdoshëm me qëllim që ngjarjet që kanë ndodhur të formësohen në eksperiencë, në vend që të mbeten vetëm në sferën e psiqizmit dhe duke mos pranuar asnjë reflektim. Prandaj, të kujtuarit e atyre ngjarjeve të hidhura me viktimat e regjimit totalitar komunist, se si u mbyt era e demokracisë që në fillimet e saj merr një rëndësi të veçantë për rrënjësimin e

2. Edmund Husserl, **La crise des sciences européennes et la phénoménologie transcendentale**, Paris: Tel Gallimard, 1976, p. 382.

3. Hannah Arendt, **Responsabilité et jugement**, Paris : Payot, 2009, p. 149.

gjeneratave të reja në ekzistencën tonë të përditshme. Kështu që vendosja e nocionit të detyrës së kujtesës është një mënyrë për të vendosur një marrëdhënie edhe me krimet e regjimit komunist, për të mos vlarë edhe një herë të dytë duke harruar ata që u shfarosën në burgjet dhe kampet e vdekjes. Por, edhe të flasësh pa fund pa thënë thelbin e gjërave, nuk i shërben njohjes sonë. Detyra e kujtesës do të implikonte të kujtuarit. Por çdo të thotë të kujtosh? Të përsëritësh disa gjëra? Të dish një numër të caktuar faktesh? Të marrësh në konsideratë një bashkësi shifrash, emrash? Jo. Më e rëndësishme se sa të jesh thjesht në dijeni për atë se çfarë ka ndodhur në të kaluarën, është që të mendosh. Vetëm kështu ne do të dallojmë përgjegjësinë tonë. Ne duhet të themi «të vërtetën mbi të vërtetën», edhe në qoftë se kjo është një detyrë e rëndë dhe e dhimbshme. Sepse, siç ka theksuar Arendt në analizën e procesit të Eichman-it, ka një lidhje të thellë ndërmjet dhunës dhe faktit të të folurit përmes klisheve. Në të dy rastet, askush nuk bën ndonjë veprim të keq dhe askush nuk është viktimë.

Për të realizuar një përtëritje shpirtërore, vlen të kujtojmë ato pika referimi në historinë tonë të afërt që dëshmojnë për aktet e larta të njerëzve, të cilët, kur ora e historisë i vuri në provën e integritetit moral, treguan virtyte të larta të moralit dhe të humanizmit. Në këtë kontekst ne duhet të njohim edhe atë mekanizëm që shpinte në tjetërsimin e individit, në depersonalizimin e tij. Duke njohur krimin e kaluar dhe mekanizmin social dhe politik që e shoqëronte, ne nuk mund të mos prekemi nga ata njerëz që treguan një integritet të lartë moral, por nuk mund të mos mirëkuptojmë dhe ata që tortura i detyronte që të vetakuzoheshin. Shkurt, ne duhet ta kuptojmë të kaluarën tonë, për të njohur sa më mirë edhe veten tonë.

Jeta dhe vuajtjet e këtyre martirëve dëshmon edhe për një fakt tepër të rëndësishëm, se është e pamundur për një genie njerëzore që brenda tij të mos punojë humaniteti

i tij. Ky është një fenomen shumë vendimtar. Humaniteti ynë është i lidhur në mënyrë të pandashme me një hapje thelbësore që na bën të shqetësohemi për të tjerët, sidomos kur ata ndodhen në një gjendje të dëshpëruar. Dhe pikërisht këtë hapje thelbësore ne duhet ta mendojmë filozofikisht në qoftë se ne duam që të kuptojmë qenien e të qenurit tonë, sepse edhe gjuetari nuk mund ta vrasë një zog që fluturon drejt tij për të kërkuar një strehë. Ndërmjet dëshmive të shumta që kanë dalë në dritë mbas përmbysjes së regjimit totalitar komunist, duket sikur provohet ajo që shkruante Kamy në esenë **Njeriu i revoltuar**, botuar më 1951. “Çdo revolucionar përfundon si shtypës ose si fanatik. Në universin e kulluar historik që ata kanë zgjedhur, revolta dhe revolucioni hapen në të njëjtën dilemë: ose polici ose marrëzi”⁴. Nën logjikën marksiste të revolucionarit, se gjyqi është historia dhe ekzekutuesi i sentencës është proletari, u përligj terrori ndaj opozitarëve dhe intelektualëve, për ta bërë ekzekutorin edhe mendimtar.

Nga këto fakte dhe dëshmi më lejoni që të bëj një refleksion filozofik sipas një të mbijetuarit nga kampet famëkeqe të shfarosjes për shkak të origjinës hebreje, Emmanuel Lévinas. Nga sa më sipër, shikojmë edhe problemin e përgjegjësisë. Urdhëresa hynore thotë: “Ti nuk do të vrasësh”, atëherë pse njerëzit vrasin? A është Zoti përgjegjës për këtë? “Përgjegjësia personale e njeriut kundrejt njeriut është e tillë që Zoti nuk mund ta anullojë. Ja komentari rabinik i dialogut ndërmjet Zotit dhe Kainit: “A jam unë mbrojtës i vëllait tim?”, pyetja nuk është një paturpësi e thjeshtë. Ajo vjen nga ai që ende nuk e ka ndjerë solidaritetin njerëzor dhe që mendon (si shumë nga filozofët modernë) se secili ekziston për veten dhe se gjithçka është e lejuar. Por, Zoti i zbulon vrasësit se krimi i tij ka tronditur rendin natyror”⁵. Në qoftë se njeriu do të udhëhiqet nga parimi, se secili ka të vërtetën e vet

4. Albert Camus, **L'homme révolté**, Folio Gallimard, 1951, p. 311.

5. E. Lévinas, **Difficile liberté**, Paris: Albin Michel, 1963, p. 36-37.

dhe çdo gjë është e lejuar, pasojat janë shumë të rënda. Njerëzimi bie në barbari nëse udhëhiqet nga parimi nihilist se çdo gjë është e lejueshme. Prandaj Lévinas e vë theksin te përgjegjësia që duhet të ndjejë ai që prek njeriun tjetër. “E keqja nuk është një parim mistik që mund ta fshimë përmes një riti, ajo është një ofendim që njeriu i bën njeriut. Askush, madje as Zoti, nuk mund të zëvendësohet me viktimën”⁶. Edhe sot marrëdhënia me tjetrin po bëhet treguesi më i qartë i humanitetit të shoqërisë sonë në tranzicion. Përsëri, mendimtari që njohu natën naziste, në pamjen më të egër të saj, kampin e përqëndrimit, mund të na shërbejë për të ndriçuar aktualitetin. “Marrëdhënia me tjetrin nuk është një marrëdhënie idilike dhe harmonioze kungimi, as një simpati përmes së cilës ne vendosemi në vend të tij, por e jashtme nga ne; marrëdhënia me tjetrin është një marrëdhënie me një Mister”⁷.

Pra, detyra e kujtesës është jo vetëm që të sjellë në kujtesën e njerëzve shembuj që tregojnë se si shfaqet humaniteti i njeriut, kur vihet në provën e faktit që i sjell historia, por edhe që të kuptojmë se kjo barbari nuk ishte fakt vetëm i një individi imoral, por se kjo ishte vepër e një sistemi të ri. Kjo do të thotë se forca e një njeriu u ridublua, ose u drejtua, përmes një sistemi. Atëherë detyra jonë është që të kuptojmë dhe t’ua trasmetojmë të rinjve koherencën e tmerrshme të këtij sistemi të të keqes.

Detyra e kujtesës është që mendojmë se si u lindën marksizëm-leninizmi, stalinizmi dhe nazizmi, por gjithashtu edhe aspektet e jetës sonë aktuale. Duke lexuar dhe kujtuar ne njohim një eksperiencë që lidhet me ne edhe sot, përfshirë dhe demokracitë liberale. Regjimet totalitare që përjetuam, përfaqësojnë botën e jo-lirisë, të mos-zbutjes, botën e ndrydhur ku edhe Zoti ishte tërhequr. Përballë autoritetit të tyre arbitrar, meskin dhe të padrejtë, e vetmja rrugë shpëtimi

6. E. Lévinas, **po aty**, p. 37.

7. E. Lévinas, **Le temps et l'autre**, PUF, Paris, 1983, f. 63.

ishite të ndiqje ligjin tënd individual, të refuzoje nënshtrimin dhe të kapërxeleshin barrierat ndaluese. Kur sistemet e refuzojnë lirinë, atëherë vijnë periodhat e katastrofave.

Detyra e kujtesës na thërret që të mendojmë se disa janë humanë dhe disa nuk janë. Ne të gjithë duhet të gjejmë mënyrat për të qenë humanë. Të jesh human nuk është një natyrë, por diçka që ne duhet të jemi dhe që nuk është e parapërcaktuar. E thënë filozofikisht, qenia e të qenurit human nuk është natyrore. Prandaj Levinasi theksonte se çështja vendimtare duhet të jetë ajo e etikës, domethënë e marrëdhënies me tjetrin. Kështu, projekti komunist mbi pranverën e përjetshme të njerëzve, që na u tha në një gjuhë enciklike ishte një utopi që zëvendësoi Zotin me të ardhmen, siç shprehej Kamy, dhe këtu utopia i shërbeu cinizmit dhe krimin. Thelbësorja e këtij krimi nuk ishte thjesht zgjedhja e viktimave, por natyra e tij.

Prandaj, sot na duhet që të kuptojmë katastrofën e djeshme, pasi, siç shprehej Niçe, të vërtetat që harrohen kthehen në katastrofa. Të tregosh se e vërteta e sistemit komunist funksiononte në një moment, pavarësisht nga qeniet njerëzore që e bënë të ishte, kjo do të thotë që të mohohet përgjegjësia e secilit dhe lirinë që duhet të na karakterizojë. Është kollaj të quhet barbari ose monstruozitet ajo që ndodhi me komunizmin, por ajo që ndodhi u krye përmes përdorimit të metodave mizore, të cilat u përdorën në mënyrën sa më pak spektakolare të mundshme që synonin një manipulim sa më afikas të njerëzve duke i paraqitur viktimat si agjentë dhe tradhëtarë.

Prandaj ne kemi nevojë për sjelljen në kujtesën tonë jo vetëm të aksioneve morale që tregojnë humanitetin e një populli, pasi aksioni moral e përpunon individin, por edhe të keqen. Në këtë kuptim, kujtesa dhe historia duhet t'i shërbejnë përsosjes shpirtërore të shoqërisë sonë të tronditur thellë nga regjimi totalitar, sepse, siç shkruante Hanah Arendt, "lëvizjet totalitare janë të mundshme kudo ku ekzistojnë

masa, që për një arsye apo një tjetër, kanë në vetvete oreks për organizim politik”⁸.

Shpesh dëgjohej se e kaluara duhet të harrohet për të parë nga e ardhmja. Në fakt e kaluara duhet menduar për të kuptuar se çfarë lloj njerëzish jemi. Për shoqëritë që dalin nga totalitarizmi kjo është një detyrë themelore me qëllim që njerëzit të mos vazhdojnë të mbeten viktimë të mashtrimit dhe iluzionit. “Një nga zbulimet e qeverisë totalitare, shkruante Hannah Arendt, ka qenë metoda që konsistonte në gërmimin e vrimave të mëdha ku varrosnin faktet dhe ngjarjet që nuk mund të flitet, ndërmarrje e gjerë që mund të realizohej vetëm duke vrarë miljona njerëz që kishin qenë aktorë ose dëshmitarë të të kaluarës. E kaluara ishte e dënuar sikur nuk kishte ekzistuar kurrë”⁹. Nuk duhet të harrojmë se totalitarizmi, kudo ku u realizua përfshirë dhe Shqipërinë, duhet të konsiderohet si i vetmi rrezik i madh që kërcënon me rrënim total jo vetëm entitetin tonë politik, por edhe mbijetesën shpirtërore dhe substancën tonë morale. Kur totalitarizmi merr pushtetin, politika e brendshme i le vend intrigave dhe dhunës. Totalitarizmi mbështetet mbi shkëputjen e lidhjeve, që e lidhin njeriun me disa pika referimi të qëndrueshme dhe duke e privuar nga çdo referencë, sidomos çdo referencë morale, njeriu aspiron nga hiçi dhe anarkia brenda tij. Totalitarizmi i premtun çdo njeriu atë që ai dëshiron me qëllim që ta joshë sa më mirë. Në këtë kaos human, që nuk kuptohet si një kaos i brendshëm, sepse së jashtmi rendi ekziston, por që ka si pasojë një ndjenjë pakënaqësie të thellë, totalitarizmi shfaqet si një rrugë shpëtimi. Totalitarizmi nuk u kërkon njerëzve që të jenë vetvetja, por u kërkon një bindje të pakushtëzuar. Totalitarizmi përdor gjithçka për ta përfshirë në aparatit e pushtetit të tij, për ta dominuar individin sipas rolit që legjenda i atribuon gjarprit; ta joshë viktimën, me qëllim që

8. Hannah Arendt, **Origjinat e totalitarizmit**, Prishtinë: Dija,, f. 402.

9. H. Arendt, **Responsabilitë et jugement** ..., p. 333.

ta gëlltitë sa më mirë. Kështu, njerëzit, të privuar nga çdo pikë reference, që nuk kanë më ndërgjegjen e vetvetes dhe të lirisë së tyre, por që aspirojnë që të pohohen në mënyrë të verbër duke ndjekur një rregull të imponuar, e lenë veten të bien në kthetrat e kësaj makine që i trajton thjesht si një material dhe kështu humbasin gjithçka që kishin besuar se e kishin fituar dhe e ruanin. Prandaj totalitarizmi ka vetëm një armik; vetë lirinë, domethënë të vërtetën, universitetet, vendet e kërkimit të lirë, artin dhe letërsinë, pasi ato na bëjnë që të depërtojmë në tokat e panjohura të shpirtit, gjithçka që është eksperiencë, gjithçka që piqet përmes përsosjes intelektuale, gjithçka që te çdo qenie njerëzore nuk lejon që të udhëhiqet nga diçka tjetër; ndërgjegjja për të qenë vetvetja. Jo më kot Hitleri deklaronte se do t'i largonte njerëzit nga ajo humnerë që quhet ndërgjegje. Historia, që ndikon në emancipimin do të ndikojë në një ripërtëritje shpirtërore, sidomos për shoqëritë e sapo dala nga regjimet totalitare. Prandaj, çdo vullnet që nuk do të mendojë rreth rreziqeve që na tregojnë historia dhe aksioni politik, atëherë ai do të përballlet me surpriza të çuditshme në të ardhmen. Detyra e kujtesës është që të përjetësohet liria brenda një vendi të lirë. Në rendin shpirtëror të drejtat e pensionit nuk ekzistojnë. Më lejoni ta mbyll këtë diskutim me fjalët e Levinas: "Ekziston vetëm kjo: kohë pas kohe, muzgje të çuditshme e ndalojnë historinë e ndriçuar, drita copëtohet në flakëra të vogla të panumërta luhatëse dhe ambige, toka e fortë ju rrëshqet nën këmbë, ngjarjet fillojnë të rrotullohen në rrathë ferri rreth një ndërgjegjeje përsëri pa vend. Dhe siguri që tallen nga konfrontimi ju ngrenë nga një thelb i harruar"¹⁰. Shkurt, duhet ndriçuar historia për të mos harruar thelbin tonë human si njerëz.

Prof. Dr. Gjergj Sinani

10. E. Lévinas, **vep. e përm.**, f. 337.

**70 VJETORI I EKZEKUTIMIT
TË "GRUPIT TË DEPUTETËVE"**



70 VJETORI I EKZEKUTIMIT
TË "GRUPIT TË DEPUTETËVE"

10
TETOR
2017

DEPU-
TETËT
PËR
DEPU-
TETËT



REFLEKTI
TOT

Deputetët për Deputetët 70-vjetori i ekzekutimit të deputetëve opozitarë

Një nga historitë më të dhimbshme dhe tragjike të periudhës komuniste në Shqipëri, vrasja më 1947 e deputetëve opozitarë nga regjimi i sapo vendosur i Enver Hoxhës, bashkoi më 10 tetor 2017 deputetët e postdiktaturës në përkujtim të 70 vjetorit të kësaj ngjarje shumë të rëndësishme, por të harruar nga historia.

Me këtë rast, më 10 tetor 2017, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë, Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri dhe Qendrën e Studimeve Albanologjike, organizon takimin “Deputetët për Deputetët”, në sallën e seancave plenare. Aktiviteti përkujtoi “grupin e deputetëve” opozitarë, në 70-vjetorin e ekzekutimit të tyre. Takimi u hap me fjalën e mirëseardhjes të Kryetares së AIDSSH, znj. Gentiana Sula. Sipas saj edhe pse kanë kaluar 70 vjet nga dita e rënies së sistemit totalitar “akoma ndihet një mosartikullim historik i 45 viteve diktaturë. Figura si Musine Kokolari, Sabiha Kasimati, grupi i deputetëve e shumë të tjerë, ende nuk njihen mirë. Ditë kujtese si kjo e sotmja i shërbejnë pikërisht njohjes dhe artikullimit të përpjekjes sonë kombëtare për të mbrojtur si pasuri të çmuar mendimin ndryshe, që nuk rreshti as në diktaturë”. Diskutimi mbi vlerat europiane të opozitarëve të parë, parlamentarizmin dhe mendimin ndryshe vijoi me fjalën e Kryeministrit, z. Edi Rama, i pasuar nga kryetari i Partisë Demokratike, z. Lulzim Basha.

Partnerët e Autoritetit dhe të shtetit shqiptar në një sërë projektesh mbi të kaluarën e pasojat e saj si: vijuan diskutimet. Në komentet e veta, secili prej tyre, - si mbështetës i projekteve të AIDSSH, për dosjet, studimin e dokumentimit të periudhës komuniste dhe personat e zhdukur, - theksuan nevojën për t'u përballur me transparencë me të shkuarën, duke konsoliduar kështu demokracinë.

Në prani të familjarëve të të ekzekutuarve, të përndjekur për vite me radhë, trashëgimtarëve të tyre, historianëve e studentëve, përfaqësuesve të institucioneve publike dhe jo-qeveritare, organizatave kombëtare e ndërkombëtare, bashkëbisedimi vijoi me fjalën e znj. Nevila Nika, familjare e fizikanit deputet Selaudin Tota dhe diskutimet e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, nga tre grupime parlamentare. Në një dialog të hapur, të gjithë bashkë në këtë seancë të posaçme reflektuan mbi “të shkuarën, si pjesë e patjetërsueshme e raportit me të ardhmen si dhe marrëdhënies së shoqërisë me vetveten. Në një shkëmbim idesh, znj. Jorida Tabaku, znj. Almira Xhambulla, z. Enkelejd Alibeaj, znj. Edlira Bode, znj. Kejdi Mehmetaj, z. Fatmir Mediu, znj. Eglantina Gjermani, znj. Oriola Pampuri, z. Shezai Rrokaj, z. Romeo Gurakuqi, znj. Evis Kushi, znj. Klodiana Spahiu dhe z. Sadi Vorpsi, u dhanë zë deputetëve që iu pre jeta në mes, duke e kthyer vëmendjen te viktimat dhe ridimensionimi i tyre në shoqëri.

Më 10 tetor 1947 u zbatua vendimi për ekzekutimin e 16 vetëve të dënuar si pjesëtarë të organizatës ilegale “Nacional Demokratike”, prej të cilëve 5 ishin deputetë të Kuvendit Popullor. Për takimin përkujtimor, AIDSSH ka zbardhur materialet arkivore që gjenden për këtë gjyq, përmes një CD me materialet e digjitalizuara dhe për herë të parë dorëzon një dosje të plotë me lëndë arkivore, foto, studime për ngjarjen dhe pjesë filmike për të.

Heqja e mandatit, arrestimi dhe dënimi i një grupi

deputetësh të Asamblesë Kushtetuese/Kuvendit Popullor në vitin 1947, vetëm një vit pasi ky kishte marrë mandatin për të ushtruar veprimtarinë e tij, është një nga ngjarjet më tronditëse të historisë së komunizmit në Shqipëri. Nga të dënuarit në dy prej proceseve gjyqësore, 15 qenë deputetë që iu kundërvunë herët kufizimit të lirive politike të shqiptarëve, duke u akuzuar si pro-perëndimorë. Të gjithë deputetët e dënuar ishin personalitete me kontribut të spikatur në shoqërinë shqiptare. Ata vinin nga prejardhje të ndryshme shoqërore, arsimore e politike, por bashkoheshin në aspiratën për një Shqipëri moderne, me prosperitet ekonomik e shoqëror dhe për një sistem politik liberal. Deputetët opozitarë ishin përfshirë aktivisht, apo jo, në lëvizjen e rezistencës shqiptare. Ngjarja shënoi shkëputjen nga Perëndimi, që zgjati thuajse pesë dekada. Zhvillimi i kësaj seance të veçantë, në Kuvendin e Shqipërisë, u shoqërua edhe nga emocione të forta, si nga simbolika e ngjarjes dhe nga përjetimet e familjarëve, që kishin njohur kalvarin e persekutimit, për fajin e vetëm, sepse ishin familjarë të viktimave.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit është përgjegjës për zbatimin e ligjit, lidhur me mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to, bazuar në ligjin nr. 45/2015 **“Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”**.

Për të ndjekur veprimtarinë e Autoritetit, ndiqni faqen tonë www.autoritetidosjeve.gov.al ose në Facebook, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit 1944-1991, AIDSSH, ku mund të merret informacion për veprimtaritë e zhvilluara dhe ato të pritshme.

AIDSSH mbetet i hapur për propozime dhe bashkëpunime, me qëllim fuqizimin e dialogut dhe edukimin qytetar.



DISKUTIMET E DEPUTETËVE NË KUJTIM TË DEPUTETËVE TË VRARË

Genta Sula, Kryetare e Autoritetit

Të nderuara familje Beja, Deliallisi, Sazani, Karbunara, Dhonato, Dani, Kokalari, Toto, Konjari, etj.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar përfaqësues të trupit diplomatik

Më lejoni së pari, të shpreh respektin për deputetët e këtij parlamenti, të cilët, të impenjuar në kauzat e mëdha që shqetësojnë kombin, dedikuan axhendën e ngjeshur dhe e huazojnë sot shtëpinë e tyre, për përkujtimin e ekzekutimit të “grupit të deputetëve” 70 vjet më parë.

“Grupi i deputetëve” përbëhej nga figura të shquara të shoqërisë së kohës, antifashistë, profesionistë dhe politikanë të nderuar, me reputacion shumë të mirë në popull, të cilët dolën deputetë nga zgjedhjet e para të pasluftës.

Por, ata e donin Shqipërinë si demokraci perëndimore. Vizion që u munduan ta vënë në jetë me kurajë të pashembullt, përballë terrorit e spastrimeve që kishin filluar të shfaqeshin, që pa mbaruar mirë lufta. Për këtë arsye, dhe u dënuan me vdekje.

Ata mbetën përjetësisht në tregimet e shqiptarëve si “grupi i deputetëve” e me këtë emër hynë dhe në histori, duke kthyer sakrificat e tyre sublime në standardin më të lartë të përkushtimit ndaj lirisë dhe demokracisë.

70 vjet më parë, me ekzekutimin e deputetëve ishte një nga aktet e tragjedisë që themeloi institucionin e eliminimit fizik të mendimit ndryshe, institucion, i cili do të ishte një realitet i përditshëm në 43 vitet në vijim.

Sot përulemi para vlerave më të larta që përfaqëson “grupi i deputetëve” dhe bashkëpunëtorët e tyre që humbën jetën tragjikisht po atë ditë:

1. *Shefqet Beja – deputet (me varje)*
2. *Enver Sazani – deputet (me vdekje)*
3. *Sheh Ibrahim Karbunara - deputet (me vdekje)*
4. *Selaudin Toto – deputet (me vdekje)*
5. *Irfan Majuni – deputet (me vdekje)*
6. *Tefik Deliallisi (me vdekje)*
7. *Hysen Shehu (me vdekje)*
8. *Salim Kokalari (me vdekje)*
9. *Sulo Konjari (15 vjet burg)*
10. *Ramazan Tabaku (dënohet me vdekje, por i ndryshohet vendimi me 25 vite burg)*
11. *Gjovalin Vlashi (burg përjetë)*
12. *Rustem Sharra (burg përjetë)*
13. *Xhevat Xhafa (burg përjetë)*
14. *Rram Marku (burg përjetë)*
15. *Beqir Çela (me vdekje)*
16. *Riza Alizoti (me varje)*
17. *Sulo Klosi (me varje)*
18. *Paolo Saggioti (me vdekje)*
19. *Foto Bala (burg përjetë)*
20. *Abdyl Kokoshi (me vdekje)*
21. *Shefki Minarolli (burg përjetë)*
22. *Pertef Karagjozi (me vdekje)*
23. *Mehmet Prishtina (me vdekje)*
24. *Agathokli Xhitoni (me vdekje)*

*Le të mbajmë një minutë heshtje në nderim të tyre!
I përjetshëm iu qoftë kujtimi!*

Në përputhje me mandatin tonë, i propozuam deputetëve një aktivitet të veçantë: thellim në njohjen për këtë ngjarje, duke u bërë zëri i atyre që jeta iu pre tragjikisht në mes. Deputetët për deputetët!

Ata morën dosjen e plotë që kemi zbardhur me rastin e kësaj dite, e cila përbëhet nga rreth 1000 faqe tashmë të digjitalizuara, si dhe burime të tjera rreth ngjarjes, përfshirë dy artikuj studimorë. Gjej rastin të falënderoj z. Hamit Kaba dhe znj. Sonila Boçi të Akademisë së Studimeve

Albanologjike, që përgatitën një artikull të përditësuar. Në këtë mënyrë mundësojmë të drejtën mbi të vërtetën, duke i dhënë jetë një dialogu të shëndetshëm dhe të bazuar mbi fakte për këtë periudhë të historisë sonë jo të largët.

Leximi i historisë, në hapësirën dhe dritën e duhur, na bën të njohim vetveten, të jemi të vetëdijshëm për rreziqet që i kanosen demokracisë dhe të rritim breza të shëndetshëm e më të imunizuar në sfidat që kohët hedhin mbi ta.

Politika ka një vlerë të jashtëzakonshme në krijimin e kësaj hapësire dhe kësaj drite. Ishte pikërisht politika që i dha jetë transparencës mbi arkivat sekrete të diktaturës. Është po politika që ka krijuar këtë hapësirë diskutimi këtu sot. Shpresoj që bashkëpunimi konkret me deputetët e të gjitha grupeve të formalizohet e forcohet më tej, me krijimin e një dialogu të vazhdueshëm mbështetës për institucionin tonë të ri, si dhe për çështje të rishqyrtimit të historisë dhe edukimit qytetar për vitet e diktaturës.

Kanë kaluar 27 vjet nga dita e rënies së sistemit totalitar dhe akoma ndihet një mosartikulim historik i 45 viteve diktaturë. Figura si Musine Kokolari, Sabiha Kasimati, grupi i deputetëve e shumë të tjerë, ende nuk njihen mirë. Ditë kujtese si kjo e sotmja i shërbejnë pikërisht njohjes dhe artikulimit të përpjekjes sonë kombëtare për të mbrojtur si pasuri të çmuar mendimin ndryshe, që nuk rreshti në diktaturë.

Leximi i kësaj përpjekje na bën nder të gjithëve dhe na lejon të ndërtojmë një ballafaqim pa komplekse me prindërit dhe fëmijët tanë, me një ndjenjë krenarie për shpirtin liridashës të shqiptarëve, edhe nën tirani.

Është një fitore e të gjithë shoqërisë shqiptare që Dita e Kujtesës së Mendimit të Lirë të themelohet sot, së pari, në tempullin e fjalës, në parlamentin shqiptar.

Jam shumë e sigurt, që deputetët e sotëm të Kuvendit të Shqipërisë, pavarësisht nëse i përkasin minorancave apo mazhorancës, sot ndihen të gjithë brenda këmbishëve të kolegëve të tyre historikë, të torturuar e vvarë jo shumë kohë më parë.

Ju faleminderit!



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

“
SA MË SHUMË
TA KUPTOJMË
DIKTATURËN,
AQ MË MIRË I
JAM DORMË
DE...
AC...
AND

Pandell Malke

76. Flibia Gjinali

7. Ermir Gharaj



Fjala e Kryeministrit të Shqipërisë Z. Edi Rama

Shumë të nderuar dhe të dashur pjesëtarë të familjeve të deputetëve që përkujtojmë sot.

Zonja dhe zotërinj, anëtarë dhe anëtare të Kuvendit të Shqipërisë, shkëlqesi, miq, të ftuar.

S'është e lehtë të rikujtosh, me përlësinë dhe vetëpërmbytjen e nevojshme, një dëshmi kaq domethënëse. Dëshminë tragjike të jetës së dhënë për një zanat të vjetër sa bota, politikën. Politikën e idealeve, vlerave, parimeve. Politikën e lindur për t'u dhënë njerëzve mundësinë të bëjnë së bashku atë që vetëm nuk e bëjnë dot. Deputetët dhe grupimi elitari, i asgjësuar barbarisht 70 vjet më parë, ishin sfidë ndaj një regjimi që fatkeqësisht e pati jetën shumë të gjatë, pas marrjes së jetëve të tyre dhe lumturisht është përmbysur 27 vjet më parë.

Rikujtimi i tyre sot, në këtë sallë, vlen për aq kohë sa mbetet sfidë për ne dhe bashkëkohësit tanë në raport me politikën. Me politikën si arsye dhe si mjet që i bën njerëzit së bashku, në emër të gjërave më të larta dhe që rëndom i ndan dhe i përçan ata për llogari të interesave të ulëta. Sfidë, si nxitje për t'u kujtuar për një moment të gjithë së bashku, se ne jemi këtu që të gjithë, pavarësisht se në shumicë apo në pakicë, si rezultat i lirisë dhe për ta përdorur lirinë dhe fjalën në funksion të atyre që këtu na kanë sjellë.

Shumë prej këtyre dëshmorëve të fisnikërisë së politikës ishin përshkruar në gjithë sistemin e bindjeve të tyre, nga socialdemokracia më gjithëpërfshirëse. Pikërisht ajo socialdemokraci që në vitet '50, me rezistentin dhe kryeministrin francez, Pierre Mendès France e përkufizonte veten me shprehjen që mbetet edhe sot një apel. "Jo çdo politikë njollos, jo çdo hap i ndërmarrë

përpara është kotësi!”. Pierre Mendès France ishte njeri i filozofisë dhe letrave, njësoj si shumë prej deputetëve që u eliminuan fizikisht nga ai sistem që me gjakun e tyre dhe me gjakun e plotë të tjerëve, u ushqye për të ushqyer urrejtjen dhe për ta kthyer politikën në një shembull rrëqethës të forcës ndaj kujtdo, që përmes politikës mund të kërkonte forcën domethënëse të shembullit.

Dhe, me thënë të drejtën, të përjetosh sot frymën aq të shëndetshme të sakrificës, që i çoi në asgjësim këta paraardhës tanët është e vështirë. Është e vështirë, sepse në ndërkohë nuk mund të mos harrosh se sa shpesh, sa në mënyrë të rëndomtë dhe sa në mënyrë të padenjë, shpesh herë, shkelet këtu, në këtë sallë, çdo javë ajo frymë. Dhe, nga ana tjetër, patjetër që është e pamundur të mos vlerësohet pikërisht, pse-ja e madhe që lidhet me Shqipërinë e pas luftës, me Shqipërinë e aspiratave të mëdha që mishëronin edhe këta paraardhës tanët, me Shqipërinë e vetëmohimeve të një populli të vogël dhe të vobektë, ku gjithë fryma dhe dëshira për progres u përdor për të ngjizur një mekanizëm të tërë vëllavrasës dhe vetëshkatërrues.

Një mekanizëm, që ndonëse i çuar për skrap 27 vjet më parë, vazhdon të ndotë mjedisin tonë publik përmes nesh. Përmes politikës. Përmes të zgjedhurve. Përmes gjithë atyre që kur shkojnë tek populli janë përgjegjës të gatshëm të bëjnë gjithçka për t'u njësuar me imagjinatën më të mirë të atyre që votojnë dhe kur vijnë këtu nuk lënë gjë pa bërë për të treguar se, në fakt, mes të thënës dhe të bërës nuk është në mes thjesht një det i tërë, por është tradhtia ndaj politikës ashtu siç e konceptonin dhe e jetonin ata, që për politikën dhanë jetën dhe ashtu siç cilido prej nesh e ka konceptuar momentin kur ka kapërcyer pragun e saj.

Sidoqoftë, as sot dhe unë besoj as për jo pak vite, ne nuk do të arrijmë dot ta çlirojmë këtë sallë, ta çlirojmë vetveten, si pjesë e kësaj gjenerate të politikës, nga ndotja prej atij mekanizmi që si çdo gjë e ndryshkur, por e pa ricikluar tërësisht në diçka tjetër, helmon dhe pengon. Ajo që mbase vlen si një arsye e mirë për t'u larguar nga ky reflektim, që po të shkojmë më thellë mund ta prishë këtë ceremoni, është fakti që sot jemi këtu për shkak të një ligji, që ne e kaluam në këtë parlament dy vjet më parë, në mos gabohem, një ligji që më në fund, ekzaktësisht pas 25 vjetësh e bashkoi Shqipërinë me vendet që kaluan përmes ferrit komunist dhe që vendosën të ndahen me të, jo thjeshtë duke ndërruar sistemin dhe kostumet, por duke guxuar të bëjnë dritë mbi të shkuarën.

Ligji për dosjet, për hapjen e dosjeve, për ato dosje që për 25 vjet u përdorën për të goditur njeri tjetrin. Por, kush më shumë i përdori më pak guxoi t'i hapte dhe sot ne jemi këtu falë një ligji që është i pari në historinë e dhimbshme dhe komplekse dhe të përbashkët që ne ndajmë, që na pajis me mjete hulumtimi, në funksion të një misioni human dhe humanist. Dhe unë nuk mund të mos jem sot krenar për faktin që jam në krye të një qeverie dhe një shumice që këtë mision e mori përsipër, pasi të tjerë përpara nesh nuk e patën kurajën ta merrnin, apo nuk gjetën kohë ta merrnin edhe pse shumë kohë shpezuan dhe shpenzuan të gjithë së bashku duke baltosur njëri-tjetrin me duart e padukshme edhe të atyre fantazmave, që fshihen nën kapakët e dosjeve dhe dosja e procesit gjyqësor, apo në fakt e sajësës së kobshme, që u mbyll më 27 shtator 1947. "Provat" e së cilës janë sot të lexueshme duket sikur vijnë nga një univers i pajetuar, i shpikur. Por, në fakt, janë gurë të rëndësishëm kilometrikë në një rrugë që do të jetë e gjatë, do të jetë e dhimbshme, por do të

jetë shëruese. Rrugën e hedhjes dritë mbi të shkuarën për të mos lejuar që e kaluara, me errësirën e vet, të vazhdojë të mbajë peng të ardhmen tonë, siç e ka mbajtur për shumë vite pas rënies së regjimit. Përmes zërash, përmes figurash, përmes fantazmash që kanë ditur bukur mirë ta përdorin skenën e demokracisë si një teatër për t'i ikur përgjegjësisë së të shkuarës.

Një major dhe dy kapitenë ushtrie, të asistuar nga një aspirant, janë autorët e eleminimit të 15 deputetëve, që përbënin 20 për qind të Parlamentit në atë kohë. Por, jo vetëm 20 për qind të parlamentit, që ta kuptojnë qartë të gjithë ata, që tek parlamenti nuk shikojnë boshtin e inteligjencës kombëtare dhe në fakt nuk kanë faj, por 20 për qind të atij boshti që ishte i përfaqësuar në Parlamentin e kohës dhe është e papërfytyrueshme të shohësh përmes “provave” të gjyqit se si një kolektiv punonjësish prej 1350 anëtarësh, apo se si një skuadër vullnetarësh diku tjetër, apo se si një kolektiv, apo grup diku tjetër, i shkruanin gjykatës, i shkruanin majorit dhe dy kapitenëve se përse këta njerëz duheshin shfarosur. Dhe, për këtë arsye, na vlen edhe ligji, për këtë arsye mund të na vlejë edhe kjo seancë, që përveç se nderon kujtimin e deputetëve të rënë, përveç se ngushëllon modestisht plagën e hapur të familjarëve të tyre, mbase sjell pak dizinfektant në këtë sallë dhe mbase ndihmon që në të ardhmen muret e kësaj salle të mos jenë dëshmitare të aq shumë gjërave të padenja që kanë dëgjuar në këto 27 vjet. Duke i shprehur edhe një herë falënderimin tim të gjithë atyre që morën kurajën të na bashkohen në nismën për hapjen e dosjeve.

Duke i shprehur falënderim të gjithë atyre, që jo në kushte optimale, po përpiqen ta zbatojnë ligjin e dosjeve. Duke i shprehur falënderimin ideatorëve dhe organizatorëve të kësaj seance të posaçme, që na sollën këtu dhe, në një farë mënyre, na kanë

vënë përpara foltores kujtimin e një numri të vrarësh nga paraardhësit duke arritur të realizojnë sot të pamundurën, që të na pengojnë, që ne të gjejmë një tjetër arsye për t'u kapur me njëri-tjetrin.

Unë dua ta mbyll me kujtimin që këtu, por kudo në botën komuniste, mishëroi në një slogan që ishte edhe në Poloni, “Përjetësisht me diktaturën e proletariatit!”. Këtë slogan, polakët e transformuan në një motiv për t'iu kundërvënë diktaturës së proletariatit, me sloganin “Përjetësisht, por asnjë sekondë më shumë!”. Shumë faleminderit!

70 VJETORI I EKZEKUTIMIT
TË "GRUPIT TË DEPUTETEVE"

DEPU-
TETËT
PËR
DEPU-
TETËT

REC...

Fjala e kryetarit të opozitës Z. Lulzim Basha

Të nderuar familjarë të deputetëve të martirizuar 70 vite më parë të grupit të elitës intelektuale, bashkëvuajtës së tyre.

Të nderuar anëtarë dhe drejtues të shoqatave të të përndjekurve politikë.

Shkëlqesi ambasadorë, zonja dhe zotërinj, anëtarë të Kuvendit.

70 vjet më parë, regjimi barbar komunist i Enver Hoxhës pushkatoi grupin e deputetëve të fundit opozitarë, që kishin mbetur në këtë sallë. I vrau sepse mendonin ndryshe. I vrau sepse nuk u pajtuan me komunizmin, nuk u pajtuan me vdekjen e pluralizmit politik. Grupi i deputetëve dhe dhjetëra bashkëvuajtës të tyre ishin të fundit, në radhën e intelektualëve, patriotëve dhe shqiptarëve që i kishin shërbyer me përkushtim, me mençuri, vendit dhe popullit të tyre, por që nuk iu bashkuan klikës komuniste. Para tyre ishin eliminuar, burgosur, torturuar, ekzekutuar dhe internuar pjesa më e madhe e elitës së kombit. Klerikë, intelektualë, inxhinierë, ekonomistë, artistë, mjekë dhe profesionistë të shkëlqyer do t'i pasonin në dekadat e ardhshme. Të gjithë u dënuan pa gjyq, ose me gjyqe farsë, të montuara nga prokurorët dhe hetuesit kriminelë. Të gjithë u vranë në emër të popullit, nën moton, “drejtësia është levë e partisë”.

Eliminimi i deputetëve opozitarë, 70 vite më parë, varrosi përfundimisht, çdo lloj lirie politike në Shqipëri, çdo lloj mendimi dhe çdo lloj disidence apo mosbindje ndaj regjimit. Pas tyre, salla e të ashtuquajturit Kuvendi Popullor, u mbush me kriminelë, me injorantë dhe me shërbëtorë të bindur të klikës gjakatare, të cilët shërbyen vetëm si fasadë e shëmtuar dhe gojëqyçur

e pushtetit personal të Enver Hoxhës. Pas kësaj, në Shqipëri kishte vetëm një zë, një mendim dhe një ngjyrë, enverizmi. Të gjitha institucionet politike dhe shoqërore të vendit, kuvendi, qeveria, organizatat e rinisë, organizatat e gruas, fronti demokratik, media dhe çdo institucion tjetër, pavarësisht prapashtesave popullore apo demokratike, ishin thjeshtë instrumente të sundimit të Enver Hoxhës dhe rrethit të tij të ngushtë, përmes propagandës, manipulimit, dhunës dhe terrorit. Vrasjet, burgosjet, internimet, shpronësimet, persekutimet dhe gjithë dhuna që u ushtrua në fillimet e regjimit komunist dëshmoi një të vërtetë të madhe, e cila vazhdon t'i mbahet e fshehur kësaj shoqërie dhe këtij kombi.

Komunizmi nuk ishte zgjedhje e lirë e popullit shqiptar, por një regjim që u instalua dhe iu imponua popullit me dhunë e me gjak dhe që u mbajt me dhunë dhe me gjak. Kjo dhunë filloi që në ditët e para të ekzistencës së Partisë Komuniste, të drejtuar nga Enver Hoxha dhe antishqiptarët jugosllavë, Miladin Popoviç dhe Dushan Mugosha. Vazhdoi gjatë gjithë luftës kundër fashizmit dhe komunizmit, u bë masive menjëherë pas ardhjes në pushtet të Enver Hoxhës dhe klikës së tij, vazhdoi pa ndërprerë gjatë gjithë sundimit enverist në Shqipëri. Vrasjet, burgosjet, internimet, shpronësimet dhe persekutimi tregojnë gjithashtu një të vërtetë sa ironike aq dhe domethënëse. Të ashtuquajturat ideale socialiste ishin thjeshtë dhe vetëm preteksti për pushtetin personal të Enver Hoxhës. Pushteti i Enver Hoxhës ishte një pushtet personal dhe gjakatar. Ideologjitë që ai përqafoi ishin vetëm instrumenti për mbajtjen e këtij pushteti. Kjo është arsyeja, që dhuna e tij nuk kurseu askënd. As ata që luftuan me ndershmëri dhe idealizëm në radhët e ushtrisë partizane. Disa nga deputetët e pushkatuar qenë të tillë. Por, kontributi

i tyre në luftë, në krah të komunistëve nuk i shpëtoi dot nga eliminimi. Të gjitha diktaturat, në thelb, janë pushtete personale që përdorin ideologjitë dhe kauzat e mëdha si instrumente. Të njëjtën gjë bëjnë të gjithë autokracitë, të reja dhe të vjetra, që maskohen pas populizmit, pseudonacionalizmit, patriotizmit të rremë, të mirës së popullit. Ky është mësimi që duhet të nxjerrim nga e shkuara komuniste. Ky është detyrimi që jetët e flijuara të patriotëve dhe martirëve të vërtetë shqiptarë, si dhe gjithë viktimave të pafajshme të komunizmit të mos kenë shkuar kot.

Sot, unë ndiej dhimbje sepse e di që ceremonia e sotme, e fjalët që po fliten nga kjo sallë janë për shumë shqiptarë hera e parë, në veçanti për të rinjtë shqiptarë, që dëgjojnë konkretisht për krimet dhe të vërtetat e dhimbshme të komunizmit. Sot, unë ndihem fajtor si deputet, si politikan, si kryetari i Partisë Demokratike dhe si qytetar që ne kemi lënë pa bërë shumëçka për gati tre dekada, për të dënuar krimet e komunizmit. Për të dënuar mentalitetin dhe praktikën komuniste dhe diktatoriale. Për të penguar eksponentët e lartë komunistë dhe autorët e krimeve të komunizmit që të mos ndikojnë më jetën politike dhe shoqërore në vend. 70 vjet, pas vrasjes së deputetëve, unë ndihem i turpëruar që jam pjesë e një Kuvendi, i cili drejtohet nga njëri prej atyre që ishte pjesë aktive e asaj klike kriminale, që vrau dhe dhunoi shqiptarët që donin lirinë dhe dinjitetin e njeriut. Ndjem i trishtuar që, 27 vjet pas rënies së komunizmit, ky vend ende vazhdon të ketë në krye të institucioneve njerëz të edukuar dhe stërvitur me mësimet e Enver Hoxhës dhe të ushtruar me frymën dhe praktikën enveriste. Jam po aq i dëshpëruar, që pas 70 vjetësh ka njerëz, që nuk kanë as ngjashmërinë më të vogël me martirët e demokracisë shqiptare dhe janë vite drite larg tyre për

nga karakteri dhe integriteti njerëzor, për nga formimi intelektual, për nga aftësitë dhe kontributi profesional dhe, mbi të gjitha, për nga aftësia për ta dashur pa kushte vendin dhe bashkëqytetarët e tyre.

Ky është dështim, dështimi ynë, i gjithë shoqërisë tonë, i politikës dhe i intelektualëve të ndershëm të këtij vendi. Së fundi, jam i hidhëruar dhe i revoltuar që me paratë e taksapaguesve shqiptarë, këto katër vite, infrastruktura çnjerëzore e Sigurimit të Shtetit dhe e aparatit të dhunës së komunizmit është kthyer në tërheqje turistike duke u trajtuar si diçka argëtuese, ndërkohë që nuk ka asnjë monument dhe përkujtime për viktimat e komunizmit dhe vuajtjeve të tyre.

Ndaj sot dua të zotohem që, së bashku me Partinë Demokratike, të punojmë që kjo të ndryshojë dhe ka ende shumë që ne mund të bëjmë. Së pari, duhet të gjejmë dhe identifikojmë të gjitha eshtrat e viktimave të komunizmit, ende të pa zbuluara. Së dyti, duhet të nderojmë emrat dhe kontributin e të gjithë martirëve të vërtetë të demokracisë dhe pluralizmit shqiptar. Ne duhet t'i kujtojmë ata, duhet të rrëfejme jetën e tyre, sakrificat e tyre, tragjeditë e tyre, që janë akte të tragjedisë tonë të kobshme kombëtare nën diktaturën e Enver Hoxhës. Së treti, ne duhet të tregojmë krimet e komunizmit dhe historinë tragjike, se si një popull i tërë ra në kthetrat e përgjakura të komunizmit dhe ju nënshtrua atij për gati pesë dekada. Së katërti, duhet t'i presim rrugën njëherë e mirë, të paktën drejtuesve të lartë komunistë, nga drejtimi i vendit. Së pesti, të ndalojmë manifestimin publik të shenjave, simboleve dhe figurës së Enver Hoxhës dhe figurave gjakatare të regjimit të tij. Ne do t'i prezantojmë Kuvendit akte konkrete për përmbushjen e këtyre objektivave, jo vetëm ligje dhe amendamente, por do të kërkojmë që nisur nga buxheti i vitit të ardhshëm, të përfshihet një

fond për studimin, hulumtimin dhe botimin e historive kriminale të komunizmit dhe viktimave të tij. Është koha të sjellim zërat e jetët e atyre që luftuan për liri dhe demokraci në çdo shkollë, në çdo klasë dhe në çdo bankë të nxënësve shqiptarë. Është koha të nxisim dhe mbështesim studiuesit dhe intelektualët, që të punojnë për zbardhjen e historisë së zezë të komunizmit, në mënyrë që ajo të na bëhet reflektim për ne dhe për brezat e ardhshëm.

Historia e dhimbshme e diktaturës nuk duhet të përsëritet kurrë më. Ne duhet ta ndalojmë me çdo kusht dhe me çdo çmim një mundësi të tillë. Mirënjohje për jetë martirëve të diktaturës gjakatare, zoti e bekoftë Shqipërinë!



Fjalimi i Brian J. Williams, Ambasador i OKB-së në Tiranë

Shtatëdhjetë vite më parë, më 10 tetor 1947, 16 deputetë shqiptarë u ekzekutuan sepse kishin një opinion, jo për shkaktim dhune apo për vjedhjen e ndonjë gjëje, por vetëm sepse kishin një opinion se si shqiptarët duhej të qeverisnin veten e tyre.

Kjo padrejtësi ishte vetëm një prej ngjarjeve të para të asaj, që do të shndërrohej në një prej diktaturave më të ashpra të shekullit XX.

Pikërisht një vit e një muaj pas ekzekutimit të këtyre 16 parlamentarëve, më 10 dhjetor 1948, në Paris u miratua Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, nga e sapokrijuara Kombet e Bashkuara.

Deklarata luftonte për ato gjëra, që diktatura mohonte, liria e shprehjes, liria dhe lëvizja e lirë, e drejta për të marrë pjesë në qeverisje, e drejta për një votim të lirë, parimet e barazisë njerëzore dhe, më e rëndësishmja, mbrojtja e të drejtave të njeriut nëpërmjet shtetit të së drejtës.

Kjo Deklaratë nxiti një lëvizje të të drejtave të njeriut që hodhi rrënjë përreth gjithë botës, duke frymëzuar një shtim të shpejtë të instrumenteve të të drejtave të njeriut dhe aktivistë nga të gjitha kulturat dhe kontinentet e botës.

Rritja e kësaj lëvizje nxiti Kombet e Bashkuara që të krijojë një Këshill të përhershëm të të Drejtave të Njeriut, me qendër në Gjenevë, një Këshill në të cilin Shqipëria qëndron krenare. Vitin e kaluar Këshilli dërgoi Grupin e

Punës së tij të pavarur për Zhdukjet me Forcë në Shqipëri.

Këtu, për habinë e tyre, këta ekspertë të pavarur të të drejtave të njeriut zbuluan një trashëgimi të diktaturës, që ende kërkon mjaftueshëm ballafaqim.

Ata gjetën një seri rastesh, që flasin për rreth 6 000 individë të zhdukur. Raste, të cilat, sipas opinionit të tyre ligjor, janë ende të hapura, pasi kufomat ende nuk janë gjetur, drejtësia nuk është vënë dhe për pasojë aplikohet parimi i një krimi të vazhduar.

[Ata zbuluan se, 25 vite pas rënies së komunizmit, “asnjë rast i zhdukjeve të detyruara nuk është] trajtuar në gjykatë”].

Në vija më të përgjithshme, ata deklarojnë, në përfundimet e tyre, të paraqitura muajin e kaluar tek Këshilli në Gjenevë, nevojën për një qasje të gjerë dhe gjithëpërfshirëse për t’u ballafaquar me të kaluarën.

Po citoj: “Shqipëria ende duhet të zgjidhë shkeljet e rënda dhe sistematike të të drejtave të njeriut, të kryera nga diktatura. Më shumë se 25 vite pas rënies së regjimit, në vitin 1991, e kaluara mbetet e gjithëpranishme dhe plagët janë të thella ... Iniciativat aktuale pozitive që kanë për qëllim qeverisjen e mirë, ngritjen e institucioneve dhe shtetin e të drejtës, nuk mund dhe nuk do të arrijnë potencialin e tyre të plotë nëse kufizohen nga pesha e të kaluarës së dhimbshme të vendit. Shteti duhet të inkurajojë një debat publik kombëtar mbi trashëgiminë e të kaluarës shtypëse, si dhe të tejkalohej së bashku pasojat e saj të dhimbshme. Një debat i tillë është jashtëzakonisht i rëndësishëm në një shoqëri që ka mungesë besimi në institucionet shtetërore ...”

Seanca e sotme parlamentare krijon një mundësi të jashtëzakonshme për të ndërtuar me vull, për një proces të tillë gjithëpërfshirës, një proces, i cili mund të sjellë drejtësi dhe të vërtetën, si dhe të mundësojë mjete për t'u shëruar nëpërmjet përkujtimit, shpërblimit dhe mbështetjes sociale. Një proces i tillë ka nevojë që të njohë të gjithë “të zhdukurit” nga regjimi, qoftë shënjestër e pastër politike ose jo.

Raporti i Grupit të Punës citon disa shembuj pozitivë, përfshirë veçanërisht ndërtimin e “Bunk Art 2”, punën drejt marrëveshjes me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Humbur (ICMP) për të ndihmuar në identifikimin e mbetjeve dhe veçanërisht ngritjen e Autoritetit mbi Dosjet e Sigurimit.

Kombet e Bashkuara përgëzojnë Qeverinë për krijimin e Autoritetit dhe vetë Autoritetin për përqaftimin e shpejtë të mandatit të tij, duke hedhur dritë në krimet e së kaluarës, duke marrë pjesë në iniciativat e reformës në drejtësi dhe të transparencës në politikë, duke mbështetur rikuperimin e mbetjeve të viktimave të Sigurimit dhe duke kërkuar që të përkujtohen.

Programi i Kombeve të Bashkuara është i kënaqur që po bëjmë atë që mundemi, në bashkëpunim me partnerët, për të mbështetur Autoritetin dhe unë inkurajoj qeverinë që t'i japë mjetet e nevojshme që të kryejë detyrat e tij.

Më lejoni t'ju përgëzoj sërish, parlamentarë të nderuar, në organizimin sot të kësaj seance speciale, e para e llojit të saj, për Gjyqin e Deputetëve të vitit 1947. Fatmirësisht dita e sotme do të kujtohet si pika e kthesës në veprimin e Shqipërisë për të hedhur dritë mbi të shkuarën e saj.



Fjala e Kryetarit të Prezencës së OSBE Ambasador Bernd Borchardt

Në përkujtim të 70-vjetorit të ekzekutimit të 16 deputetëve. Gjatë dekadave të fundit, shumë shoqëri në botë janë përballuar me fenomenin e tranzicionit: Afrika, ish-Bashkimi Sovjetik, Evropa Lindore, Amerika Latine: ndryshimet pas-koloniale, përmbysja e diktaturave ushtarake dhe e regjimeve totalitare me shpresën për liri dhe demokraci. Distançimi nga rendi diktatorial kudo çoi në lindjen e pyetjeve të nxehta, si për shembull: si të përballemi me të kaluarën e ligë? Çfarë lloj trajtimi i së kaluarës ndihmon në krijimin e një rendi të ri liberal? Si të bëjmë drejtësi në të mirë të viktimave? Si të krijojmë një narrativë të re çliruese?

*Tranzicionet shpesh sjellin ndryshimin e paradigmeve normative, gjë që e vështirëson aplikimin e sanksioneve penale në rrethanat e shtetit ligjor: **nulla poena sine lege** (nuk ka ndëshkim për krimet që nuk përbënin vepër penale në kohën kur janë kryer) – ky është rregull thelbësor për shtetet demokratike. Ose, thënë ndryshe: si të vëmë përpara përgjegjësisë individët që kanë kryer shkelje sistematike gjatë një sundimi shtypës? Kjo nuk e përjashton ndëshkimin për krimet më të tmerrshme, por e kufizon sferën e veprimit të drejtësisë penale.*

Shoqëritë kanë në dispozicion mjete të ndryshme për realizimin e drejtësisë tranzitore. Kompensimi mund të jetë një prej tyre. Por, edhe për një vend të pasur si Gjermania Perëndimore, nuk ka qenë i mundur kompensimi i plotë i të gjitha dëmeve të shkaktuara prej komunizmit. Kjo sepse fatura e kompensimit do të rëndonte mbi të gjithë taksapaguesit.

Këto dilema – përpjekjet e viktimave për drejtësi dhe alternativat e kufizuara për sanksione dhe kompensim - kanë ngjallur hidhërim të thellë tek shumë viktima të

regjimit në shumë vende. Ata ndihen sikur kauza e tyre nuk po njihet aq sa duhet. Megjithatë, i takon shoqërisë shqiptare dhe këtij parlamenti të vendosin nëse mund të bëhet më shumë në këtë fushë, madje edhe pas vendimeve më të fundit në lidhje me kompensimin.

Mirëpo, ekzistojnë edhe mënyra të tjera për t'i zbardhur dhe dënuar shkeljet. Këtë po bën edhe ky Kuvend i nderuar sot: ju po njihni krimet e së kaluarës dhe po i dënoni ato dhe kjo në vetvete arrin përmasa shndërruese, sepse pranimi publik kontribuon në çlirimin e shoqërisë. Ekspozimi i shkeljeve i damkos dhe i shkualifikon shkelësit, duke i syrgjynosur në të kaluarën e hidhur. Kjo përbën shtysë për avancimin normativ, gjë që është thelbësore për një tranzicion çlirues.

Për mua është nder dhe krenari që më jepet mundësia t'ju drejtohem në këtë moment historik, kur parlamenti thotë bashkërisht në këtë mbledhje, në lidhje me krimet e regjimit të mëparshëm: "Po, kjo ishte diçka e gabuar dhe e ligë" dhe ju e thoni këtë pavarësisht mendimeve tuaja rreth ideve politike të deputetëve të ekzekutuar.

Regjimet shtypëse bien me revolucion ose përmbysje, por ideologjia e tyre mund të vijojë nëse ato nuk diskreditohen. Ju shpallni qëndrimin e përbashkët politik dhe ndani të njëjtën vetëdije politike me votuesit tuaj. Kjo vetëdije, e cila shpall: "Po, kjo ishte diçka e gabuar dhe e ligë", e ndan edhe më shumë shoqërinë tuaj nga regjimi i mëparshëm; ky akt ritual kontribuon në vetëdijen kolektive lidhur me këtë avancim normativ, sepse po hidhni poshtë ideologjinë e mëparshme dhe po vini në dukje ndryshimin ideologjik që karakterizon shndërrimin çlirues. Prandaj, ky moment është gur kilometrik për procesin që ka filluar në Shqipëri, përmes diskutimeve publike, ndërtimit të muzeve, vendeve të kujtesës dhe ngritjes së Autoritetit për Hapjen e Dosjeve të Ish-Sigurimit të Shtetit: ky është dialog kombëtar mbi të kaluarën.

Siç mund ta dini, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri është angazhuar prej më shumë se dy vitesh në mbështetje të dialogut lidhur me përballjen me të kaluarën dhe të Autoritetit të Dosjeve të Ish-Sigurimit në punën e tij.

Dija dhe dialogu për të kaluarën, luajnë rol vendimtar në trazicionin çlirues, dhe ndihmojnë në rivendosjen e identitetit të vendit. Ky parlament mund të diskutojë dhe të vendosë nëse Shqipërisë i duhen më shumë akte të tilla tranzitore, që krijojnë lidhjen normative mes të kaluarës dhe të ardhmes së vendit. Mundësitë për ta vazhduar dhe për ta thelluar këtë dialog janë të shumta.

Prezenca e OSBE-së e quan kënaqësi mundësinë për të kontribuar në këtë dialog.

Ambasadorja gjermane Znj. Suzanne Schutz

Është një privilegj dhe nder i madh për mua që të marr pjesë sot në Sesionin e Veçantë për përkujtimin e 70 vjetorit të ekzekutimit të 16 deputetëve, që kundërshtonin kushtetutën e parë komuniste, që themeloi regjimin totalitar në tetor 1947.

Shtatë dekada duket një kohë të gjatë, jetëgjatësia e më shumë se dy gjeneratave. Megjithatë, për viktimat dhe familjet e tyre, fëmijët dhe nipërit e mbesat e tyre nuk është kurrë tepër vonë për të bërë drejtësi për keqbërjet e kaluara dhe për të kujtuar dinjitetin e patjetërsueshëm të çdo qenieje njerëzore. Për më tepër, ekzekutimi i 16 përfaqësuesve të zgjedhur të popullit shqiptar ishte në fund liria e fjalës, fundi i pluralizmit dhe futja e diktaturës në Shqipëri për më shumë se 40 vjet që do të vijnë!

Në shekullin e njëzetë, Gjermania përjetoi dy herë diktaturat totalitare: Nga 1933 deri më 1945 ishte socializmi nacionalist fashist, i cili solli vuajtje të pamatshme dhe krime mbi popujt dhe kombet në Evropë dhe më gjerë. Më vonë, nga viti 1945 deri më 1989, gjermanët në RDGJ vuajtën nga një regjim çnjerëzor komunist, i cili u mohoi qytetarëve të tyre liritë dhe të drejtat themelore.

U deshën 20 vjet, pas Luftës së Dytë Botërore, derisa në Gjermani brezi i ri i pasluftës kërkoi përgjigje për pyetjet e tyre të shumta se kush ishte përgjegjës, cilët ishin autorët, cilët ndjekës dhe si t'u kthehej dinjiteti viktimave. Ky nuk ishte një proces i lehtë, por çoi në njohjen në vitin 1990, pas përfundimit të sundimit komunist në RDGJ, se kujtimi i të kaluarës është i pashmangshëm për një shoqëri që kërkon një fillim të ri, në respektimin e të drejtave të njeriut dhe pluralizmit demokratik.

Në sfondin e përvojës sonë gjermane, ne mirëpresim që Shqipëria ka filluar një proces serioz për t'u marrë me të kaluarën e vet. Në veçanti, themelimi i Autoritetit për hapjen e dosjeve të Sigurimit ishte një vendim i



rëndësishëm. Dhe, me shpresë, së shpejti Autoriteti do të jetë në pozitë që t'u japë akses në dosje gjithnjë e më shumë individëve dhe të afërmve të tyre, si dhe të hapet për kërkime shkencore dhe publike.

Më vjen mirë, pra, që Gjermania ka qenë në gjendje të këshillojë projekte për të kujtuar të kaluarën e afërt të Shqipërisë, qoftë për shembull, në bashkëpunim me Shtëpinë e Gjetheve ose ndërmjet Autoritetit të Hapjes së Dosjeve të Sigurimit me Federatën Gjermane dhe Komisionerin për Regjistrimet e Shërbimit të Sigurisë Shtetërore të ish-RDGJ-së.

Ne jemi të gatshëm për të ndarë përvojën tonë dhe për të ndihmuar Shqipërinë edhe në të ardhmen. Në fund të fundit, megjithatë, vetë shqiptarët duhet të gjejnë përgjigje për shumë pyetje të hapura rreth historisë së tyre të kohëve të fundit. Kujtimi i së kaluarës dhe trajtimi i padrejtësive është një proces i vështirë dhe madje i dhimbshëm. Sesioni special i sotëm përkujtimor, pra, është një ngjarje e rëndësishme, një moment historik dhe, me shpresë, për shumë më tepër në të ardhmen, duke u mundësuar shqiptarëve të kujtojnë të kaluarën e tyre në mënyrë që të ndërtojnë një shoqëri ku respektimi për secilin, shumicën dhe minoritetin të jenë njësoj.

Nevila Nika, përfaqësuese e familjeve të persekutuar

Ndihem thellësisht e nderuar që po flas përpara jush për një ngjarje jo të gëzueshme, fatkeqësisht, tejet të hidhur që përcaktoi fatet e vendit tonë në dekada e dekada.

Znj. Sula më prezantoi si pjesëtare të dy familjeve. Familjes Toto dhe asaj Prishtina. Jugu i Shqipërisë dhe veriu i Shqipërisë. Një fat, nuk është meritë e imja. Merita ime do të jetë që sa të kem frymë të vazhdoj në rrugën e tyre. Por, cila ishte ajo. Dashuria për këtë vend, një dashuri e pamasë që nuk morën parasysh absolutisht asgjë. Të shkolluar në shkollat më të mira të asaj kohe, por edhe ata që nuk ishin të shkolluar kishin kontribute të jashtëzakonshme në historinë e Shqipërisë. Por, ky ishte ndoshta edhe një faj shumë i madh për ata. Regjimi komunist ende nuk ishte vendosur plotësisht, të zgjedhurit ishin nga grupi i nacionalistëve të ndershëm, nga familjet me ndikim, sepse të themi të vërtetën, Luftën Antifashiste Çlirimtare nuk e kishin bërë vetëm ata që kishin taserën e partisë, e kishte bërë i gjithë populli shqiptar, natyrisht me përjashtime të vogla.

Selaudin Toto, profesor i fizikës, themeluesi i Institutit të Shkencave, nuk e kujton më shkenca shqiptare. Riza Alizoti, nuk ishte deputet, por faji i tij ishte se e kishte dashur këtë vend, i shkolluar në Angli dhe kthehet në Shqipëri. Ishte i biri i Fejzi Alizotit dhe ai duhej dënuar, e njëjta gjë për Shefqet Bejën. Por, unë do t'ju përmendja këtu, Kol Kuqalin, babin e dy heronjve të luftës antifashiste, baza kryesore e rinisë antifashiste në Tiranë, ishte pikërisht shtëpia e Kuqalëve. Kol Kuqali ndërron jetë në tortura. Maqo dhe Gjikë Kuqali pothuaj harrohen.

Nuk dua t'ju mërzis duke ju përmendur torturat që u përdorën ndaj tyre. Por, gjykoj që nuk ishin vetëm shqiptarët ata që i bënë. Natyrisht specialistët kishin



ardhur nga veriu i trojeve tona. U kishin mësuar tortura që kurrë në Shqipëri nuk ishin bërë. Ndoshta as në periudhën e Perandorisë Osmane. Por, ata i përdorën tek këta burra të cilët kishin integritetin, kishin një formim të jashtëzakonshëm, donin t'i shërbenin vendit. Mendimi i tyre ndryshe, unë nuk dua t'ju përsëris, parafolësit folën për këtë çështje, por dua t'ju them se në qoftë se ata shikonin që po shkërmoqej ajo pak gjë që neve kishim, kishim pak, ishim 800 mijë banorë. Në 800 mijë banorë sa ishin që ishin të shkolluar, sa ishin që kishin zë, sa ishin që kishin ndikim për të mirën e këtij vendi. Ishin shumë pak dhe ne ata pak i keqpërdorëm, i keqpërdorëm ose edhe ua morëm jetët. Sot ne nuk i kemi eshtrat e tyre. I kërkojmë, ndoshta është shumë e vështirë t'i gjejmë. Por, shpresa humbet e fundit.

Unë vij nga radhët e historianëve dhe të arkivistëve të këtij vendi. Historianët kanë një tiran, por jo një tiran burrë, një tiran grua, të vërtetën. Ne duhet ta dimë të vërtetën, çfarë ndodhi, se si është ajo. Na vjen mirë apo na vjen keq. Familjet e këtyre të shquarve të këtij vendi

vuajtën pafundësisht, vuajtën pafundësisht fizikisht, kush bëri burg dhe internim, kush kampet e përqendrimit. Por, edhe ata që qëndruan në qytete, nuk pati për ata të drejta studimi, nuk pati për ata të drejta për të punuar në një punë, po themi pak sa më të lehtë, duhet të ishin vetëm punëtorë të rëndomte. Përpiqej me gjithë mend, regjimi, deri në fund t'ju ulte kokën. Unë sot shoh këtu që ende janë.

Selaudin Toto pati nipër dhe mbesa, nuk pati fëmijë, nuk krijoi familje. Asnjëri prej tyre nuk bëri shkollë. Por, të gjithë ishin me armë në dorë në male për lirinë e vendit. Kunata e tij, nusja e Ismet Totos, ishte zëvendës presidente e bashkimit antifashist të grave shqiptare. Një personalitet për kohën. Nuk punoi kurrë. Iu vunë taksa të jashtëzakonshme edhe kur e dinin që ata nuk kishin asgjë.

Mehmet Prishtina, djali i një prej familjeve më të njohura të Kosovës martire, duhet të ekzekutohej. Nuk ishte deputet, vetëm 19 vjeç, s'i kishte mbushur të 20-at, s'kishte ndonjë lidhje. Por, akuzat, ju do t'i lexoni materialet që na i ka bërë gati Autoriteti, janë absurde. Kaq absurde sa nuk e beson si ka mundësi që të jenë bërë të tilla gjëra.

Drejtesia shqiptare e vitit '45-'46 dhe në '48-ën pësoi goditjen e vetë më të madhe, e pati edhe një tjetër në '66-ën dhe '67-ën, sepse të gjithë ata juristë, të formuar më përpara, natyrisht nuk mund të ishin pjesë e trupave gjykuese. U përmendën disa emra, që ishin krejtësisht të pashkolluar, të indoktrinuar.

Por, edhe këta deputetë, këta burra patën disa faje. Faji i madh i tyre ishte, se e donin Shqipërinë si gjithë Europa. U kthyem mbas pesë dekadash ta përsërisnim këtë fjalë dhe na dukej si çudi kur e thoshim. Në shkollat tona mësohet pak për këtë periudhë kaq të errët të historisë tonë, që ia shumë pasoja. Nga studiuesit gjithashtu nuk analizohet, nuk duam të flasim vetëm për vrasje dhe

torturat, por çfarë erdhi nga mbrapa.

Diplomacia dhe politika, pak dinë për këtë periudhë, sepse këta burra patën edhe një faj tjetër, e donin të bashkuar Shqipërinë dhe Kosovën. Por, ne ishim me Beogradin, me Titon, në këto kushte këta duhet të eliminoheshin. Profesor Selaudini, përktheu, shqipëroi “20 vite ngatërresa në Ballkan”. Një faj tjetër dhe faji tjetër më i madhi ishte, sepse bisedonin me misionet Aleate. Shqipëria ishte pjesë e boshtit antifashist botëror. Ne nuk është se nuk bënim pjesë në të. Atëherë ku ishte arsyeja se kanë folur me nën-kryetarin e misionit amerikan, apo britanik, apo me një zonjë sekretare? Por, heshtazi ata kishin mbaruar shkollën amerikane, një ndër shkollat më të mira që ka pasur Shqipëria e atyre viteve dhe, si të tillë, konsideroheshin rrezik potencial për pushtetin që ishte duke u vendosur.

Terrori i ushtruar, u përmenden telegramet, telegramet janë diçka që mbetesh e befasuar kur i shikon. Është një histeri kolektive e nxitur, nuk ka qenë se ishte populli dakord. Populli nuk e dinte akoma se çdo t’i vinte nga pas. Kur iu mor tregtarit, do t’i merresh në fund edhe fshatarit më të fundit, pula e fundit dhe nuk do të kishin më çfarë të hanin. Dyert e mbyllura të Shqipërisë i pamë në 90-91-shin se si u shqyen.

Nuk kishim të drejtën të flisnim, të mendonim ndryshe, të lëviznim. Nuk kishim asnjë lloj të drejte. Në këto kushte, në 27 vite shumë ankohen, unë do të them, që kemi arritje, më shumë mund të bëjmë dhe duhet të shkojmë pak sa në gjurmët e tyre.

Gjyshi im në vitin ’37 në momentin e varjes nga regjimi i Zogut tha një fjalë për rininë: “Bota është e atyre që digjen dhe jo e atyre që ngrohen”.

Alva Dani, përfaqësuese e familjeve të persektuara



Unë jam Ava Dani, stërmbesa e Rizat Danit, deputetit të Shkodrës, politikanit me përmasa perëndimore, që luftoi në emër të idealit të lirisë. E njoh përmes kujtimeve të babait tim dhe disa fotografive, ku bie në sy vështrimi tepër i ngulitur dhe shumë autoritar. Është nder dhe emocion i veçantë të ndodhesh në të njëjtin vend nga ku një pjesë e elitës intelektuale shqiptare, 70 vjet më parë, u bë pjesë e krenarisë tonë kombëtare dhe për fatin e tyre të keq, pjesë e një historie të llahtarshme persektimi. Falënderoj fort Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, për botimet dhe punën kërkimore në realizimin e këtyre materialeve me dëshmi dhe arkiva duke nxjerrë nga mesi i errësirës atë që është historia jonë e përbashkët.

Jam e mendimit se vetëm njohja dhe denoncimi i këtyre krimeve do të mirëedukojë brezat e rinj, do t'i

ndërgjegjësojë për krimet çnjerëzore të kryera nga regjimi diktatorial i Hoxhës, do të respektojë sado pak viktimat e krimeve të regjimit totalitar komunist, si dhe familjet e tyre dhe do të jetë një shenjë mirënjohjeje për qëndresën e tyre ndaj diktaturës, në luftën në emër të idealit të lirisë së vendit. Bashkohem me mendimin e atyre studiuesve, intelektualëve apo akademikëve, që mendojnë se ka ardhur koha që të nisë një fushatë kombëtare për ndërgjegjësimin rreth krimeve të kryera në emër të kësaj ideologjie të sëmurë komuniste, duke përfshirë rishikimin e librave shkollorë, zyrtarizimin, pse jo, të një dite kombëtare kushtuar viktimave të komunizmit në Shqipëri, ose ngritjen e një monumenti për nder të tyre. Do të ishte jo vetëm një dëshmi e kujtimit dhe sakrificës së tyre, por edhe e një fakti tjetër, që kjo histori nuk duhet të përsëritet më kurrë.

Jorida Tabaku, deputete

Në fakt është shumë e vështirë që të flasësh mbas Nevilës dhe zonjës Dani dhe, në fakt, në këtë foltore, që në këto katër vitet e fundit, që unë kam folur në morinë e shumë fjalëve, ndoshta edhe polemikave të kota politike, për mua ky mund të jetë një nga fjalët më të veçanta që jam menduar shumë për të shkruar që kur zonja Mara më tha se do të flisje në këtë seancë.

Së pari, më lejoni që të përkulem me respekt në nder të punës, luftës, përkushtimit, sakrificave të familjarëve tuaj. Çurçilli thotë: “Një komb që harron të djeshmen është i destinuar të mos ketë të ardhme”.

Kohët, në të cilat ne po jetojmë, janë të vështira dhe njëkohësisht të çuditshme. Reflektojnë ndasi të mëdha reale që ne kemi si shoqëri, në raport me të djeshmen dhe marrëdhënien me të. Përpiqemi që të ndërtojmë një urë komunikimi me të shkuarën tonë totalitare. Jo në bazat e një reflektimi dhe shumë rrallë përçojmë në breza atë që kultura jonë ka harruar për të shkuarën.

70 vjet më parë në sallën e ish-Kinema Nacionalit u stis një nga gjyqet e para farsë të regjimit komunist. Në një sallë që sot nuk e gjejmë dot në këtë qytet, sepse është zhdukur si shumë pika kyçe të Tiranës, para dhe gjatë diktaturës, për t'i lënë vendin një pallati të madh, që fatkeqësisht ka projektues të së djeshmes, të komunizmit. Atje, pra, ku sot ngrihet një pallat i madh, mbi 20 intelektualë, deputetë, sipërmarrës, pronarë dhe shqiptarë të ndershëm u dënuan me vdekje apo me burgim të përjetshëm. Pa prova, pa gjyq. Sot, pak dëgjoj që të flitet për deputetët e vrarë nga regjimi komunist në shtatë dekada më parë. Në shkollat tona nuk di që të kujtohet kjo ditë dhe familjarët e martirëve të torturuar, më pas ekzekutuar apo dënuar, të jenë të lirë të flasin, të tregojnë, të transmetojnë atë dramë që kanë pasur ato dhe familjet e tyre. Në vend të kësaj, të këtij reflektimi, ne sot kemi helmin e vazhdueshëm të një kulture, që na sjell ndërmend të djeshmen në formën e një nostalgjie pozitive,



gati-gati perfekte, një marifet që shërben më shumë për të mbushur kujtesën, kështu që e djeshmja të mos qëndrojë e boshatisur.

Unë kam qenë dhjetë vjeç kur dëgjova për herë të parë, nga halla ime, se si trupi i Shefqet Bejës është gjendur në pragun e shtëpisë time të vjetër tiranase, në rrugicat e vjetra të Tiranës dhe është lënë aty të dergjet, që ta shohin të gjithë se si komunizmi dënon ata që mendojnë ndryshe, ata që veprojnë ndryshe, ata që punojnë për të ndryshuar realitetin e hidhur para 70 vitesh, por edhe sot njësoj. Çfarë mund ta shtynte një qeveri, që të përzgjedhurit e popullit t'i çonte në skëterrën e burgut apo në botën e përtejme? Të thuash çmenduria e një grupi bandit që donin të sundonin deri në ditët e tyre të fundit, mund të kesh thënë shumë pak, ajo çfarë e shtyn një regjim totalitar të kryejë akte kaq çnjerëzore lidhet me ideologjinë, e cila për t'u zbatuar kishte nevojë për terrorin, kishte nevojë për traumën.

Detyrimi jonë karshi atyre që dhanë jetën për liri apo që edhe jeta ju morr tinëzisht nga një regjim gjakatar është shumë herë më i madh. Sot, shumë prej jush, ende nuk e dinë se ku ndodhen eshtrat e familjarëve tuaj. Fatkeqësisht dhe paturpësisht sot ende nuk kemi një fond të veçantë për gjetjen e trupave apo shumë prej jush një gur varri

ku, ndoshta, mund të shkojnë të reflektojnë. Është mëse e vërtetë që Kuvendi i Shqipërisë ka dënuar krimet e regjimit komunist. Kolegët kanë votuar në vitin 2006 një rezolutë të kërkuar nga BE-ja dhe së fundmi një rezolutë, që dënon vrasjen e eksponentëve fetarë nga regjimi diktatorial.

Po a mjafton kjo? Unë mendoj që jo. Sot, nuk ka një institucion që të marrë emrin e Musine Kokalarit, Riza Danit, Selaudin Totos, Jup Kazazit, Sheh Karbunarës dhe sa e sa viktimave të tjera të vrara padrejtësisht. Në fakt, vendin e tyre e kanë zënë portretet e diktatorit që nuk mbahen mend vetëm nga mosha e tretë dhe nostalgjikët, por fatkeqësisht edhe nga fëmijët. Kjo është historia jonë e trishtë, e shkuara jonë nuk ka qenë nostalgjia që na prezantohet në formën e koncerteve, asnjë gjoja tentativë artistike për t'ia prezantuar të huajve të djeshmen si diçka përtypëse në formën e artit. Përkundrazi, e shkuara jonë është mësimi për brezat e ardhshëm se si nuk duhet ndërtuar asgjë mbi ideologjitë totalitare, se si pushteti nuk duhet të jetë pronë e një klike uzurpuesish, se si mendimi dhe demokracia nuk duhet të jenë tituj dhe slogane qeveritare, por thelbi i vetë jetës sonë si shoqëri dhe, fatkeqësisht, kjo sot është e vërtetë.

Ne sot gjendemi midis dy antagonizmave, të djeshmes që vazhdon të na shtyjë, duke na kujtuar vuajtjen tuaj e të familjarëve tuaj dhe të ardhmes që qëndron si bllokadë. Tokëvili, në fakt, ka një shprehje shumë të bukur që kryeministri e citoi por, nuk tha se kush e kishte thënë, “deri sa e djeshmja ka reshtur të hedhë dritë mbi të ardhmen, mendja e njeriut endet në errësirë”. Fatkeqësisht ishte ironi shumë e madhe e fatit që e tha kryeministri, por sot ky është realiteti. Kërkoj që në respekt të këtij parlamenti, në respekt të sakrificës, të gjithë familjarëve tuaj, të nderojmë kujtimin e martirëve Beja, Alizoti, Klosi, Toto, Karbunara, Saggioti, Xhitoni, Prishtina, Kokoshi, Çela, Kokalari, Deljallisi, Majuni, Karagjozi, Sazani, Shehu, Bala, Tabaku, Marku dhe Vlashi, i përjetshëm qoftë kujtimi i tyre!

Almira Xhambulla, deputete



Ne deputetët e këtij Parlamenti flasim shpesh nga kjo foltore. Por, sot është një emocion shumë i veçantë dhe unë ndjehem e privilegjuar që më jepet mundësia të ndaj me ju dy fjalë në lidhje me ngjarjen e errët që ka ndodhur para 70 vitesh.

Grupi i deputetëve, që doli hapur, si një grup i organizuar në mbrojtje të parimeve bazë të demokracisë perëndimore, tentoi të bënte opozitën në Parlamentin e parë të Shqipërisë komuniste. Opozita e tyre lindi me një jehonë të jashtëzakonshme për shkak të qëndrimit të tyre kundër instalimit të komunizmit në Shqipëri, duke shtruar domosdoshmërinë e mendimit ndryshe dhe të një alternative tjetër qeverisjeje. Por, edhe pse në atë kohë regjimi komunist ishte ende i pakonsoliduar, lufta politike ishte shumë e ashpër dhe sidomos të bëje opozitë ishte tepër e vështirë. Iniciativa për të ndalur revanshin komunist u kushtoi jetën, jo vetëm grupit të deputetëve që kishin mundur të hynin në parlamentin e Shqipërisë,

por dhe shumë bashkëpunëtorëve të tyre, të cilët, propaganda e shfrenuar, nga opozitarë i cilësoi si armiq që kishin bashkëpunuar me kriminelët dhe agjenturat e huaja. Thënë ndryshe, armiq të popullit dhe të atdheut. Me anë të këtij procesi, regjimi komunist pati si synim të nënshtronte dhe asgjësonte opozitën e vërtetë demokratike dhe shprehjen e mendimit të lirë në Shqipëri duke shuar kështu, për 45 vite me radhë, çdo shpresë apo tentativë për demokraci dhe pluralizëm.

Natyrisht është shumë e rëndësishme ta kujtojmë historinë, jo thjesht dhe vetëm për të nderuar grupin e deputetëve që luftuan për Shqipërinë europiane. Por, ajo ngjarje e errët duhet të na shërbejë dhe ndërgjegjësojë të gjithëve për t'i vlerësuar akoma më shumë parimet tona bazë, lirinë dhe demokracinë. Ata punuan me përkushtim për alternativën e fjalës se lirë, qeverisjes pa diktaturë dhe që Shqipëria të mos ndahej dhe izolohej nga vendet e tjera perëndimore.

Por, a e kemi sot Shqipërinë ashtu siç e dëshironin ata? A e kemi sot atë demokraci, për të cilën ata sakrifkuan edhe jetën? A i shërben sot fjala e lirë lirisë, transparencës, konkurrencës, mirëqeverisjes? Unë mendoj që kemi akoma shumë punë përpara, për ta kuptuar dhe jetuar siç duhet demokracinë dhe pluralizmin, sepse në themel të demokracisë dhe pluralizmit duhet të jenë e vërteta, puna, toleranca, mirëkuptimi dhe respekti për njëri-tjetrin. Por, a i kemi ne këto në shërbim të zhvillimit të vendit dhe integritit në Bashkimin Europian? Sot, fatmirësisht, kemi opozitë, kemi mendim ndryshe, kemi fjalën e lirë. Por, fatqësisht, dëmi, dhimbja dhe pasojat që i shkaktojmë dikujt, qoftë deputet apo njeri i zakonshëm, për shkak të baltosjes, akuzave apo denigrimit publikisht, të ngritur shpesh mbi gënjeshtër dhe mashtrime për qëllime veçse politike, janë ndoshta po aq të mëdha sa dhe torturat fizike të komunistëve të asaj kohe.

Demokracia në Shqipëri është akoma e brishtë dhe këtu nuk është fjala vetëm për procesin zgjedhor, për të cilin unë kam shumë besim, që së bashku me të gjitha forcat e tjera politike, do arrijmë ta përmirësojmë së shpejti me anë të reformës zgjedhore. Demokracia lidhet edhe me punën e shoqërisë civile, me mediet e pavarura, e qeverisjen kombëtare dhe lokale, kuadrin juridik, pavarësinë e drejtësisë dhe shkallën e korrupsionit.

Në të gjitha këto drejtime ka akoma shumë punë për të bërë, por ka edhe shumë shpresë dhe besim, qoftë tek reforma në drejtësi, që është një arritje shumë e madhe dhe që ne të gjithë presim me padurim t'i shikojmë së shpejti rezultatet. Qoftë tek lufta kundër korrupsionit, lufta kundër informalitetit, e qoftë tek angazhimi shumë i rëndësishëm i medieve të pavarura dhe i shoqërisë civile, që gjithnjë e më shumë dëgjohet.

Të gjithë mund dhe duhet të japim kontribut për forcimin e demokracisë, për një Shqipëri më të mirë, më të drejtë, më të zhvilluar dhe më të integruar në Bashkimin Europian. Edhe një herë respekt dhe nderim pafund për grupin e deputetëve që ëndërruan dhe luftuan për një Shqipëri Europiane. Është detyrimi ynë që realitetin e Shqipërisë demokratike ta vashdojmë dhe ta çojmë përpara, drejt Shqipërisë europiane, sepse shqiptarët e kanë merituar atë gjithmonë.

Enkeleid Alibeaj, deputet



“Sot në datën 10/10/1947 ora 03:00 paradite, prokurori i shoqëruar dhe nga ndihmësit shkuan në burg dhe morën në dorëzim të pandehurit e dënuar me vdekje. Shefqet Beja, Riza Alizoti, Sulo Klosi, Selaudin Toto, Irfan Majuni, Enver Sazani, Sheh Ibrahim Karbunara, Hysen Shehu, Agathokli Xhitoni, Abdyl Kokoshi, Salim Kokalari, Beqir Çela, Mehmet Prishtina, Paolo Saggioti, Tefik Deliallisi dhe Pertef Karagjozi. Mbas u siguruan për identitetin e tyre, të shoqëruar edhe nga rojet, shkuan në vendin e caktuar për ekzekutimin e të pandehurve. Mbas kënduan vendimin e gjykatës së lartë nr. 187 - 27/9/1947, që dënon të gjithë të pandehurit të lartë përmendur me vdekje, mbasi i kënduan shkresën e presidiumit popullor numër 180 - 10/10/1947, që refuzon lutejet e tyre për falje dhe mbasi u pyetën dhe thanë fjalën e fundit, në bazë të vendimit të mësipërm, në orën 14:30 urdhëroi ekzekutimin e tyre. Me vdekje në litar: Shfqet Beja, Riza Alizoti, Sulo Klosi. Me vdekje: Selaudin Toto, Irfan Majuni, Enver Sazani, Sheh Ibrahim Karbunara,

Hysen Shehu, Agathokli Xhitoni, Abdyl Kokoshi, Salim Kokalari, Beqir Çela, Mehmet Prishtina, Paolo Saggioti, Tefik Deliallisi dhe Pertef Karagjozi. Pasi u krye ekzekutimi, mjeku konstatoi vdekjen e të gjithë të pandehurve”.

Këto janë pjesë nga procesverbali i ekzekutimit të deputetëve opozitarë. Ishin deputetë opozitarë, u dënuan vetëm për faktin e vetëm se ishin kundër komunizmit, se kishin vizion perëndimor, promovonin idetë liberale, ekonominë liberale, forcimin e nismës private, demokracinë pluraliste, afrimin e Shqipërisë me botën perëndimore dhe fuqizimin e parlamentarizmit. Bashkë me ekzekutimin e tyre dhe burgosjen e tyre, u ekzekutua dhe u burgos liria, humbi fjala e lirë, u venit shpresa, u asgjësua sistemi i drejtësisë, u ndërpre aspirata perëndimore, u topit një popull i tërë me zjarr dhe me hekur, për 45 vite. Memoria e shoqërisë sonë vazhdon të jetë ende fatkeqësisht në letargji. Një shkëndijë e shndritshme është edhe iniciativa e zonjës Sulo, të cilës i shkojnë edhe falënderimet e mia personale.

Sot pas 70 vjetësh nisur nga ai episod, besoj se është koha e duhur për të pasur një reflektim të sinqertë, të kthjellët, një reflektim të të gjithë shoqërisë shqiptare. Së pari, një reflektim për historinë e shkuar të këtij vendi, të këtij treçerek shekulli. Nuk ja arritëm ta shkruajmë historinë tonë ashtu siç është, pa gjyftime, pa manipulime, pa përdorime politike. E kemi keqpërdorur dhe shpërdoruar historinë, duke krijuar tension dhe acarim, duke deformuar vetë konsistencën morale të këtij populli e duke i bërë shërbimin më të keq të sotmes dhe të ardhmes. Duhet të gjejmë forca të reflektojmë, duhet të pranojmë hapur se nuk kemi jetuar krimet e komunizmit, se autorët e krimeve të komunizmit nuk janë përballur me drejtësinë, se viktimat e komunizmit ende nuk e kanë dëgjuar fjalën falje. Ne, si shoqëri, nuk kemi rivlerësuar komunizmin, nuk kemi purifikuar të kaluarën tonë.

Sot, edhe për këtë arsye, kemi motiv shumë të fortë të përkujtojmë opozitarët e asgjesur në vitin 1947. Jeta dhe

vepra e secilit prej tyre na thërret të reflektojmë për gjendjen ku jemi sot. Të kthejmë kokën pas. Të mos harrojmë për asnjë moment egërsinë e regjimit komunist, si dhe pasojat e tij në shoqëri. Të kuptojmë se, po nuk pranuar të shkuarën ashtu siç është, e kemi të pamundur të ndërtojmë një të ardhme të paqhtë.

Së dyti, na duhet një reflektim, një reflektim për tranzicionin. Prej 27 vitesh, vazhdojmë të përkundemi nën idenë iluzive të një sistemi të lirisë dhe demokracisë, ndërkohë që sistemi i vlerave morale të shoqërisë shqiptare është tërësisht i munguar, apo është në bjerrje e sipër. Sot zhvillohemi për inerci, në ujëra të turbullta të vlerave morale pothuajse të përmbysura. Kemi humbur ndjesinë e të identifikuarit të asaj çka është e vërtetshme dhe të qortimit të asaj çfarë është ves. Individualizmi egosit mbretëron i pashqetësuar në një shoqëri gjithnjë e më të pandjeshme ndaj së keqes dhe produkti është ai që shohim përditë. Disfunsione të rënda të shtetformimit, mungesë e orientimit të qartë mbi vlerat euro-atlantike, të lirisë dhe të drejtave të njeriut, provokime diabolike drejt rrëshqitjes në arbitraritet diktatorial. Nëse nuk e bëjmë një reflektim të tillë, me gjasë, në këtë det të trazuar, do të endemi për shumë kohë. Por, një reflektim i tillë mund të fillojë që sot, duke marrë shkas nga kjo ngjarje e 70 viteve më parë.

Askush nuk duhet të mendojë se duke shikuar syçelë atë çfarë komunizmi i shkaktoi këtij vendi, mbartet me vete ndonjë emocion hakmarrjeje. Jo! Porse drejtësi ligjore për ç'ka dhe ndaj kujt i është shkaktuar duhet dhe do të ketë. Ashtu siç edhe çdo popull i civilizuar, në Lindje apo Perëndim, tashmë e ka bërë. E po kështu, askush nga ata që prej komunizmit e pësuan, ata sipër, nuk do të duhet të ndejnë asnjë kompleks për ta shndërruar në një ideologji të vërtetë antikomunizmin. Se tek sa flitet për antikomunizëm, nuk bëhet fjalë për skalionime të paqena në pozicione politike. Jo! Tek sa flitet për antikomunizëm, si ideologji politike, bëhet fjalë për rreshtime pro ose kundër ndaj vlerave morale të shoqërisë. Antikomunizmi i filluar që prej

70 viteve më parë, qëndron fort edhe sot. Ndoshta më fortë se sa më parë. Si katalogu i vërtetë i vlerave më të shëndosha properëndimore të një shoqërie të brishtë si kjo e jona. Herët apo vonë, siç duket vonë, do të duhet të kalojmë nga ky shteg.

Së fundmi, një reflektim për të sotmen dhe për të ardhmen. Një reflektim që duhet së paku në emrin tim, për aq sa më takon, ta shprehja me kërkimin e një ndjesë. Ndjesë, për të cilën do të doja të ftoja çdo njeri, brenda apo jashtë kësaj salle, për çdo shqiptar dhe çdo njeri që ia do të mirën këtij vendi, ta kishte një brejë të tillë ndërgjegjeje. Ndjesë, që dhe pas 27 vitesh nga rënia e komunizmit, Shqipëria është ende shumë larg standardeve të shtetit të demokracisë liberale. Ndjesë, që edhe pas 27 vitesh nga rënia e komunizmit, në Shqipëri pluralizmi politik është në rrezik. Ku krimi lulëzon dhe vota vidhet. Ku vota vidhet dhe shtypi i lirë blihet apo dhunohet. Ku fjala e lirë dhunohet dhe popullit i serviret propagandë. Ku opozita denigrohet dhe këtu brenda të drejtat i mohohen. Ku programet dhe idetë zëvendësohen me tallje dhe fyerje masive të inteligjencës së shoqërisë. Ku institucionet po zëvendësohen me idetë e klasës punëtore. Ku ligjet, këtu në Kuvend, shkruhen keq, ashtu si në vitin 1947. Miratohen vetëm me ndreqje stilistike, apo si në vitin 1947. Ndjesë pra, që si në vitin 1947 opozita, shoqëria, institucionet, e ardhmja e këtij vendi është sot në udhëkryq. Megjithatë, sot, ndryshe nga 70 vite më parë, ka një gjë që nuk është më si atëherë. E dimë se cila është rruga e duhur. E dimë këtë në sajë të veprës së shndritshme dhe fatit të zi të deputetëve të vvarë dhe fatit skëterrë të një populli të tërë. Do të ishte shaka e hidhur që ky popull të pësonte të njëjtin fat. Kjo e sotmja, për këtë arsye, nuk duhet të mbetet një ditë e zakonshme përkujtimi. Përkujtimi i tyre do të duhet të jetë i përditshëm dhe është një peshë shumë e madhe që duhet të shoqërojë çdokënd nga ne, që fati e ka sjellë t'u përgjasojë atyre deputetëve. Faleminderit edhe një herë deputetëve të vitit 1947, i paharruar qoftë kujtimi i tyre!

Edlira Bode, deputete



Dr. Enver Sazani - 37 vjeç. Mbaron shkëlqyeshëm gjimnazin e Korçës. Kryen studimet e larta për mjekësi, dy vjet në Monpelie, pjesën tjetër në Lion. Specializohet dy vjet të tjera për patologji-radiologji. Anëtar i degës Çlirimi Nacional të Shqiptarëve të Francës. Partizan i Çetës Krujë-Ishëm dhe i Çetës së Pezës. Drejtor i Spitalit Ushtarak. Deputeti legjislativ i parë. Dënohet me pushkatim. Ndalova të këto rreshta tek lexoja për këtë ngjarje tronditëse të historisë së komunizmit në Shqipëri. U hiqet mandati, arrestohen, dënohen, një grup deputetësh të Kuvendit Popullor.

Të gjithë personalitete me kontribut të spikatur në shoqërinë shqiptare, të njohur për intelektualizmin e tyre; me prejardhje të ndryshme shoqërore, arsimore dhe politike, por me idealin e përbashkët për një Shqipëri moderne.

Kërkuan një sistem liberal ekonomik, me iniciativë private të lirë; një sistem arsimor që nuk impononte edukatë ideologjike; kërkuan politikë të jashtme të orientuar drejt perëndimit dhe vendosjen e një demokracie të tipit perëndimor në Shqipëri.

Të zhytur në mjegullën e diktaturës, ata e shikonin aq qartë demokracinë. Dhanë jetën për një sistem që ne s'po

dimë akoma e sot t'i japim fytyrë të pakontestueshme europiane. U akuzuan se ishin armiq të betuar të popullit dhe të pushtetit popullor, se kishin si qëllim përmbysjen me dhunë të atij pushteti, se për këtë bashkëpunonin me armiqtë e jashtëm, me reaksionin e brendshëm, me shtresat e deklasuara e me klerin reaksionar. U akuzuan se ishin spiunë të regjuri, që kishin mbaruar kurse speciale spiunazhi jashtë vendit.

Doktor Enver Sazani kishte studiuar për mjekësi në Francë e kishte ndjekur kurset e specializimit për patologji e radiologji. Sa larg qëndron e vërteta nga akuza, sa ndryshe është objekti nga imazhi. E natyrisht, këto dy realitete, kaq larg njeri-tjetrit, nuk mund t'i bashkonte veçse tortura e tmerrshme e qelive.

Flasin rrobat gjithë koagula gjaku të dr. Sazanit, i cili me kokën e shkrepëseve të djegura në fundin e pjatave i shkruante familjes.

Bën përshtypje idealizmi i një mjeku, në një kohë kur politika ose të nënshtronte ose të vriste.

Këshilli i Gjykatës së Lartë Ushtarake merr vendim. Varje, pushkatim, burgosje përjetë ...

Mbas të gjitha dhimbjeve, vuajtjeve dhe sakrificave ata u ndanë nga jeta, duke i bërë ballë provës së rëndë të kohës. Epilogu më i dhimbshëm do të ishte odiseja e pambarimtë e vuajtjeve të nënave të veja e fëmijëve jetimë, vëllezërve e motrave, familjarëve.

Gruaja franceze dh e vajza e Dr. Enver Sazanit kthehen në Francë; familja e të vëllait dhe e së motrës përndiqen gjithë jetën.

Sa shumë të enjte ne i kemi fyer këto sakrifica!

Armiku i tyre ishte diktatura, ndëshkimi, pushkatimi.

Cilin kemi ne armik? A ka arsye që për ligj kacafytje të padenjë në këtë sallë? Ato pushkatojnë demokracinë! "Kujto vdekjen, që të jetosh". Asgjë e ardhme nuk mund të ndryshohet, pa nxjerrë mësimet historike nga e kaluara.

Ligji i parë moral, që mjeku përvetëson kur ndërmerr mbi supe profesionin citon, se jetën do ta verë në shërbim të humanitetit. Historia e Dr. Enver Sazanit kumton se deputeti "është përgjegjës përpara nderit dhe ndërgjegjes së tij ...".

Klejdi Mehmetaj, deputete



Kjo mund të jetë, ndoshta, hera ime e parë që flas publikisht për këtë kapitull kaq të errët të Shqipërisë. Për një nga diktaturat më të egra që janë përjetuar në Evropë, por edhe më gjerë. Dua të jem shumë e sinqertë me ju. Jam e emocionuar dhe njëkohësisht e ndrojtur kur ju drejtohem. Pasi flas si një e re e lindur pas viteve '90-të, së cilës nuk i është dashur të përjetojë në kurrizin e saj, as frikën dhe as vuajtjen e atij sistemi. Flas e ndrojtur, sepse shumëkush prej jush sot, sidomos ata që kanë vuajtur brenda familjes së shtëpisë së tyre pasojat e asaj kohe, do të mendonin e do të thoshin me veten : “Eh ç’mund të thotë kjo vajzë e re?”; “Ku e di ajo se ç’kemi kaluar ne?”. Shumë i drejtë është konstatimi juaj, unë nuk e di dhe nuk e kam përjetuar. Por, mendoj se ne të rinjtë do të jemi ndihmesa më e madhe, ndoshta ilaçi më i mirë, për të shëruar plagët dhe dhimbjet e së kaluarës. Më të ftohtë e më të shkujdesur, ne të rinjtë mund ta shohim të vërtetën në sy. Ta gjykojmë drejt e të mos kemi frikë nga ajo e vërtetë dhe nga pasojat, që ajo mund të sjellë.

Unë vetë vij nga një familje, ndoshta, si nga ato më tipiket shqiptare. Me stërgjyshër e gjyshër partizanë, dikur miq shumë të mirë të kësaj Shqipërie, më pas të vrarë e të internuar. Po ashtu, me disa kushërinj të përkatësive të tjera politike dhe në fund të ditës, me vitet që kalonin, e gjithë familja vuante pasojat, pikërisht, të bindjeve të ndryshme politike të anëtarëve të familjes. Kjo ishte Shqipëria. Kjo ishte Shqipëria atëherë, këto ofronte. Një regjim diktatorial të pamëshirshëm, gjakatar, të etur për pushtet të përrjetshëm, të vetmuar e izoluar në Europën që zhvillohej çdo ditë e më shumë në demokraci.

Unë lexoj, kërkoj, hulumtoj, përpiqem të gjej në copëza dëshmish, librash, ditarësh e procesverbalesh fjetet që lidhin ngjarjet. Të gjej kuptimin dhe përherë përfundoj duke gjetur vetem moskuptimin. Janë 36-të vetë të akuzuar këtu, në këtë gjyq, katër grupe, tre prej të cilëve kanë vetëm një gjë të përbashkët, një shënim të nisur aleatëve për të shtyrë zgjedhjet në mënyrë që një koalicion demokratik të marrë pjesë në to. Nuk ka pasur asnjë synim për rrëzim të qeverisë, ishte thjesht për të pasur zgjedhje demokratike.

“U ktheva në vendin tim. Ata më pyetën për një fjalë të fundit, unë kërkoja drejtësi. Gjyqi zgjati 15-të ditë, në fund gjykata dha dënimin, 20 vjet dhe unë isha e burgosur”. Këto janë fjalët e Musine Kokalarit, të parës grua kryetare të një partie politike në Shqipëri, pjesë e një familje që kishte luftuar për të çliruar vendin, edhe vëllezërit e së cilës ishin vrarë pa gjyq nga pushteti i pasluftës. Kështu shkoi jeta e dijetares dhe e politikanes shqiptare Musine. Në pranga dhe në internim deri në ditën e fundit të jetës së saj. Rasti i Musinesë luftarake dhe i shokëve të saj i parapriu asaj që ndodhi një vit më pas, në 10 tetor 1947, ku deputetëve opozitarë vetëm e vetëm se kërkonin një Shqipëri demokratike të zhvilluar e të begatë iu hoqën mandatet dhe u arrestuan, u varën apo u pushkatuan.

Kjo ditë njihet si një nga më të dhimbshmet e diktaturës, kjo është një nga ngjarjet më tronditëse të historisë së komunizmit në Shqipëri.

Djem të rinj, të shkolluar mirë, burra intelektualë, patriotë që sakrifkuan veten. Për çfarë? Për të kërkuar demokraci në këtë vendin tonë. E paimagjinueshme është në kohën që ne jetojmë sot, në demokracinë tonë, që deputetit t'i mbyllet goja e jo më t'i merret jeta. Po aq e paimagjinueshme ishte në atë kohë që deputeti të fliste për të drejtat e njeriut, për shtypin e lirë, për ekonominë e tregut dhe të drejtën e pronës.

Pikërisht në këtë kontrast duhet të ndalemi pak më gjatë, ne. Sepse ka ditë kur na duket se ky rend po prishet dhe ajo ç'ka ishte normë e diktaturës në të shkuarën, po kthehet e modernizuar, por e njëjtë në normë parlamentare dhe qeverisjeje në këtë të tashmen tonë. Në rreshtat e atyre që kanë shkruar e demaskuar krimet e komunizmit, e specifikisht me atë lidhur me dënimin e deputetëve opozitarë, nënvizova këtë që po citoj më poshtë "Ata ranë viktimë e politikës së pamoralshme ndërsa vetë ishin misionarë politikë, që në çdo platformë politike mbanin kurdoherë përpara moralin e duke parë se ku na çoi politika e pamoralshme duhet të bëjmë tepër kujdes në të ardhmen, se një gabim historik sakrifikon sa e sa breza . Janë raste historike që përsëriten dhe kanë rëndësi të madhe pse Makbethët dhe Jagot që kërkojnë tragjedi të reja fatkeqësisht mund t'i kemi ende në mes nesh, e fatkeqësisht këto fjalë janë krejt të vërteta. Sepse mes nesh kemi sot, ndoshta dhe fillosat e një diktature të re, të një lloji tjetër, jo nga ato që vrasin me plumba dhe të varin me litar. Por, nga ato që veten e konsiderojnë heronj, Skenderbe dhe popullin e konsiderojnë me banda të fortësh. Ndoshta po na krijohet nga ai lloj diktatori që përdor flamurin në fushatë e bën patriotin, ndërkohë që, më pas, e var popullin dhe qytetarët në litarin e taksave

dhe tvsh-ve apo i merr haraçin e pushtetit, paratë e bukës sonë të përditshme, për tendera dhe koncesione. Po përjetojmë fillosat, ndoshta në gjykimin tim, të një diktature që gjyqin nuk ia lë gjyqtarëve, por e bën vetë, madje publik, me kamera, me televizione, nëpër zyra institucionesh publike, duke sharë e duke vrarë ndoshta në kuptimin modern të fjalës, duke pushuar dhe emëruar me pushtetin që i ka dhënë paraja dhe jo vota e lirë, ditën për diell, këtu në sytë tanë. E mund të flisja shumë për këto diktatura të reja që po krijohen, që përpiqen të mbajnë dhe pengojnë fjalën e deputetit në parlament, që blejnë median e lirë, që bëjnë ndoshta presione me bishtin e lugës të atyre që quhen televizione publike. Por ja që mendoj, se kjo është pikërisht ajo që duhet të luftojmë ne sot. Sepse edhe kjo diktaturë e re është po aq e rrezikshme sa ajo që ne mposhtëm 27 vite më parë. Jam mëse e sigurtë që ju do të mendoni se unë dola pak nga tema, por si deputete e re, në reflektimet e mia, doja të ktheja atë që ishte e shkuar për ta sjellë në ditët e sotme. Ku ndoshta edhe unë, si deputete, ndihem e frikësuar që s'mund të konkurrojë e lirë, që s'mund të jem e qetë, sepse përballë nuk kam ata njësoj me mua, por ata që përparësi kanë të fortin dhe paranë, ndaj nga kjo ditë e sotme, përveç se të nderojmë dhe të përulemi përpara atyre që dhanë jetën e tyre, për të sjellë demokracinë në këtë vend, unë do të thosha të reflektojmë që të pengojmë që ajo që ndodhi për shumë vite në Shqipëri të kthehet sërish dhe të na zërë frymën.

Fatmir Mediu, deputet



Komunizmi është vdekja e shpirtit, është konformizmi me tiraninë, i angazhuar për ta bërë këtë tirani universale, do të thoshte Stiven Jobs, një politikan i shquar amerikan i fillimit të shekullit. Në Shqipëri komunizmi ishte shkatërrimi total i vlerave më të shenjta njerëzore, jetës, lirisë, dhe lumturisë. I drejtuar nga një klasë politike e çmendur, që mohoi besimin në Zot për ta zëvendësuar atë me ideologjinë komuniste. Për fatin e keq, komunizmi është prezent edhe sot, jo vetëm si hije, por si mentalitet, veprim, gjykim, vendime dhe në këtë parlament dhe në qeverisje. Deputetët që u pushkatuan ishin intelektualë, mendje të ndritura, të shkolluar në universitetet perëndimore. Ata vinin nga familjet që krijuan identitetin tonë kombëtar ndër vite, firmtarë të pavarësisë, prandaj ata dhe historia e tyre duhej të shuheshin. Ata besonin në vlerat perëndimore dhe me kurajë vendosën të përballen me diktaturën komuniste duke sakrifikuar jetën në emër të lirisë së çdo shqiptari. Ata u ekzekutuan, familjet e tyre u dënuan, u internuan në kampet e përqendrimit. Ata

ishin simbol i rezistencës, por edhe frymëzimi i njerëzve të lirë. Ekzekutimi i tyre nuk ishte siç u tha këtu nga kapiteni i trupit gjykues. Ekzekutimi i tyre ishte nga diktatori Enver Hoxha dhe të gjithë ata që ishin pranë tij.

Ata ndërmorën sakrificën ekstreme në emër të besimit hyjnor për jetën dhe lirinë, dashurinë për familjen dhe kombin e tyre si komb europian. Liria ishte forca, mbi të cilën ata besonin se mund të ndërtohej lumturia personale dhe shoqërore. Ata janë historia e të vërtetës. Të vërtetës së dhimbshme të mijëra familjeve të kombit tonë, të vërtetat e mizorisë dhe shëmtisë së diktaturës dhe të kastës komuniste. Ata janë po ashtu një barrë ndërgjegjeje e madhe për të gjithë ne, por mbi të gjitha, ata janë një thirrje e fortë për koshiencën e kombit shqiptar, për të thënë dhe shkruar historinë me të gjithë të vërtetën e saj.

Me mijëra u pushkatuan, gra dhe burra në emër të popullit. Me mijëra u internuan në kampet e përqendrimit në emër të popullit. Mbi 400 klerikë u ekzekutuan po në emër të popullit. Mbi 4500 u pushkatuan pa gjyq dhe nuk u gjendet as varri, po në emër të popullit. Të gjitha u bënë në emër të popullit dhe kundër popullit dhe edhe sot vazhdohet të flitet në emër të popullit. Po populli nuk është më turmë, populli është çdo qytetar i këtij vendi që duhet të gëzojë lirinë, jetën dhe dinjitetin. Të nderuar kolegë deputetë, duke pasur parasysh sasinë e pashembullt të vuajtjeve që komunizmi ka shkaktuar, lind natyrshëm një pyetje. Pse komunizmi është shumë më pak i urryer se sa Nazizmi? Komunistët vranë 70 milionë banorë në Kinë, më shumë se 20 milionë në Bashkimin Sovjetik, 5 milionë në Ukrainë dhe pothuajse 1 në çdo 3 kamboxhianë, vranë dhjetëra mijëra këtu në Shqipëri. Komunistët robëruan kombe të tëra si Rusinë, Vietnamin, Kinën, Europën Lindore, Korenë e Veriut, Kubën dhe më shumë në Shqipërinë tonë. Ata shkatërruan jetën e më

shumë se një miliardë njerëzve. Atëherë pyetja është përse komunizmi nuk dënohet me forcën që duhet?

Arsyeja e parë, në gjykimin tim, është sepse komunizmi është akoma prezent si mentalitet dhe praktikë e sundimit dhe mohimit të lirive të qytetarëve. Arsyeja e dytë, sepse krimet e komunizmit mbulohen, historia dhe krimet e saj komuniste nuk mësohen në shkolla dhe jo rrallë justifikohen nga politikanë deri në akademikë, në thonjëza. Arsyeja e tretë, sepse teoria komuniste edhe sot me fjalë të bukura josh intelektualë dhe historianë, të cilët i konsiderojnë krimet e komunizmit si më pak të rëndësishme sesa fjalët. Madje, i justifikojnë ato si shtrembërime të komunizmit të vërtetë. Arsyeja e pestë, meqenëse këtu kemi ambasadorin e nderuar gjermane është se, gjermanët patën kurajën dhe ndërgjegjen kombëtare për të paraqitur dhe dënuar tërësisht të keqen e nazizmit, kanë marrë përgjegjësinë për ta. Ndërsa në Shqipëri, diktatori, për turp, është heroi i popullit. Lenini babai i komunizmit sovjetik është ende i nderuar në Rusi, po ashtu mbetet Mao Ce Duni në Kinë, po ashtu mohohet edhe holokausti që krijoi Stalini. Arsyeja e gjashtë, në gjykimin tim, është se komunistët vranë kryesisht popullin e tyre. Dhe kjo çështje ngelet pjesë e ndërgjegjësimit dhe reagimit të çdo kombi, në radhë të parë brenda vetes së vet.

Pavarësisht se komunistët synonin të vendosnin tiraninë universale, për sa kohë të këqijat dhe mizoritë e komunizmit nuk do të pranohen, ai do të jetë gjithmonë prezent, dhe i gatshëm për t'u ringjallur, me teori nga të gjitha llojet. Të Antonio Gramshit apo populizmin e çavizmit që shikojmë tashmë të ringjallur edhe në Shqipëri, të lidhura me interesa politike të pushtetit, por dhe një lëvizje të majtë gjeopolitike. Ndërsa e majta politike dhe të gjitha institucionet e ndikuara prej saj, nuk do të pranojnë se sa çnjerëzor dhe kriminal ka qenë

komunizmi, ne do të jetojmë në një botë jo vetëm me politikë imorale, por do të vuajmë pasoja jo të vogla. E nuk jemi në gjendje tu kthejmë shqiptarëve të persekutuara politikisht ata që humbën, jetën, lirinë dhe vitet e kaluara në burg. Ne nuk jemi në gjendje t'i bëjmë ata të harrojnë dhimbjet e shaktuara nga ferri komunist. Por, ne duhet të gjejmë mënyra t'u japim atyre nderin që ju takon, dhe jo lëshim të kompensimit, as hipokrizinë e politikës.

Ne jemi mbledhur të nderojmë sakrificën e këtyre njerëzve të rrallë, por meqë jemi këtu në sallën e këtij Kuvendi, le të kryejmë hapin e parë dhe t'i kursejmë atyre hipokrizinë. Le të mblidhemi të gjithë së bashku, të majtë e të djathtë, e t'i heqim titullin “Hero” diktatorit Enver Hoxha. Të dënojmë atë që ai ka bërë por, për turpin e historisë dhe të politikës, ai është akoma “Hero i popullit”. E dyta, ky Kuvend duhet patjetër të marrë një përgjegjësi morale. Gjithsecili deputet le të shkojë pranë atij institucionit përkatës dhe të plotësojë formularin e pastërtisë së figurës, për të treguar se nuk ka asnjë lidhje me të kaluarën dhe e dënon atë si një akt të tijin personal moral, në radhë të parë, dhe pastaj si një akt kolektiv të këtij Kuvendi.

Më lejoni ta mbyll fjalën time duke sjellë në vëmendjen tuaj, ashtu si parafolësja, se diktatura dhe tirania e shumicës kanë shumë të përbashkëta. Ato kërkojnë kontrollin e shoqërisë nëpërmjet frikës dhe varfërisë. Kontrollin politik, nëpërmjet monopoleve ekonomike, korrupsionit dhe krimit. Prandaj, në këtë situatë që jemi, ka nevojë që jo vetëm të kujtojmë të shkuarën, të respektojmë ata që u sakrifkuan në emër të lirisë së jetës dhe në emër të besimit, por të punojmë për të bërë atë që është më e mira, që çdo shqiptar të gëzojë të drejtën e tij të lirisë, jetës, dhe ndërtimit të lumturisë.

Eglantina Gjermeni, deputete



Sot, kam zgjedhur të flas për një zonjë. Për një zonjë të nderuar, e cila sigurisht nuk jeton më. Nuk ishte në grupin e deputetëve që u vranë, por u gjykua dhe pati një fund tragjik si shumë e shumë të tjerë që nuk ishin dakord me regjimin e asaj kohe. Do të flas për zonjën Musine Kokalari. Jo thjeshtë se ishte një grua e nderuar, jo thjeshtë se këtë vit ka 100-vjetorin e lindjes së saj, por edhe se njihet si emblema e qëndresës ndaj komunizmit. Janë të rralla gratë në shoqërinë shqiptare të viteve 1930-40, që kanë guxuar, përmes veprës së tyre, të emancipojnë jo vetëm kulturën, por edhe politikën Shqiptare.

Për establishmentin politiko-shoqëror të atyre viteve, që lëkundej mes formulës së skicës së njohur të Migjenit, "Sokrati i vuajtur" apo "Derri i kënaqun", një pakicë zgjidhte të parën. Me pasionin dhe dashurinë për letërsinë, të kultivuar nga familja e saj dhe përmes arsimimit në institutin Qirjazi, e më pas në institutin e ciklit të mesëm "Nëna mbretëreshë", Musine Kokalari, në zgjedhjen mes ideales dhe materiales, mes lëndës dhe

shpirtit, përmes shkrimeve të saj shpallte, si devizë të mendimit të kohës, të shpëtojmë sa më shumë nga vlerat morale. Mesazh aktual edhe sot, besoj.

E njohur si e para shkrimtare në Shqipëri, madje e vetmja deri në vitet 1960, Musine Kokalari, nën pseudonimin “Muza”, gjatë viteve 1930 kontribuoi, jo vetën në trajtimin e temave për konservatorizmin në shoqërinë shqiptare por, në të njëjtën kohë, i bëri veprat e veta monumente të vërteta leksikore të të folurës së Gjirokastrës dhe të jugut të Shqipërisë.

Vepra e saj e parë profesionale letrare, “Siç më thotë nënua plakë”, e shkruar në vitin 1939, konsiderohet të jetë dhe vepra e parë letrare e shkruar dhe botuar nga një grua shkrimtare në të gjithë historinë e vendit. Forca e veprës së Musine Kokalarit qëndron në atë, që poeti Lasgush Poradeci, e cilëson me përkufizimin poetik “Zanja e jetës”. Gruaja shqiptare e Musine Kokalarit duhet të luftonte për jetën, sepse, siç shkruante ajo, gruaja sot, nga bota e perënduar e djeshme, kërkon të jetë përgjegjëse për veten e saj dhe të marrë pjesë në të gjitha ngjarjet e kohës.

Pas diplomimit me rezultate të shkëlqyera në Universitetin “La Sapienza” të Romës, në fakultetin e Letërsisë Moderne, Musine Kokalari, pas përfshirjes në lëvizjet antikomuniste dhe antifashiste në Romë, kthehet me të njejtat bindje në Shqipëri. Si pjesë e nismës antifashiste në Shqipëri, ajo jep ndihmesën e saj në botimin e revistës “Gruaja shqiptare”, në qershor të 43-shit, nën pseudonimin “Taçita”. Në të njëjtin vit, krijohet partia Socialdemokrate e Shqipërisë, pjesë e së cilës ishte Musineja, si themeluese dhe frymëzuese kryesore e këtij entiteti politik. Musine Kokalari ishte një nga bashkëthemelueset e grupimit Socialdemokrat në Shqipëri. Një grupim, që përfaqësonte një rrymë të moderuar të së majtës shqiptare, e cila ishte për një evolucion të shoqërisë shqiptare, pa qenë e

nevojshme të ndërmerreshin masa ekstreme të kopjuara nga sistemi komunist në Bashkimin Sovjetik.

Kur lexon historinë e jetës së saj ndihesh keq, madje shumë keq, sesi as përpjekja e saj dhe as e gjithë këtyre intelektualëve të tjerë, kaq të shquar, të guximshëm, largpamës të kohës, nuk mundën të ndikonin në ndryshimin e fatit të Shqipërisë pas Luftës së Dytë Botërore. Në vitet 1945-46, Musinesë ju desh të përballej jo më thjesht me konservatorizmin në shoqërinë shqiptare, por me ashpërsinë dhe terrorin politik shumë herë më të vështirë dhe tragjik sesa betejat me konservatorizmin e shkrimeve të saj. Dëshira e saj për një Shqipëri ndryshe, ku të kishe drejtësi shoqërore dhe me shumë liri politike, ishte një dëshirë që nuk përshtatej me shërbimin komunist të kohës. Ishte një dëshirë që e ndëshkoi rëndë Musine Kokalarin.

Ajo arrestohet më 23 janar të vitit 1946. Ndonëse në tortura të vazhdueshme, Musineja nuk hoqi dorë nga bindjet e saj për një sistem pluralist dhe shoqëri të lirë, të cilat i shfaqti me guxim dhe me fjalën e saj në procesin gjyqësor. Ballëllartë për idetë e saj, shfaqet ajo edhe në foton që memorizon, në fakt, mbrojtjen e saj në gjyq, ku deklaroi me një kurajo të pashoqe intelektuale dhe njerëzore se: “Unë nuk kam nevojë të jem komuniste të dua vendin tim. E dua vendin tim edhe pse nuk jam komuniste. Unë e dua për parimin e tij. Ju jeni duke më ndëshkuar për idealet e mija”. Përpjekjet e saj për të mbrojtur vlerat morale të shoqërisë së pasluftës nuk e shpëtuan dot nga dënimi me 25 vjet burgim, nga të cilat 16 i kaloi në burg, në fakt, si dhe me persekutim të përjetshëm.

Në vitin 1962, Musineja u transferua nga ambientet e burgut në internim në Rrëshen, ku u detyrua të punojë në punë të rënda ndërtimi në kushte shumë të vështira, nën vëzhgim të rreptë. Kjo përndjekje e vazhdueshme dhe

mungesa e kushteve më minimale ndikoi drejtpërdrejtë në aktivitetin letrar të Musinesë, i cili u ndërpre në mënyre brutale. Vetëm në vitin 1972, Musine Kokalari arriti të përfundonte në fshehtësi një libër të saj të titulluar “Si lindi partia socialdemokrate”, ku ajo shpjegon pikëpamjet e saj antikomuniste dhe shpjegon alternativën e saj progresiste dhe demokratike.

Arriti ta ruante këtë vepër përmes një seri shkrimesh që ia dërgoi nipit të saj Platon Kokalarit, me tematikën “të shpëtojme sa të mundemi nga vlerat morale”. Në vitin 1983, disidentja e parë shqiptare, Musine Kokalari, humbi betejën e saj me vdekjen, prej moskurimit të kancerit të gjirit, në dhimbjet dhe vuajtjet e shumta të jetës.

Një zë i fuqishëm femëror, një intelektuale e vërtetë, do t'i kishte dhënë më shumë vepra Shqipërisë në letërsi dhe në politikë. Më shumë emancipim vendit të saj, bashkëatdhetarëve të saj, nëse ata do ta donin po aq sa i deshi dhe ajo. Në vetminë e jetës, ajo nuk ndihej vetëm, se bisedonte me njerëz të ditur e demokratë, që punuan shumë për vendin edhe përmes fotove të tyre, sepse vërtet ndihej nxënëse e të ndriturit Sami Frashëri. Ishte krenare për këtë. Si të tillë e kujtojmë sot. Me nderim dhe mirënjohje të thellë, duke besuar që shoqëria shqiptare, për më tepër politika shqiptare, të ketë mësuar t'i japë vendin që u takon njerëzve, që kontribuojnë për përparimin e saj dhe të mos lejojnë që kjo histori e trishtë dhe tragjike të përsëritet sërish.

Nora Malaj, deputete



“Të mos kemi frikë nga e shkuara për të ndërtuar një të ardhme të sigurt”

Seancën e sotme të veçantë, dedikuar veprimtarisë përkujtimore me rastin e përkujtimit të 70-vjetorit të ekzekutimit të “grupit të deputetëve”, do ta vlerësoja si një nga ngjarjet më të rëndësishme dhe pse jo më të veçanta në fillimin e këtij sezoni parlamentar. Rëndësia e kësaj seance, lidhet me atë çfarë këta deputetë dhanë për të gjithë ne sot, me nevojën dhe domosdoshmërinë që t’i rikthehemi historisë, për të njohur të vërtetat, pa pasur frikë nga e kaluara, për ta pranuar atë ashtu siç ka ndodhur dhe për të vlerësuar çdo individ për atë ç’ka bërë për vendin e tij, në emër të lirisë dhe të demokracisë, në emër të shenjtërisë së votës dhe idealeve për një jetë më të mirë, me të drejta dhe liri pa kufi.

Historia e botës, po edhe ajo e Shqipërisë, e një vendi që lindi në kapërcyellin e lindjes dhe perëndimit, s’është gjë tjetër veçse biografia e heronjve që bëjnë historinë e vendit të tyre, e atyre njerëzve të thjeshtë, por që bënë

vepra të mëdha, të atyre atdhetarëve, që e deshën vendin dhe nuk u tutën në asnjë çast nga askush. Në figurën e secilit prej tyre shoh të shfaqet bota e tyre shpirtërore, si ikona të lëvizjeve masive dhe demokracisë së një vendi. Regjimet totalitare komuniste, që sunduan në Evropën Qendrore dhe Lindore, në shekullin e fundit dhe të cilat janë ende në pushtet në disa vende në botë kanë qenë, pa përjashtim, të karakterizuara nga shkeljet masive të të drejtave të njeriut. Shkeljet ndryshonin në varësi të kulturës, të vendit e periudhave historike dhe kanë përfshirë vrasje dhe ekzekutime individuale e kolektive, vdekje në kampet e përqendrimit, uri, dëbime, tortura, skllavëri të punës së detyrueshme dhe forma të tjera të terrorit masiv fizik, persekutim në baza etnike ose fetare, shkelje e lirisë së ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes, lirisë së shtypit, si dhe mungesë e pluralizmit politik.

Me gjithë tendencën e përgjithshme drejt globalizmit, integritit dhe bashkëpunimit, bota s'ka pushuar ende së penguari veten në ngritjen e mureve. Ne si komb, akoma më shumë. Jeta dhe komunikimi ynë i përditshëm është i mbushur me jo pak të tillë. Mure që shihen dhe mure që s'ka nevojë të ngrihen, mure të trashëguara dhe mure të imagjinuara. Kufiri, që dikur ndau botën, sot na ndan nga njëri-tjetri. Jeta na ka mësuar, se atje ku ka mure të ngritura, ka ndarje, atje ku ka ndarje ka zhgënjime, ka frikëra, pengje, varre... Historia jonë e mbushur me mure dhe kulla, mbyllur me kufij dhe bunkerë, rrethuar me male dhe prita, na ka mësuar të dallojmë muret mbrojtëse, nga muret mbytëse. Nëse do ta shohim në këndvështrimin historik, do të vërejmë se ky gjyq, i këtyre martirëve të demokracisë, përbën "gongun" e tragjedisë së re shqiptare. Ky gjyq dha verdiktin final kundër demokracisë, solli njeriun "model", që jo vetëm mos të guxojë të veprojë, por as të flasë, as të dëshirojë dhe as të mendojë atë që nuk e pëlqen partia në pushtet, duke dyzuar e zvetënuar keqas

njeriun fisnik shqiptar. Ajo që ishte më e frikshme, goditi për vdekje inteligjencën e sapoformuar. Ajo u mundua të vrasë lirinë dhe shpirtin e lirë shqiptar. Gjyqi politik kundër deputetëve demokratë synonte zhdukjen e atyre individëve që kërkonin të vendosej në Shqipëri një sistem demokratik. Një nga deputetët demokratë, që kishte luftuar për çlirimin e Shqipërisë, Shefqet Beja, thotë në gjyq: “Ne donim një pushtet me parimet e demokracisë së Perëndimit”. Gjyqi dënoi me varje: Shefqet Bejën, Sulo Klosin dhe Riza Alizotin. Me pushkatim: Selaudin Toto, Irfan Majuni, Enver Sazani, Sheh Karbunara dhe i biri, Hyseni, Selim Kokalari, Beqir Çela, Mehmet Prishtina, Paolo Sagiotti, Tefik Deliallisi, Pertef Karagjozi. Të tjerët me burgime të rënda.

Çdo mendje e ndritur e kohërave ka lënë trashëgiminë personale. Për disa janë veprat, për disa të tjerë aseti më i madh janë thëniet në letër. Ky gjyq përcaktoi shkëputjen përfundimtare nga Evropa dhe sido që “për inat të saj” ne, që u bëmë “fanar ndriçues” në Evropë, u endëm si çifuti në shkretëtirë, u larguam aq shumë nga Evropa, sa tani dukemi si dy planetë të ndryshme. Ky gjyq vendosi përfundimisht diktaturën e ashtuquajtur “të proletariatit”, ku meqenëse ç’thotë populli bënte Partia, Shqipëria u rrethua me klonet me gjemba, kultivoi burgje e kampe përqëndrimi, zëvendësoi kisha e xhami me tunele e bunkerë, luftoi çdo kulturë e shfaqje të “huaj perëndimore”, duke përfunduar të sfilltur materialisht, shpirtërisht e mendërisht, në krijimin e pseudo “njeriut të ri”. Ndaj është detyrë e të gjithëve që të nxjerrim mësimin e duhur historik nga ky gjyq, nga ky dëm i madh kombëtar! Po mësimet e “MURIT” i kapërcejnë kufijtë e kombit dhe rajonit tonë. Në një botë, ku të gjithë tentojnë drejt njëri-tjetrit, ku bashkëjetesa është nevojë dhe bashkëpunimi garanci, të vetmet mure, që justifikojnë vetveten, janë muret që bien edhe në komunikimin e thjeshtë me njëri-tjetrin. Shekulli XX arriti t’i korrigjonte gabimet e fillimit të vet. Shekulli XXI nuk jetohet dot duke shpërfillur mësimet e paraardhësit.

Ajo quhej Musine Kokalari, 28 vjeçe, lindur ne Adana, Turqi dhe banuese në Tiranë. U lind në një familje intelektualësh, si vajzë e vetme e një juristi të shquar nga Gjirokastra. Kryen shkollën e mesme në Institutin “Nana Mbretneshë”. Vazhdon studimet e larta për letërsi në Romë, diplomohet “Doktor” në letërsi më 28 nëntor 1941, ku edhe i propozohet vend në këtë Universitet. Në vitin 1943, së bashku me Skënder Muçon, krijon Partinë e parë Socialdemokrate, si fraksion i dalë nga Balli Kombëtar. Arrestohet më 16 nëntor 1944, mbahet 17 ditë në godinën te “Selvia” dhe lirohet, sepse 4 ditë më parë, (12 nëntor 1944) i pushkatohen pa gjyq dy vëllezërit e saj Muntazi e Vesimiu, që me 10 veta të tjerë përfundojnë në një varr të përbashkët mbrapa ish-hotel “Bristolit”. Refuzon në vitin 1945 të bëjë pjesë në “Lidhjen e Shkrimtarëve” të Shqipërisë. Rikrijon lidhjet me intelektualët e patriotët antikomunistë duke themeluar grupin “Bashkimi Demokratik”. Arrestohet më 23 janar 1946, nga Skënder Konica e Qemal Balluku, dënohet me 30 vjet burg nga prokurori dhe 20 vjet nga gjykatësi. Te 40 vjetët e “çlirimit” i kaloi në pranga e internime, deri ditën që do të çlirohej vërtet përfundimisht nga mundimet e torturat e pafund me vdekjen. Monografi, libra, skenarë e shumë si këto do të jenë vërtet pak për figurën e madhe, të ndershme e patriote të “bubulinës” shqiptare, vajzës nga Gjirokastra, shkrimtares e publicistes së njohur Musine Kokalari. “Njeriu sa të jetë e mundur të shpëtojë si vlerë morale”, do të thotë Musineja në një nga shkrimet e saj. Nuk di se nga t’ia fillosh! Nuk je në gjendje të mbarosh... Ta filloj nga Musine Kokalari, intelektualja e ndritur e shkolluar në perëndim që përfundoi e burgosur, e internuar dhe pastruese në Burrel për t’u varrosur pastaj me duart e lidhura me tela. Apo lista e gjatë e të gjithë deputetëve martirë, që sot janë edhe dëshmia e gjallë për të treguar se të ndërtosh të ardhmen, duhet të shkuarën ta shohësh drejt në sy, pa droje dhe me kurajon për të jetuar dhe ndërtuar një shoqëri më të mirë. Musine Kokalari do të kujtohet për kalvarin e saj njerëzor, por

edhe si e para shkrimtare shqiptare, si veprimtare politike dhe për të drejtat e gruas, si intelektuale e kohës së vet. Do të kujtohet edhe për vlerat e veprës së vet modeste, por stilistikisht të kulluar, sikurse ka muzikantë që kujtohen për nocturne jo për simfoni, për etyde e impromptu për piano, jo për opera dhe oratorio. Sidoqoftë, ne kemi detyrim dhe përgjegjësinë t'i dokumentojmë ato krime dhe të pastrojmë ndërgjegjen tonë të përbashkët shoqërore nga çdo hije e errët e së kaluarës, duke u mësuar brezave të rinj mbi të kaluarën e hidhur, në mënyrë që ajo të mos përsëritet kurrë më! Le ta fillojmë nga tribuna e këtij parlamenti, për të komunikuar më mirë, për të mbrojtur të drejtën e votës, për të vlerësuar fjalën dhe për të mbështetur aksionin. Për të kuptuar qartë, se fatet e njerëzimit varen nga vetë njerëzit. Le t'u jemi mirënjohës brezave dhe të kryejmë misionin human, për t'i dhënë njerëzimit atë që meriton, shkrimin e historisë, pa frikëra dhe me mesazhin se nuk është pushteti ai që të bën të korruptosh, por frika. Frika se mos humbet pushtetin, korrupton ata që e zotërojnë atë dhe frika e fshikullimit të pushtetit korrupton ata që janë të varur nga ai. Ndaj, kur flasim dhe veprojmë në emër të popullit, duhet jo vetëm ta duam popullin, po ta mbrojmë nga oligarkët, nga frikërat e njerëzve që kanë pushtet absolut dhe mbajtja peng në emër të "luftës" kundra varfërisë. Në fund të ligjërimit tim, në kujtim dhe vlerësim të veprimtarisë, dua të theksoj se grupi i deputetëve edhe sot, na motivon për t'u bërë luftëtarë të mbështetjes së kauzës së mbrojtjes së fjalës së lirë dhe shpirtit të lirë, lejomëni të citoj Sokratin, filozofin e kohërave që thotë: **"Gjithë shpirtrat e njerëzve janë të pavdekshëm, por shpirtrat e të drejtëve janë edhe të pavdekshëm, edhe hyjnorë"**.

E paharruar qoftë vepra e tyre!

Le të jemi pjesë e ndërtimit të një shoqërie më të mirë, pa frikëra, inate, mllafe ballkanike, që nesër historia mos të na gjykojë e ndëshkojë, por të na vlerësojë!

Orjola Pampuri, deputete



Sot është një ditë e shënuar, një ditë reflektimi ndaj të kaluarës së dhimbshme të kombit tonë, ndaj qytetarëve dhe familjarëve të tyre, ekzistenca e të cilëve na bën të ndihemi krenarë. Familje të mëdha e intelektualë të shquar në fushat e tyre, është nder që një komb të numërojë kaq shumë njerëz të shquar. Por, është e dhimbshme që këta njerëz të kenë qenë preja e regjimit hoxhist. Kur intelektualit thërret, kombi ngrihet në këmbë. Por, kur ngrënë kokë diktatorët, të parët që mposhtin se u friken janë intelektualët. Mënyra më e mirë që i paafit, diktatori, narcizisti të mbijetojë është të denigrojë dhe masakrojë intelektualin.

Pas largimit triumfues të regjimit të kobshëm komunist, kujtimet, ngjarjet, figurat, veprat u respektuan e rikujtuuan duke i kthyer borxhin moral viktimave e familjarëve të të afërmve të tyre. Por, sot, 70 vite më vonë, gjendemi përballë një realiteti të hidhur ku figura përfaqësuese të atij regjimi, sot janë pjesë e qeverisë dhe organeve ligjvënëse të këtij vendi duke denigruar figurën e secilit

prej nesh dhe secilit prej tyre.

Ndjem e nderuar që flas sot përpara jush në emër të njerëzve të nderuar të këtij vendi. Në emër të atij grupi të nderuar deputetësh që patën guximin të ngrenë zërin kundër projekt kushtetutës së parë komuniste dhe si përgjigje, morën dënimin me vdekje.

Përpara vlerave të dijes përulen të gjithë. Kush i njeh e i pranon, di edhe t'i respektojë dhe mbështesë. Kush nuk do t'i njohë dhe t'i pranojë e ka të pamundur të shohë përtej mjerimit dhe inferioritetit të tij dhe kush gjunjëzohet ndaj tij, nëse është individ përhumbet, nëse është popull mjerohet.

Shpesh në këtë foltore është pohuar nga deputetë të maxhorancës, që një çështje e tillë është e kaluar dhe nuk mund të përdoret si kauzë nga opozita. Por, është në nderin tim t'ju pretoj ju sot, që rikthimi i dinjitetit, mbështetja pa kompromis e kësaj shtrese do të jetë një ndër kauzat e mia dhe të Partisë Demokratike.

Askush nuk mund t'i kthejë mbrapsht fëmijërinë mamasë time dhe dy dajave të mi. Askush nuk mund t'i përgjigjet vuajtjes së gjyshes time, një zonjë e hekurt që ia doli e vetme vuajtjeve që ai regjim i rezervoi. Ishte vitit 1948 kur dy vëllezër të lindur në Gjakovë, Riza dhe Enver Karoshi, të shkolluar në shkollat më të mira në Shkup dhe Perëndim dhe që nuk mbështesnin regjimin e asaj kohe në ish-Jugosllavi, të përndjekur nga ai regjim atje, u detyruan të arratisen duke lënë gjithçka. Njëri në Egjpit dhe tjetri me not nëpërmjet lumit Drin, për të mos u takuar më kurrë me njëri-tjetrin. Ky i fundit ishte gjyshi im, i cili me shpresën që në Shqipëri do të gjente mbështetje gjeti ferrin e vërtetë. U internua në Llakatund të Vlorës. Disa herë tentoi t'i jepte fund jetës. U largua nga kjo botë pa iu tharë një herë lotët në sy. Nuk tregoi asgjë, madje as formimin e shkollimin e tij.

Historia e vërtetë e tyre u formësua si një pazëll shumë

vite pas vdekjes. Kujtimet e mamasë time dhe dajave të mi shoqërohen vetëm me lot. Kujtimet e mia për ta, mbeten ndër më të bukurat, por shpesh e kaluara, vuajtjet, dhimbjet ishin aq të forta sa më preknin edhe mua. Gjë, mbesës që ata e rritën, gjë, që më bëri të rritesha para kohe dhe t'i qëndroja pranë e ta ndihmoja si të isha vajzë e rritur. Pra si im gjysh dhe akoma më keq, me qindra e mijëra të tjerë janë internuar, persekutuar, torturuar, pushkatuar, në burgjet e Burrelit, Spaçit, Ballshit, Tepelenës. U burgosën më shumë se 34 mijë persona. Mbi 59 mijë persona të tjerë u internuan në kampet më të tmerrshme të regjimit hoxhist, që ua kishte rezervuar kundërshtarëve të tij politikë. Nga këta, mbi 7000 persona kanë humbur jetën, mbi 6000 persona të tjerë u pushkatuan pa gjyq. Nga torturat në burgjet e komunizmit vdiqën mbi 984 persona dhe mbi 308 persona të tjerë kanë humbur aftësitë mendore. Torturat që regjimi hoxhist ushtroi mbi këto ikona të lirisë, ishin torturat më çnjerëzore që ia kalonin edhe kampeve të Hitlerit.

Nga vitit 1944 deri 1955 me mijëra persona janë vrarë, por identiteti i shumicës prej tyre është zhdukur nga arkivat. Ky është një tmerr që kush e ndjen dhe kush e mbart nga e kaluara e familjes nuk mundet ta harrojë lehtë.

Ndaj kjo do të jetë kauza ime. Kauza e Partisë Demokratike, e cila do të propozojë hartimin e një projektligji për ndalimin, dënimin dhe ekspozimin të çdo forme të simboleve të regjimit komunist. Në përfundim, unë sot i propozoj këtij Parlamenti zbatimin e dy rezolutave të rëndësishme. Siç janë ajo e Këshillit të Evropës të vitit 1996 dhe rezoluta e Parlamentit Shqiptar 2006 për dënimin e krimeve të komunizmit dhe ndalimin e përfshirjes së figurave që përfaqësojnë ish-regjimin komunist në politikëbërje, në krye të organeve ligjvënëse dhe ekzekutive. I paharruar qoftë kujtimi i tyre!

Shezai Rokaj, deputet



70 vjet më parë, në 10 tetor të vitit 1947, ora tre e mëngjesit, atë kohë i ngarkuar me cilësinë e prokurorit, përshkoi rrugën deri në burg dhe morri në dorëzim të dënuar me vdekje të pazakontë. Ata ishin deputetë të parlamentit të parë pas pushtimit nazi-fashist, opozitës së parë nën regjimin komunist në Shqipëri. Pas torturave, nga më çnjerëzoret, ata përfunduan të ekzekutuar. Ky ishte në thelb, ekzekutimi nga komunizmi i të vetmes shpresë për një sistem demokratik.

Ata nuk u dënuan si individë, por si deputetë të grupuar në mbrojtje të vlerave të demokracisë perëndimore dhe që morën përsipër të bënin opozitë në vendin më të pamundur ndonjëherë, në Shqipërinë komuniste. Por, përse u dënuan grupi i deputetëve? Mëkati i tyre ishte guximi për të çelur siparin e mendimit ndryshe, në parlamentarizmin e ri dhe të brishtë shqiptar. Në fakt, nisma e grupit të deputetëve, siç e njohim dhe e nderojmë sot, do t'u kushtonte jetën jo vetëm atyre, por edhe shumë bashkëpunëtorëve, edhe nga ata ndër më të zellshmit e inteligjencës shqiptare të atyre viteve. Ka qenë dhe vijon të jetë shumë e hollë vija që i ndan opozitarët

nga armiqtë në Shqipëri.

Sot, e gjithë ditën ne duhet ta rrëzojmë këtë mendësi totalitare. Të edukuar në Paris, Vjenë e Romë, këta deputetë gëzonin guximin për të thënë atë që mendonin dhe konstatonin, se partia komuniste po instalonte në Shqipëri një shtet diktatorial. Zëri i tyre grishte edhe deputetë të tjerë me pikëpamje të afërta dhe liberale. Grupi i deputetëve doli hapur në mbrojtje të parimeve demokratike dhe ata ishin pa diskutim ndër perëndimorët e parë me mend e kalem të Shqipërisë sonë. Ata nuk u ndalën së foluri e përpjekuri për vlerat demokratike deri në arrestimin e tyre. Prosesi i dënimit të grupit të deputetëve nuk ishte thjeshtë për të dënuar disa elementë, por ai synonte të nënshtronte dhe asgjësonte zërin e lirisë duke i dhënë fund lirisë së shprehjes në Shqipëri për pesë dekada, si dhe duke kërcënuar për fundin që do e priste çdo tentativë për demokraci e pluralizëm në Shqipëri.

Sigurisht që kjo çështje shkonte përtej të majtës dhe të djathtës. Deputetët e dënuar, kryesisht ishin me bindje të majtë, monarkistë, socialdemokratë, por edhe të rezistencës. Ata ishin personalitete me kontribut të spikatur në shoqërinë shqiptare. Kishte në mes tyre intelektualë me shumë gjuhë të huaja, tregtarë të ndershëm, ushtarakë të lartë, të shpallur armiq nga “shokët e armëve”. Mes tyre Gjergj Kokoshi, deputet i Shkodrës, i pari ministër i arsimit pas Luftës së Dytë Botërore, Shefqet Beja, që i doli ballas vdekjes e pati guximin të zhvishet në sallën e gjyqit për t’i treguar trupit gjykues dhe të pranishmëve plagët e shkaktuara nga hekuri i skuqur në gjoks dhe në shpinë. Plagë, shenja të pashlyeshme, në kujtesën e familjarëve të tyre. Plagë të panjohura dhe të parrëfyera krejtësisht në kujtesën tonë post-totalitare. Fatkeqësisht, tregues të amnezisë sonë post-totalitare.

Paranoja është prolog i totalitarizmit. Këta deputetë e dinin se shprehja e tyre e lirisë kundër shumicës komuniste, përveç rrezikut që sillte për ta, mund të mos ndryshonte asgjë. Por, ata nuk u rëzuan, por ngritën krye dhe u bënë

shembuj të ligjvënësit që sakrifikohet për t'i lënë trashëgim parlamentarizmit, aq i varfër sa është tek ne, një traditë pluraliste mendimi.

Likuidimi i grupit të deputetëve dhe frymës perëndimore që përhapnin, ishte porta hyrëse për luftën brenda llojit në parti të komuniste shqiptare. Kundërshtarë realë dhe imagjinarë, ky vend ka prodhuar me bollëk. Pas likuidimit të tyre, nisi dhunimi masiv i të drejtave të njeriut përmes vrasjeve dhe ekzekutimeve, individuale dhe kolektive, vdekjet në kampet e përqendrimit, vdekjet në tharjet e kënetave, vdekjeve nga uria dhe torturat, dëbimet, internimet, terrori fizik dhe psikologjik. Këto krime nuk u pasuan me një hetim pas rënies së regjimit. Autorët e këtyre krimeve nuk u përballën asnjëherë me drejtësinë, madje nuk u kërkuan as falje viktimeve.

Dënimi i krimeve të regjimit komunist në Shqipëri është tejet i rëndësishëm për ndërgjegjësimin e brezit të ri, për krimet çnjerëzore të kryera nga regjimi diktatorial. Vetëm njohja dhe denoncimi i këtyre krimeve do të mirëedukonte brezat e rinj, do të respektonte viktimat e krimeve të regjimit komunist dhe familjet e tyre, si dhe do të ishte një shenjë mirënjohjeje për qëndruesin e tyre ndaj diktaturës. Ky dënim do të siguronte edhe vlerësimin e atyre figurave, që vërtetë luftuan për idealin e lirisë së vendit, por u lanë në harresë, u retushuan nga propaganda e regjimit, ose akoma më keq, u eliminuan nga pushteti i diktatorit. Vetëm kështu mund të mësojmë kush ka qenë vigan dhe kush ka qenë pigme.

Ka ardhur koha që klasa politike të dënojë krimet e komunizmit dhe, së bashku me botën akademike nga unë vij, median dhe shoqërinë civile, të nisë një fushatë kombëtare për ndërgjegjësimin rreth krimeve të kryera në emër të ideologjisë komuniste, duke përfshirë edhe shpalljen e një dite kombëtare për kujtimin e viktimeve të komunizmit, hapjen e muzeve, rivlerësimin e figurave të asaj periudhe, si edhe ngritjen e memorialeve në nderim të shqiptarëve që u vranë për kundërshtimin dhe rezistencën ndaj regjimit totalitar.

Romeo Gurakuqi, deputet



70 vjetori i eliminimit të grupit të deputetëve të Kuvendit të ish-Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të intelektualëve të pavarur, sot, është një moment reflektimi për gjithçka ndodhi në këtë vend në tre vitet që pasuan 29 nëntorin e vitit 1944, me ardhjen në pushtet të klikës së diktatorit Enver Hoxha, menjëherë pas luftës dhe përpjekjeve të vërteta për liri të partizanëve të mirëfilltë, të rinisë antifashiste, të djemve dhe vajzave që luftuan me armë në dorë për një Shqipëri më të vërtetë dhe të lirë.

Komunistët që hynë më 17 nëntor të vitit 1944 në Tiranë dhe më 29 nëntor të vitit 1944 në Shkodër, në të gjithë Shqipërinë vepruan si dhunues të vërtetë në vatrën e këtyre qyteteve paqësore, deri atëherë vatra komunitetesh të lira dhe të lumtura të Shqipërisë, të cilët dijen dogmatike nuk e njihnin, madje e urrenin. Kultura qytetare shqiptare, përbënte një kulturë krejtësisht të pangjashme dhe të përkundërt me rendin e tyre të mendimit, të cilën ata do ta shkatërronin së bashku me bazamentin social që e

kishte ndërtuar dhe ushqyer për dekada dhe shekuj. Eliminimi i deputetëve me pikëpamje dhe qëndrime indipendente, në raport me bllokun e njëzuar komunist brenda përfaqësisë së ish-Frontit Demokratik në Kuvendin Popullor, një numri intelektualësh dhe teknikienësh të lidhur artificialisht me ata, në procesin e montuar politik, ishte veç pjesa fundore e shkatërrimit të shoqërisë shqiptare paraekzistuese. Do të thosha ishte rrethi i tetë i eliminimeve të asaj shoqërie që kishte themeluar shtetin Shqiptar, institucionet politike dhe juridike, institucionet arsimore, kulturore dhe vetë Tiranën si kryeqytet.

Deputetët nacionalistë të Frontit Demokratik u pastruan në mënyrën më barbare duke u cilësuar si armiq të popullit, pasi misioni i koperturës tashmë kishte përfunduar dhe ata përbënin veç një pengesë në ritmet e instalimit të plotë të një diktature me orientim të mirëfilltë sovjetik. Para këtij pastrimi, Enver Hoxha dhe Koçi Xoxe kishin ndërmarrë, përmes një plani të saktë purifikues, eliminimin me gjyq dhe pa gjyq të të gjithë elitës pararendëse të vendit dhe të gjithë strukturës shoqërore dhe politike të Shqipërisë së para vitit 1945.

Por, në një pjesë të madhe të muajve të parë të ardhjes së tyre në pushtet në Tiranë, komunistët nën drejtimin e qeverisë qendrore, u përqendruan në neutralizimin e opozitës së mirëfilltë dhe hipotetike, përmes një lufte të mirëfilltë të drejtuar përmes parullave të drejtësisë revolucionare. Kjo udhëheqje, në një vit e gjysmë pas ardhjes në pushtet, pasi mundi ushtarakisht kundërshtarët e dëzenuar politikë të klasës drejtuese tradicionale, arriti të dobësonte mjaftueshëm çdo kundërshtar politik përmes institucioneve të reja ligjore, që ata ndërtuan në harkun kohor nga ardhja në pushtet deri në marsin e vitit 1946.

Në fillim të vitit 1946, pas dështimit të qartë të procesit të njohjes së regjimit nga aleatët perëndimorë, pasi

formalizuan koperturën legale të pushtetit në zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945 dhe mbledhjes së Asamblesë Kushtetuese në janar-mars 1946, radha u kishte ardhur pengesës së fundit në rrugën e njësimimit me politikën e Partisë Komuniste Jugosllave, deputetëve me pikëpamje independete, që nuk korrespondonin me linjën e fortë të Enver Hoxhës dhe klikës së tij. Deputetët u ndërlidhën rastësisht në funksion të një alibie komplotiste dhe ato pakë intelektualë, që kishin mbetur pa u shfarosur fizikisht nga regjimi komunist në dy vitet pararendëse, u ndërlidhën së bashku me ta.

Duhet të themi që merita e deputetëve, intelektualëve të vitit 1946-47 qëndron në faktin se ata, atëherë kur nuk mendohej, arritën të shfaqnin një qëndrim të ndryshëm, që përmbante mesazhin e qartë të shkëputjes nga rruga pa krye antikombëtare dhe antidemokratike ku ishte futur pa kthim regjimi.

E mora fjalën këtu, jo vetëm si deputet i parlamenti, por edhe si përfaqësues i atyre familjeve të Tiranës së asaj kohe shkatërrimtare, që u dëbuan dhe u deportuan pas çdo procesi politik. Shumë prej tyre pësuan kalvarin e vrasjes dhe të dhunës pambarim nisur nga kjo kohë e vendosjes së regjimit të terrorit. Brezat e sotëm, mbase ende sot nuk e kanë të qartë, se në vitet 1945-48 e gjithë klasa e mesme e shoqërisë së kryeqytetit, që nuk arriti të largohej nga Shqipëria, para ardhjes së komunistëve në pushtet, ose u eliminua fizikisht ose u deportuan pa të drejtë kthimi në shtëpitë tyre.

Tirana e pas kësaj kohe ishte një qytet me pamje të ndryshme shoqërore, e shkëputur krejtësisht nga koha e themelimit dhe e ndërtimit shtetëror të Shqipërisë. Banorë të rinj kishin zaptuar ilegalisht pronat dhe vatrën familjare të të gjithë klasës së mesme të kryeqytetit dhe kjo nuk është shkruar në asnjë nga librat e historisë deri më sot. I gjithë thesari intelektual, që Shqipëria trashëgoi

para Luftës së Dytë Botërore, pikërisht ata që e krijuan Shqipërinë, ata që vendosën bazat kombëtare të sistemit arsimor dhe shkencor, themeluesit e jurisprudencës shqiptare, filozofët më mendjendritur të vendit, ministrat më të ndershëm të shtetit shqiptar, ata të cilët mbajtën lart emrin e shqiptarit evropian në rrethanat nga më të vështirat, u eliminuan me një të rënë të lapsit nga diktatori dhe rrethi i tij.

27 vite pas rënies së diktaturës, ende në këtë vend, nuk është dokumentuar dhe ndëshkuar krimi i të kaluarës komuniste, nuk është bërë spastrimi shpirtëror, rrëfimi i ndërgjegjshëm dhe denoncimi i kriminelëve ordinerë të diktaturës. Ne, ende, vazhdojmë të jemi një vend ku nuk janë hedhur bazat e një shoqërie të lirë dhe të qytetëruar. Fatkeqësisht, sot, ende pushteti hesht para krimit të djeshëm. Mbrojtësit publikë, të kriminelëve, ende, bëjnë avokatin në media lirshëm. Jemi një shoqëri, që nuk kemi kryer ende spastrimin ligjor të paligjshmërisë së djeshme. Madje ne jemi një vend ku pasardhësit e establishmentit që kryen shfarosje të tilla, ripërtërijnë politikat e kamufluara përjashtimore ndaj çdokujt, që i përket familjarisht dhe politikisht ish-elitës, përfshirë edhe përfaqësuesit e deputetëve, të cilët jemi mbledhur sot këtu t'i nderojmë. Jemi një shoqëri, që nuk reagojmë kur kryeministri aktual vendos me imponim në krye të institucionit sovran, ministrin e fundit të Punëve të Brendshme të asaj diktature, që vrau njerëz në kufij në atë kohë dhe dogji dosjet e Sigurimit të Shtetit. Shoqëria e sotme, kështu e ndërtuar, mbetet ende një shoqëri me ndërgjegje të rënduar, thellësisht të traumatizuar nga zbulimi i pjesshëm i krimeve të komunizmit. Ndoshta këtu duhet të kërkojmë një pjesë të arsyeve pse e vjetra ka arritur të mbijetojë, të modifikohet dhe të forcohet ekonomikisht dhe politikisht.

Për mendimin tim, kjo ndodhi, sepse të vjetrës iu dha

frymë pikërisht në kohën e duhuar, atëherë kur ajo duhej të jepte shpirt. Ata, që kanë marrë përsipër të ndërtojnë ekipin e ri administrativ dhe frymën ligjvënëse të Shqipërisë së vitit 2017, duhet të dallohen për maturinë, shmangien nga diletantizmi dhe militantizmi ordiner. Ndërtimi i strukturave të qëndrueshme demokratike të mbështetet nga arritjet më të mira të Shqipërisë. Kjo mbledhje e sotme e Kuvendit është një thirrje për ndjekjen e kultit të vlerave tradicionale, nderimin e personalitetit njerëzor, institutit familjar të lirive shoqërore, politike, respektimit të të drejtës së pronës private, të drejtës së popullit për vetëvendosje politike, përmes zgjedhjeve të lira, të ndershme.

Ekipet e reja legjislative dhe ligjvënëse të Shqipërisë së vitit 2017 nuk mund të jenë më, për së dyti, të ndërthurura me trashëgiminë e diktatorëve, ministrave dhe prokurorëve të së djeshmes tragjike, ashtu sikurse nuk mund të jenë më të mbushur me mediokër dhe meskinë që vlojnë nga rihakmarrja e etërve gjakatarë që vranë deputetët në vitin 1946-47.

Sadi Vorpsi

Ne sot, përkujtojmë një nga ngjarjet më të rënda të historisë së Shqipërisë, e cila shënoi edhe pikënisjen e tmerrit dhe krimeve të komunizmit, që do të pasonin në të ardhmen. Të ashtuquajturit si armiq të popullit, nga diktatura që po instalohesh, 17 viktimat, mes tyre 15 deputetë, përbënin elitën e vendit dhe ishin të parët që ranë pre e një historie të mbushur me padrejtësi e terror dhe që do të zgjaste 50 vite. Përmes gjyqeve të falsifikuara, dëshmitarëve të rremë dhe të zgjedhurve për të ndjekur seanca vdekjeprurëse, shoqëria përjetoi holokaustin Shqiptar. 15 deputetët, që ne sot i nderojmë si martirë ju kundërvunë herët kufizimit të lirive politike të shqiptarëve. Kështu ngjarjet e viteve 45-47 shënuan edhe shkëputjen nga Perëndimi dhe që pasoi për pothuajse pesë dekada.

Provat e tanishme për manipulimin e procesit hetimor gjyqësor, në lidhje me grupin e deputetëve, janë të frikshme. Të mbledhura bashkë, ato jo thjeshtë treguan falsitetin e plotë të dokumentave në dosjet hetimore gjyqësore, por më shumë se kaq, i përshfaqën shqiptarëve tmerrin që po afronte prej manipulimit.

Si sot 70 vite më parë diktatura komuniste, e sapo instaluar në Shqipëri, ju mori jetën intelektualëve demokratë progresistë e patriotë. Shefqet Beja, Riza Alizoti, Sulo Klosi, Salim Kokolari, Irfan Majuni, Enver Sazani dhe Selaudin Toto të dënuar me varje në litar. Sheh Ibrahim Karbunara, Paolo Saggioti, Ramazan Tabaku, Agathokli Xhitoni, Mehmet Prishtina, Abdyl Kokoshi, Beqir Çela, Tefik Deliallisi, Pertef Karagjozi, Islam Radovicka dhe Hysen Shehu, paradoksalisht disa prej tyre ishin edhe deputetë të Parlamentit të parë Shqipëtar të para Luftës së Dytë Botërore. Sa gjëra do ishin ndryshe sot, sikur mendje të ndritura e me mentalitet perëndimor, si këta heronj, t'ia kishin dalë të merrnin pushtetin në ato zgjedhje të para pluraliste.

Sot dua të sjell një fragment, që zbardhja e së të vërtetës na lejon ta dimë, qoftë, edhe me vonesë. Shefqet Beja pati guximin të zhvishet në sallën e gjyqit për t'i treguar trupit gjykues dhe të pranishmëve në sallë plagët e shkaktuara nga hekuri i skuqur në gjoks dhe në shpinë. Duke ditur fatin e tij, kërkonte t'i binte për herë të fundit kambanës së alarmit për të faktuar atë që e priste Shqipërinë në vijim.

Sot, ne kemi detyrimin, që ngjarje të tilla të zbardhen për t'i dhënë brezit të ri shembuj se si diktaturat nuk duhen kthyer dhe aq më pak mbështetur. Falë angazhimit të qeverisë dhe Autoritetit mbi Informimin e Dosjeve, qytetarët shqiptarë do të njihen së shpejti me të vërtetën e ekzekutimit të atyre që guxuan të bënin lëvizje antikomuniste dhe vendimin në Marrëveshjen e Mukjes për eliminimin e eksponentëve të organizatave të tjera politike si Balli Kombëtar apo Legaliteti. Gjithashtu, hapja e dosjeve të Sigurimit pritet të nxjerrë të vërtetën mbi ekzekutimet komuniste të grupit të inxhinierëve të Maliqit, ashtu siç pak kohë më parë bënë rivlerësimin e figurës së Musine Kokalarit, të doktoreshë Sabiha Kasimatit. Unë besoj se, po në të njëjtën rrugë, do të vazhdojmë me ngjarje të tjera të rëndësishme për historinë e kombit.

Ne sot na lind detyra, që krahas përkujtimit të viktimave të bëjmë edhe rivlerësimin e persekutorëve, që prej dekadash mbajnë titujt e dekorata. Dekorime këto, që në 27 vite pluralizëm, qeveritë dhe legjislaturat e shkuar nuk gjetën kohën për t'i gjykuar. Them nuk gjetën kohën, sepse më vjen turp të mendojmë se nuk kishte vullnet. Shoqëria e sotme, u detyrohet viktimave të këtij grupi një gjë, të vërtetën. Nëse ajo nuk do të arrijë ta realizojë atë, do të instalojmë një histori tjetër edhe më të zehtë se sa ajo paraardhësja për sa u përket krimeve ndaj lirive civile.

Duke ju përlurur të gjithë atyre që kërkonin të na jepnin një jetë më të mirë dhe që paralajmëruan rrezikun nga diktatura e kuqe, unë dua t'i shpreh falënderimet e mia dhe respekt të pakufishëm pasardhësve të tyre.

Deputetët opozitarë përballë ndërtimit të “shtetit të diktaturës së proletariatit”

Sonila Boçi - Hamit Kaba

Heqja e mandatit, arrestimi, dënimi dhe ekzekutimi i një grupi deputetësh të Kuvendit Popullor, në vitin 1947, vetëm një vit pasi ky kishte marrë mandatin për të ushtruar veprimtarinë e tij, është një nga ngjarjet më tronditëse të historisë së komunizmit në Shqipëri. Ajo dëshmoi vullnetin e drejtuesve më të lartë të PKSH-së për të mos lejuar asnjë hapsirë lirie në vend. Si e tillë është një nga gurët kilometrikë në procesin e instalimit të diktaturës së proletariatit. Shumë është folur dhe shkruar për këtë ngjarje, por ende nuk mund të thuash se historia e tyre e trishtë është zbardhur plotësisht. Qëllimi i këtij artikulli është të përpiqet të hedhë dritë mbi rrugëtimin e këtyre personaliteteve, që nga përfshirja e tyre në listat e përfaqësuesve të Frontit Demokratik, në Asamblesë Kushtetuese, deri në dënimin e tyre. Ai, gjithashtu, do të përpiqet të shpjegojë kontekstin historik të brendshëm dhe të jashtëm që ndikoi në arrestimin dhe dënimin e deputetëve të Kuvendit Popullor.

Rrethanat që kushtëzuan përfshirjen e këtyre personaliteteve në listat e përfaqësuesve të Asamblesë Kushtetuese

Ndonëse rezistenca kundër pushtuesve dhe fitorja ndaj

tyre u kishte dhënë komunistëve mjaft kredite popullariteti dhe lehtësoi mjaft ngritjen e tyre në pushtet që gjatë Luftës së Dytë Botërore, paqja po rezultonte e vështirë për t'u menaxhuar. Më 17 tetor 1945, pikërisht në prag të zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese, u zhvillua Plenumi IV i KQ të PKSH-së, i cili analizoi situatën e brendshme dhe të jashtme të Shqipërisë. Pjesëmarrësit në mbledhje u shprehën të shqetësuar mbi mbështetjen e masave ndaj regjimit të ri¹. Enver Hoxha² në referatin e tij “Mbi situatën e brendshme dhe të jashtme” theksonte se “reaksioni jonë [opozita kundër PKSH] nuk i kishte rrënjët në ujë”³. Sipas tij, situata ndërkombëtare kishte nxitur “reaksionin” për t'u organizuar dhe për të krijuar një lëvizje opozitare. Ai konsideronte si opozitarë të mundshëm popullsinë e veriut të Shqipërisë, e cila ishte tërësisht nën influencën e krerëve fisnorë; elementët e pakënaqur nga reformat e ndërmarra nga **Qeveria Provizore Demokratike**; klerin katolik; “shtresat e intelektualëve të pasqaruar dhe që kanë qenë ose janë në pozitë e armikut, ose në indiferencë, shtresat e tregtarëve të mëdhenj, që i kanë goditur tatimet e fitimeve të jashtëzakonshme, spekulatorët e përhershëm, shtresat e bejlerëve dhe të agallarëve që i ka prekur ligji i Reformës Agrare dhe rreth këtyre me siguri mund të grumbullohen në

1. **Arkivi Qendror i Republikës së Shqipërisë** (më tej: **AQSH**), Fondi (më tej: F.) 14/AP organet udhëheqëse (më tej: org. udh.), Viti (më tej: V.) 1945, Dosja (më tej: D.)

2. Fleta (më tej: fl.) 8-10, Referati mbi situatën e brendshme dhe ndërkombëtare të Shqipërisë, mbajtur nga Enver Hoxha në Plenumin IV të KQ të PPSH, 17 tetor 1945.

3. Enver Hoxha në atë kohë mbante postet më të larta partiake dhe qeveritare. Ai ishte Sekretar i Përgjithshëm i KQ të PKSH, kryeministër, ministër i Jashtëm dhe i Mbrojtjes.

3. **AQSH**, F. 14/AP org. udh., V. 1945, D. 2, fl. 8-10.

rast se ne s'punojmë drejt dhe nuk zbatojmë si duhet vijën e Frontit, të gjithë ata elementa indiferentë të papërzier me politikë dhe që nuk arrijnë të kuptojnë si duhet manovrën e reaksionit dhe përpjekjet tona në këtë situatë të vështirë”⁴. Edhe diskutimet e anëtarëve të tjerë të Plenumit, si: Sejfulla Malëshova, Rahman Përlaku, Ymer Dishnica, Abedin Shehu etj., vunë në dukje hendekun që ekzistonte midis pritshmërisë së popullit dhe realizimeve të qeverisë. Kështu, S. Malëshova⁵ pohoi se populli shfaqte pakënaqësi në lidhje me drejtimin e qeverisë së Frontit, pasi, sipas tij, kishte një hendek midis asaj se: “çfarë kemi premtuar në Luftë dhe çfarë japim; d.m.th. masat pretendojnë më shumë se ç'mund të marrin në realitet”⁶.

Përtej situatës së brendshme jo fort të stabilizuar, **Qeveria Provizore Demokratike** e drejtuar nga E. Hoxha po përballëj edhe me vështirësinë për të afirmuar veten në arenën ndërkombëtare. Në Konferencën e Jaltës (shkurt 1945), ato premtuan se do të njihnin vetëm ato autoritete “në të cilat të përfaqësohen gjithë elementët demokratë të popullsisë [dhe] që ndërmjet zgjedhjeve të lira duhet sa më shpejt të formojnë qeveri që i përgjigjen vullnetit të popullit”⁷. Qeverisë provizore shqiptare i duhej të plotësonte patjetër këtë kusht të Jaltës, pra zhvillimin e zgjedhjeve. Vetëm kështu mund të siguronte mbështetjen e duhur nga Aleatët

4. **AQSH**, F. 14/AP org. udh., V. 1945, D. 2, fl. 8-10.

5. Sejfulla Malëshova ishte anëtar i Byrosë Politike të KQ të PKSH dhe ministër i Propagandës.

6. Për më tepër shih: Sonila Boçi, “Zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945 (ngjarje që sollin në pushtet apo legjitimoi pushtetin e komunistëve)”, në: **Studime Historike**, nr. 1-2, Tiranë: 2008, f. 98.

7. Artur Conte, **Jalta dhe ndarja e Botës**, Tiranë: Albinform, 1994, f. 189

Perëndimorë, jo vetëm për pushtetin e komunistëve, por dhe vetë ekzistencën e shtetit shqiptar, situata ndërkombëtare e të cilit mund të konsiderohej e rrezikshme. Qeveria shqiptare nuk u ftua të merrte pjesë në mbledhjen themeluese të OKB në San Franciskos (prill 1945) dhe, rrjedhimisht, nuk u pranua as në këtë organizatë. Qeverinë Provizore shqiptare nuk e kishte njohur asnjë qeveri, përveç asaj jugosllave. Greqia vazhdonte të ushtronte trysni ndaj qeverive të Aleatëve Perëndimorë dhe OKB-së, për njohjen e pretendimeve greke në Shqipërinë e Jugut. Qeveria greke i kishte shtuar retorikës së saj mbi “strukturën etnike greke të Epirit të Veriut” edhe elementët strategjikë, si dhe persekutimin e minoritetit grek në Shqipëri nga qeveria komuniste e Enver Hoxhës⁸.

Situata e rënduar ndërkombëtare shtronte si domosdoshmëri për qeverinë provizore shqiptare, sigurimin e mbështetjes dhe njohjes nga të gjithë Aleatët e Mëdhenj. Aleatët Perëndimorë, Britania e Madhe dhe SHBA e kushtëzuan njohjen zyrtare të qeverisë së Enver Hoxhës me zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike⁹. Për drejtuesit e lartë të PKSH ishte e qartë se, rruga drejt konsolidimit e legjitimitit të pushtetit të tyre kërkonte një fitore plebishitare në zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese dhe për ta arritur këtë, ata duhet të mos neglizhonin asgjë. Kjo do të thoshte që qëllimet përfundimtare të administratës së re, pra për të vendosur një regjim të diktaturës së proletariatit, duhet ende

8. Sonila Boçi, **Minoritetet midis identitetit dhe integritit 1939-1949**, Tiranë: QSA, 2012, f. 146-167

9. **The National Archives** (më tej: **TNA**), FO 371/48083, 1945, Warner për Foreign Office, 3 shtator 1945.

të prisnin. Drejtuesve më të lartë të PKSH i duhej të përdornin të gjithë burimet e mundshme njerëzore, propagandistike e materiale për të fituar në mënyrë të bindshme zgjedhjet. Kështu, ata u detyruan të konsideronin përfshirjen në listat e përfaqësuesve të Asamblesë Kushtetuese dhe njerëz me reputacion, por që nuk ishin mbështetës fanatikë të regjimit të ri.

Cilët ishin deputetët e dënuar dhe çfarë përfaqësonin ata?

Të gjithë deputetët e dënuar në proceset e të ashtuquajturit “gjyqi i organizatës Nacional-Demokratike”¹⁰ ishin personalitete me kontribut të spikatur në shoqërinë shqiptare të kohës. Ata kishin prejardhje të ndryshme shoqërore, arsimore dhe politike, por ata bashkoheshin në idealin për një Shqipëri moderne me prosperitet ekonomik e shoqëror dhe për një sistem politik liberal. Të gjithë deputetët opozitarë kishin qenë të përfshirë, aktivisht apo jo, në lëvizjen e rezistencës shqiptare. Disa prej tyre mbanin pozicione të ndryshme në Këshillin Nacionalçlirimtar që prej Kongresit të Përmetit dhe Mbledhjes së Beratit. Deputetët e dënuar kishin bindje kryesisht të majta, por nuk ishin komunistë fanatikë. Për

10. Në katër proceset që u zhvilluan për dënimin e të ashtuquajturës organizata tradhtarë “Nacional-Demokrate” u përfshinë 14 deputetë, të cilët ishin: Shefqet Beja, Selaudin Toto, Enver Sazani, Sheh Ibrahim Karbunara, Irfan Majuni, Riza Dani, Faik Shehu, Islam Radovicka, Kostandin Boshnjaku, Kol Kuqali, Arif Gjyli, Kadri Hoxha, Hysni Peja, Zef Haxhija.

ta ishte e qartë se, shteti që donin të krijonin ata që e kishin pushtetin, nuk ishte i ngjashëm me shtetin që ata aspironin dhe ishin të gatshëm të bënin pjesën e tyre për të ndaluar të pashmangshmen.

Gjatë vitit 1945, disa nga personalitetet e Frontit si, Riza Dani, Shefqet Beja, Kostandin Boshnjaku, Selaudin Toto, Kolë Kuqali etj. kishin shfaqur hapur apo në biseda personale koncepte mbi të ardhmen e Shqipërisë, që binin ndesh me ideologjinë dhe projektet e qeverisjes që kishte regjimi që po instalohesh në Shqipëri. Ndonëse, pjesë e strukturave drejtuese të Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, dukej qartë se pikëpamjet e tyre mbi zhvillimin politik, ekonomik dhe kulturor të vendit, nuk përputheshin me konceptet e drejtimit të vendit të drejtuesve më të lartë komunistë. Gjatë qershorit 1945, në disa artikuj të gazetës “Bashkimi”, nënkryetari i Frontit Nacionalçlirimtar të Shqipërisë, Shefqet Beja ka botuar një numër artikuj mbi politikën ekonomike që duhet të zbatoheshin në Shqipëri dhe rrugën ku duhet të ecte ekonomia shqiptare. Ai shpalsi idetë e tij për një sistem liberal ekonomik, ku peshë dhe rëndësi duhet t’i jepet prodhuesit privat, i cili duhet të kujdeset për cilësinë e prodhimit dhe gjatjen e tregjeve të shitjeve¹¹. Shefqet Beja nuk i fshehu edhe pikëpamjet e tij mbi sistemin politik që duhet të vendosej në Shqipërinë e pasluftës. Në referatin e mbajtur në Kongresin e Frontit në gusht 1945, Beja u

11. Shefqet Beja, “Si duhet të eksportojmë në të ardhmen”, **Bashkimi**, nr. 146-147, 14-15 qershor 1945; Shefqet Beja, “Për zhvillimin e ekonomisë sonë”, **Bashkimi**, nr. 196, 15 gusht 1945.

përpoq të minimizonte rolin e PKSH në drejtimin e vendit, duke i mëshuar rëndësisë që Fronti duhet të merrte si një organizatë që përfshin një shumicë absolute shqiptarësh. “Frontit pra, - theksonte Beja, - i bie barra që ta udhëheqë e ta edukojë popullin në rrugën e demokracisë dhe, ashtu si në kohën e luftës, [ku] ay ishte organizuesi dhe mobilizuesi i popullit ..., ashtu dhe sot, akoma më shumë i takon të jetë udhëheqësi dhe mobilizuesi i popullit për demokracinë dhe konsolidimin e saj në vendin tonë”¹². Koncepte mjaft liberale për zhvillimin ekonomik të vendit shfaqte asokohe dhe Konstandin Boshnjaku, drejtor i përgjithshëm i Bankës së Shqipërisë. Madje, ai këto koncepte ia paraqiti me anë të një promemorie Këshillit të Ministrave më 22 dhjetor 1945. “Jam i mendjes, - shkruante K. Boshnjaku, - që ne iniciativës private duhet t’i japim rëndësi të madhe, duhet ta inkurajojmë dhe sidomos të mos e shqetësojmë herë pas here, pasi ... pa iniciativën private nuk mund të bëhet as rindërtim, as ndërtim dhe asnjë përparim në ekonominë tonë”¹³. Ai paralajmëronte drejtuesit e lartë komunistë se mungesa e iniciativës private do të çonte në një ekonomi parazitare. Ai shprehej i pakënaqur me Reformën Agrare, e cila nuk i pajiste fshatarët me tapi për tokën, pra nuk i bënte ata pronarë realë të saj. Sipas Boshnjakut, shteti nuk duhet të ndërhynte në sipërmarrjen e lirë dhe politika ekonomike

12. **AQSH**, F. 14/AP, V. 1945, D. 9, fl. 15, Referat i Shefqet Bejës në Kongresin e Frontit.

13. “Promemorie e Kostandin Boshnjakut, drejtor i përgjithshëm i Bankës së Shqipërisë për Këshillin e Ministrave”, në: **Akte gjyqësore politike 1945**, botim i Institutit të Studimit të Krimeve të Komunizmit, Tiranë: Kristalina- KH, 2016, f. 521-524.

duhej të kishte qëllim “shtesën e prodhimit dhe pasurimin e atyre që punojnë”¹⁴.

Selaudin Toto ishte një nga intelektualët që i kushtonte rëndësi të veçantë zhdukjes së prapambetjes arsimore të shqiptarëve. Në shkrimet e tij gjatë vitit 1945, Toto shfaq hapur konceptet e tij liberale për zhvillimin e arsimit dhe kulturës në Shqipëri. Ai mendonte se debati i lirë intelektual do të çonte drejt lirisë së mendimit dhe krijimit e një shtrese të vërtetë intelektualësh në Shqipëri. Si fanolist dhe antizogist, Selaudin Toto mendonte se lëvizja e qershorit kishte potencialet e duhura për të siguruar emancipimin politik të shoqërisë shqiptare. Në artikullin e tij “Beteja e ideve”, ai i vlerëson vitet 1920-1924 si të vetmet vite në historinë e Shqipërisë ku kishte pasur kushte për shprehje të lirë të mendimit dhe për orientimin properëndimor të Shqipërisë¹⁵. Sipas tij, “vetëm pas Kongresit të Lushnjës populli ynë zuri të njohë për herë të parë vendet përparimtare dhe demokratike të Perëndimit. Një pjesë e mirë e këtyre njerëzve të kësaj kohe që themelonin shtetin e ri shqiptar, ishin patriotët dhe shkrimtarët tanë të Rilindjes sonë Kombëtare dhe mjafton që njeriu të këndojë bisedimet e parlamentit të këtyre trekatër viteve, gazetatat, programin e qeverisë popullore të Fan Nolit për të kuptuar frymën demokratike që zuri të fryjë në Shqipëri”¹⁶. Mjafton ky paragraf për të kuptuar se demokracia, të cilës i referohej Toto, nuk kishte të bënte

14. **Po aty.**

15. Selaudin Toto, “Beteja e ideve”, në: **Bashkimi**, 1 qershor 1945.

16. S. Toto, “Beteja e ideve”, në: **Bashkimi**, 1 qershor 1945.

me “demokracinë popullore”, për të cilën flisnin drejtuesit komunistë. Ndërsa me demokracinë popullore kuptohej një pushtet njëpartiak ku të prevalonte “diktatura e proletariatit”, ideja e Selaudin Totos mbi demokracinë ishte një sistem parlamentar me shumë grupime e parti politike, ku të vlonte debati dhe të diskutoheshin gjerësisht problematikat që kishin të bënin me të sotmen dhe të ardhmen e vendit.

Padyshim që mendimet e Shefqet Bejës, Kostandin Boshnjakut, Selaudin Totos e shumë personaliteteve si këta binin ndesh me konceptin e drejtuesve të lartë komunistë për ndërtimin e shtetit, por në këtë fazë ata kishin nevojë për këta personalitete. Ata kishin nevojë të legjitimonin pushtetin e tyre dhe këtë mund ta bënin vetëm me anë të zgjedhjeve. Enver Hoxha, Koçi Xoxe, Nako Spiru dhe drejtues të tjerë të lartë të PKSH në shumë raste kishin shprehur domosdoshmërinë e fitores së Frontit në zgjedhjet e ardhshme për Asamblenë Kushtetuese. Për ta nuk ishte e mjaftueshme një shumicë e thjeshtë, por një fitore, sipas fjalëve të E. Hoxhës “schiacciante [shtypëse]”. Ata kontrolluan dhe diktuan çdo segment të procesit zgjedhor. Hartuan një paketë ligjore, e cila në mënyrë **a priori** përjashtonte nga e drejta e zgjedhjeve kundërshtarët e regjimit; kontrollonin të vetëm të gjithë makinën propagandistike, me anë të politikave të frikësimit e bënë të pamundur për opozitën reale të organizohej për të paraqitur kandidatët e saj në zgjedhje. Pavarësisht të gjitha këtyre masave, në disa

zona si: Shkodër, Kukës, Durrës, etj ata nuk ishin të sigurt se rezultatet e zgjedhjeve do të ishin bindëse në favor të Frontit. Më 9 shtator 1945, Koçi Xoxe u dërgon një udhëzim drejtuesve lokalë të PKSH, në të cilën porositi që në propozimet e tyre për t'u përfshirë në listat e zgjedhësve të përfshihen jo vetëm anëtarë partie, apo njerëz besnikë të saj, por të bëhej kujdes të përzgjidheshin njerëz me ndikim dhe reputacion në zonat përkatëse¹⁷. Drejtuesit e lartë komunistë kishin nevojë të përfshinin në listat e zgjedhësve, personalitete si Riza Dani, Shefqet Beja, Selaudin Toto, Irfan Majuni, Kostandin Boshnjaku, Sheh Ibrahim Karbunara, Enver Sazani, Kol Kuqali, Islam Radovicka, Mestan Ujaniku etj. Shumica e tyre kishte ndikim të spikatur në rrethin shoqëror ku jetonin. Shumë prej tyre ishin të njohur për prirjet e tyre më liberale. Riza Dani, Kostandin Boshnjaku e Kol Kuqali kishin mbështetur programin liberalist të F.S. Nolit dhe ardhjen e tij në pushtet. Pjesa më e madhe e personaliteteve të sipërpërmendur kishin mbështetur aktivisht Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Islam Radovicka kishte qenë komandant i shtabit të Zonës I Operative (Vlorë-Gjirokastrë), Kol Kuqali kishte humbur dy djem gjatë Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Një pjesë e tyre mbanin dhe poste drejtuese në Front. Kështu, Shefqet Beja ishte nënkryetar i Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik, ndërsa Riza Dani e Irfan Majuni ishin drejtues të këshillave të Frontit, përkatësisht në Shkodër dhe në Durrës. Personalitete të tilla si Selaudin Toto,

17. **AQSH**, F. 14/AP strukturë, V. 1945, D. 59, fl. 1, Radiogram i Abedin Shehut për Koçi Xoxen, 11 shtator 1945.

Enver Sazani ishin të njohur për intelektualizmin e tyre, i pari si drejtor i Institutit të Studimeve dhe i dyti, si mjek i dëgjuar. Të gjithë këta regjimi nuk mund t'i fuste në thesin e bashkëpunëtorëve të pushtuesit, siç bënte rëndom me personalitete të tjera, të cilët kishin lidhje të drejtpërdrejta apo të tërthorta me Ballin Kombëtar apo Legalitetin. Ai ishte i gatshëm të shfrytëzonte reputacionin e tyre për qëllimet e veta. Madje, në ndonjë rast, kur ata nuk pranonin të bëheshin pjesë e listave zgjedhore, siç ishte rasti i klerikut bektashi, 67-vjeçarit, Sheh Ibrahim Karbunara, do të bënin të pamundurën për ta bindur të ishte pjesë e listave të kandidatëve¹⁸. Strategjia e drejtuesve të lartë komunistë rezultoi e suksesshme, pasi në disa zona të njohura për opozitarizmin e tyre, kandidatët jo komunistë arritën një rezultat më të mirë. Në dy zona elektorale të Shkodrës me numër të përafërt zgjedhësish, Riza Dani mori 7680 vota pro dhe 730 kundër, ndërsa anëtari i Byrosë Politike të KQ të PKSH, Tuk Jakova siguroi 7078 vota pro dhe 1689 kundër¹⁹. Përfshirja në listat e Frontit u interesonte dhe këtij grupi personalitetesh. Ata e kishin kuptuar se opozita jashtë Frontit ishte e pamundur dhe shumë e rrezikshme. Ata mendonin se duke qenë pjesë e këtij organi ligjvënës, do të mund të ndikonin në zbutjen e ashpërsisë së ligjeve dhe do ta kishin më të lehtë të shndërroheshin në të ardhmen në një opozitë legjitime²⁰.

18. **AQSH**, F. 14/AP strukturë, V. 1945, D. 59, fl. 28, Radiogram i Flamur Nishanit, Lushnjë për Koçi Xoxen, nr. 109, dt. 2 nëntor 1945.

19. **AQSH**, F. 489, V. 1945, D. 125, fl. 2, Material statistikor mbi rezultatet e zgjedhjeve të 2 dhjetorit 1945.

20. **Arkivi i Ministrisë së Brendshme** (më tej: **AMB**), F. 1 hetimore-gjyqësore, V.

Qëndrimi i deputetëve opozitarë në Asamblenë Kushtetuese/Kuvendin Popullor

Ashtu siç pritej, në zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945 kandidatët e propozuar nga Fronti, pa rivalë dhe në një proces të kontrolluar në çdo aspekt nga drejtuesit komunistë, fituan 93.5% të votave²¹. Ndonëse procesi kontrollohej nga PKSH, në Asamblenë Kushtetuese të dalë nga këto zgjedhje komunistët nuk ishin shumicë dërrmuese. Vetëm 48 nga 82 përfaqësuesit e kësaj Asambleje kishin taserën e PKSH²². Kjo nuk do të thoshte që përfaqësuesit jokomunistë në Asamblenë Kushtetuese ishin në opozitë me pushtetin e sapo vendosur në vend. Përkundrazi, kundërshtitë edhe të këtyre përfaqësuesve të Asamblesë, që më vonë do të arrestoheshin dhe dënoheshin, nuk u shfaqën gjithmonë hapur. Madje, më 17 dhjetor 1945, Selaudin Toto mbajti një fjalim në Radio Tirana në të cilën përgëzonte qeverinë për zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme në vend²³. Opozitarizmi i këtyre deputetëve u shfaq gradualisht, disa

1946, D. 2224, fl. 17, Nga deponimet e Shefqet Bejës në gjyqin e Organizatës Nacional-Demokrate, 4 shtator 1947.

21. "Zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese", në: **Bashkimi**, 3 dhjetor 1945

22. Partia Komuniste ishte realisht forcë drejtuese e vendit, pavarësisht se ajo vazhdonte të qëndronte brenda Frontit Demokratik. Komunistët dominonin në Parlament e në qeveri, në të cilën kishin 11 ministra nga 13 të tillë. Ata kishin gjithashtu 60% të anëtarësisë në Frontin Demokratik. Mbulimi i komunistëve me emrin e Frontit Demokratik ishte një hap pragmatist i llogaritur, i cili do ti shërbente siç i shërbeu fitores në zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945, por edhe shpresës për njohjen e qeverisë shqiptare nga aleatët e perëndimorë të luftës, Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Shih: Islam Lauka, Eshref Ymeri, **Shqipëria në Dokumentet e Arkivave Ruse**, Tiranë: Toena, 2006, f. 111.

23. "Përpara Asamblesë Kushtetuese", në: **Bashkimi**, 19 dhjetor 1945

më hapur e disa të tjerë më të rezervuar. Ndër ta do të shquanin, Riza Dani, Kolë Kuçali, Kostandin Boshnjaku, Selaudin Toto etj. Gjatë zhvillimit të punimeve të Asamblesë Kushtetuese në periudhën 10 janar-14 mars 1946 deputetët opozitarë shfaqën rezerva e kundërshtime në komisionet e Kuvendit Popullor. Gjatë diskutimit të disa projektligjeve të rëndësishme, që kishin të bëni me të ardhmen politike e ekonomike të vendit, miratimi i të cilave do t'i shtronte rrugën e do të ligjëronte vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri. Deputetët opozitarë shfaqën kundërshtime ndaj njohjes **en bloc** të të gjitha ligjeve të mëparshme, të miratuara nga Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar për periudhën maj 1944-janar 1946²⁴. Ata kërkuan që secili ligj të diskutohej e miratohej rast pas rasti pasi të ishte diskutuar më parë nga Asambleja Kushtetuese²⁵. Me këtë qëndrim, ata vinin në diskutim legjitimitetin e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, të dalë nga Kongresi i Përmetit.

Një grup prej 4-5 deputetësh të kryesuar nga Riza Dani dolën kundër listës së shumicës për Presidiumin e Asamblesë Kushtetuese, duke propozuar në vend të saj një listë tjetër, e cila nuk u miratua nga shumica e deputetëve. Disa nga këta deputetë dolën gjithashtu kundër rregullores për imunitetin e deputetit, e cila lejonte heqjen e imunitetit të tij, në rast se deputeti nuk zbatonte programin elektorale. Sanksionimi i një

24. **AQSH**, F. 489, V. 1946, D. 15, fl. 16, Procesverbal i mbledhjes së Asamblesë Kushtetuese, datë 11 janar 1946; si dhe Demir Dyrmishi, **Veprimtaria e bandave dhe e organizatave opozitare ilegale në Shqipëri (1944-1948)**, Tiranë: Bota Shqiptare, 2003, f. 230.

25. Demir Dyrmishi, **Veprimtaria e bandave dhe e organizatave opozitare ilegale në Shqipëri (1944-1948)**, Tiranë: Bota Shqiptare, 2003, f. 230.

klauzole të tij u hiqte deputetëve mundësinë për t'u shprehur lirisht, duke i shndërruar ata në "frymë të vdekura" dhe në mekanizma të thjeshtë votues. "Asambleistët, - theksonte Riza Dani, - janë përgjegjës përpara nderit dhe ndërgjegjes së tyre, jo përpara trupit elektoral"²⁶. Miratimi i këtij ligji nga shumica e bëri të cenueshëm imunitetin e deputetit, pasi ai mund të hiqej edhe për arsye politike, sikurse ndodhi pak kohë më pas me deputetët kritikë.

Periodha e diskutimit dhe e miratimit të Statutit të Republikës Popullore të Shqipërisë (Kushtetuta e RPSH) nxori edhe më në pah diferencat e opinioneve ndërmjet anëtarëve dhe mbështetësve të PKSH në Asamblenë Kushtetuese dhe këtij numri të vogël individësh. Disa seanca të Asamblesë Kushtetuese, të muajve janar-mars 1946, shënuan disa debate të nxehta midis deputetit të Shkodrës, Riza Dani - një nga opozitarët më aktivë, më luftarakë dhe më të hapur dhe anëtarit të Byrosë Politike të KQ të PKSH, Nako Spiru. Dani kërkoi t'u kujtonte se legjitimimi i pushtetit të atëhershëm, mbështetej në dy shtylla: lufta çlirimtare dhe Fronti Nacionalçlirimtar, të cilat "kanë pasur më tepër karakter kombëtar se sa ngjyrë ideologjike"²⁷. Sipas Danit, këtë frymë nuk e përmbante Statuti, i cili "pa dyshim asht me frymë ideologjike si politikisht, ashtu edhe nga pikëpamja social-ekonomike. Unë për vete jam për një demokraci

26. D. Dymishi, **Vepërtaria e bandave dhe e organizatave opozitare ilegale ...**, f. 228.

27. "Nga fjalimet e përfaqësuesve në seancën përdjeshme", në: **Bashkimi**, 8 mars 1946, si dhe **Akte Gjyqësore Politike 1946 gjatë Komunizmit në Shqipëri (Dosierë dhe Dëshmi gjatë komunizmit në Shqipëri)** 3, përgatitur për botim nga Leka Ndoja dhe Alvin Saraçi, Tiranë: ISK, 2016, Tiranë: Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojava të Komunizmit, 2016, f. 12.

të lirë. Do të votoj për Statutin, por do të dëshiroja dhe Statuti jonë t'u inspironte nga ky parim”²⁸. Në përfundim të diskutimit të tij Riza Dani propozoi me ironi që Shqipëria të deklarohej Republikë Socialiste Popullore²⁹. Ndonëse në parim projekti i Statutit të RPSH u miratua me unanimitet, në votimet nen për nen disa përfaqësues të Asamblesë, abstenuan. Kështu, Selaudin Toto dhe Skënder Luarasi abstenuan për përmbajtjen e nenin 16, i cili fliste për lirinë e ndërgjegjes dhe besimit, ndërsa Kostë Boshnjaku dhe Haki Stërmilli mbajtëm të njëjtin qëndrim për nenin 19, i cili fliste mbi mënyrën e mbrojtjes së paprekshmërisë së individit³⁰. Veçanërisht pas marsit 1946, filloi të bëhej gjithnjë e më e qartë kundërshtia e disa prej deputetëve të Kuvendit Popullor ndaj ligjeve të propozuara nga qeveria. Çfarë kishte ndodhur? Nevoja e drejtuesve të lartë të PKSH, për ta paraqitur vendin si “demokraci” në sytë e Aleatëve Perëndimorë, por edhe brenda vendit, pas zgjedhjeve të 2 dhjetorit 1945 dhe konstituimit të Republikës Popullore të Shqipërisë, nuk ishte më domosdoshmëri. Të dyja këto ngjarje, së bashku me miratimin e Statutit të RPSH më 14 mars 1946, legalizuan vendosjen e pushtetit të PKSH-së në vend, pavarësisht nga fasada që e fshihte ende Partinë Komuniste brenda Frontit Demokratik. Kushtetuta e përgatitur sipas modelit sovjetik u dha komunistëve fuqi ligjore për kontrollin absolut të shtetit.

28. Nga fjalimet e përfaqësuesve në seancën pardjeshme”, në: **Bashkimi**, 8 mars 1946, si dhe **Akte Gjyqësore Politike 1946 gjatë Komunizmit në Shqipëri 3 ...**, f. 12.

29. D. Dyrmishi, **Veprimtaria e bandave dhe e organizatave opozitare ...**, f. 232.

30. “Procesverbal i mbledhjes së 9-të të Asamblesë Kushtetuese”, në: **Gazeta Zyrtare**, nr. 48, 28 maj 1946, f. 3.

Ajo i hapi rrugën riorganizimit të qeverisë, forcimit dhe zbatimit të masave ekonomike me karakter socialist. Kushtetuta e re u dha fund shpresave të vakëta për të vendosur në Shqipëri një demokraci liberale. Ajo u hapi rrugën plotësisht instalimit të diktaturës së proletariatit me një sistem sovjetik në politikë, në ekonomi e kudo. Periudha kalimtare e njohur me termin “demokraci popullore”, e cila shënjonte kalimin nga kapitalizmi në socializëm, në Shqipëri ndryshe nga shumica e vendeve të tjera ish-komuniste kaloi gati pa u ndjerë³¹.

Pas këtij akti, krijimi i partive politike në Shqipëri u bë i pamundur, pavarësisht nga ndonjë rreng juridik që “lejonte” krijimin e tyre. Në të vërtetë dhe më herët, në Shqipëri nuk kishte pasur një traditë të pluripartitizmit. Me përjashtim të Partisë Socialdemokrate [të krijuar nga Skënder Muço, Musine Kokolari, Gjergj Kokoshi etj., që prej vjeshtës së vitit 1943]³², nuk kishte parti apo grupin tjetër të organizuar, qofshin ato edhe të spektrit politik të majtë. Kjo veçanti e Shqipërisë, në krahasim me vendet e tjera të Evropës Lindore, u krijoi kushte drejtuesve të lartë komunistë të merrnin masa më të shpejta për të eliminuar kundërshtarët politikë. Që në fillim të vitit 1946 u bë e qartë se kishte ndodhur një ndryshim substancial në qëndrimin e drejtuesve të lartë të PKSH-së, të cilën e vunë re qartazi edhe përfaqësuesit e misioneve perëndimore. Përfaqësuesi i Misionit Civil Amerikan në Tiranë, Joseph Jacobs fliste me shqetësim për situatën e krijuar në vend pas zgjedhjeve. Ai shprehte sigurinë, se në Shqipëri kishin

31. Luan Omari, **Revolucioni popullor në Shqipëri dhe çështja e pushtetit**, Tiranë: Mihal Duri, 1977, f. 121-134.

32. Anëtarët e kësaj partie u arrestuan në janar të vitit 1946 dhe u dënuan në mars të po atij viti.

ndodhur ndryshime të rëndësishme vetëm gjashtë javë pas zgjedhjeve të 2 dhjetorit. “Atmosferën e vullnetit të mirë dhe të shpirtit demokratik gjatë periudhës zgjedhore të 2 dhjetorit, - shprehej Jacobs, - [e ka zënë] regjimi i dyshimit dhe i frikës ... diçka ka shkuar keq në Shqipëri, që nga hapja e legatës sovjetike këtu ...”³³.

Konstatimet e Jacobs ishin të sakta. Që prej janarit 1946, filloi një valë e re arrestimesh dhe dënimesh. Kundërshtarë të regjimit, si monarkistët, socialdemokratët, klerikë katolikë u arrestuan dhe u dënuan në gjyqe të bujshme publike ende pa u tharë boja e shpalljes së Republikës Popullore të Shqipërisë. Më 16 mars 1946, Kuvendi i saposhpallur Popullor, hoqi mandatin e deputetit të Shkodrës, Hysni Peja sepse mendohej se kishte strehuar Maliq Bushatin³⁴.

Në kushtet kur çdo shpresë për të ndikuar në zbutjen e masave, kundërshtimi i disa prej deputetëve të Kuvendit Popullor³⁵ filloi të shfaqej gjithnjë e më hapur. Riza Dani, që pas marsit 1946 ka votuar vazhdimisht ose kundër ligjeve të prodhuara nga qeverisja komuniste, ose ka abstenuar. Po kështu, në shumë raste, Selaudin Toto, Kostë Boshnjaku kanë shprehur mendimin e tyre kundra.

Një pjesë tjetër e deputetëve kritikë e konsideruan situatën të pashpresë dhe vendosën të mos shprehnin hapur kundërshtitë e tyre. Sidoqoftë, ata nuk reshtën së propaganduari në rrethe të caktuara të popullsisë kundërshtitë e tyre për efektet negative

33. Jacobs to Secretary of State 8 shkurt 1946: in: **Foreign Relations of the United States (FRUS), Volume VI, Eastern Europe; The Soviet Union**, Washington: 1969, p. 7.

34. **AQSH**, F. 489, V. 1946, D. 11, fl. 1, Vendimi nr. 216 për heqjen e imunitetit të deputetit të Shkodrës z. Hysni Peja, 16 mars 1946

35. Pas miratimit të Statutit të RPSH, më 14 mars 1946, Asambleja Kushtetuese u kthye në Kuvend Popullor.

të ligjeve të miratuara, të cilat shkonin kundër konceptit të tyre të ndërtimit të shtetit. Ata u shprehën kundër caktimit të shumave të pajustificuara të tatimit të jashtëzakonshëm mbi fitimet e luftës, kundër mënyrës së zbatimit të reformës agrare, kundër reformës arsimore që kishte si bosht ideologjinë komuniste dhe kundër çdo mase tjetër që nuk pajtohej me bindjet e tyre. Deputetët kritikë kundërshtuan orientimin e politikës së jashtme të Shqipërisë vetëm ndaj BS e aleatëve të tij, duke kërkuar një politikë më të moderuar ndaj Britanisë së Madhe e SHBA. Sistemi amerikan e britanik, konsiderohej nga shumica e deputetëve opozitarë si modeli më i mirë i zhvillimit të Shqipërisë³⁶.

Të gjithë autorët që kanë shkruar mbi historinë e “grupit të deputetëve” bien dakord që ata, në asnjë rast nuk kanë vepruar si grup dhe nuk duket të kenë pasur koordinime në qëndrimet e tyre. Një pyetje e natyrshme që kërkon përgjigje mund të bëhet se, pse këta deputetë nuk vepruan si grup i organizuar dhe kompakt në Asamblenë Kushtetuese, por dolën si individë? Përgjigjen më të saktë mund ta gjejmë në deponimin para gjyqit të deputetit dhe ish-nënkryetarit të Këshillit Nacionalçlirimtar, Shefqet Beja. Deputeti Beja ka nënvizuar dy arsye kryesore të këtij qëndrimi: **së pari**, mungesën e unitetit të pikëpamjeve në Grupin e Deputetëve dhe, **së dyti**, për shkak të karakterit të pushtetit. Sipas Bejës, çdo kundërshtim i hapur “do të kishte qenë e kotë, pasi pushtetin e gjykoja si absolut dhe neve që do të kundërshtonim do të ishim 7-8 veta. Ne, - vazhdon ai, - e ndjenim veten të përçmuar në Parlament, pse vinin ligje dhe aprovoreshin vetëm me ndonjë ndryshim stilistik”³⁷.

36. **Akte Gjyqësore Politike 1946**, 2 ..., f. 24-32.

37. **Akte Gjyqësore Politike 1946 2** ..., f. 24.

Konteksti i brendshëm historik që çoi në arrestimin dhe dënimin e deputetëve

Arrestimet, hetimet dhe dënimet e deputetëve kundërshtarë të regjimit komunist në Shqipëri, ndodhën në rrethana të brendshme e të jashtme të pafavorshme. Në planin e brendshëm, fati i këtyre personaliteteve u kushtëzua nga nevoja e drejtuesve të lartë për të eliminuar kundërshtarët politikë dhe nga zhvillimet gjatë muajit shtator 1946. Kryengritja e Postribës e 9 shtatorit 1946 solli shqetësime dhe alarme në udhëheqjen e lartë të PKSH. Në muajin shtator, ambasadori sovjetik në Tiranë Çuvahini, zhvilloi disa takime radhazi me Enver Hoxhën, Koçi Xoxen dhe Nako Spirun. Ministri i Brendshëm Koçi Xoxe më 18 shtator 1946 i deklaroi diplomatit sovjetik: “Ne mendojmë, ta shfrytëzojmë këtë rast, me qëllim që të çlirohemi njëherë e mirë nga çdo e papritur”³⁸. Menjëherë pas kësaj ngjarjeje filloi një tjetër fushatë arrestimesh e dënimesh. Regjimi po vijonte me “gjuetinë e shtrigave” dhe, në fokus të persekutimit ishin, për fat të keq, intelektualët. Pas gjyqit dhe dënimeve të rënda të grupit të inxhinierëve të akuzuar për sabotimin e tharjes së Kënetës së Maliqit, radha u kishte ardhur deputetëve opozitarë.

Ata u akuzuan se në shkurt 1945 kishin formuar në Tiranë organizatën ilegale “Nacional Demokratike”, e cila gjatë muajve shkurt-prill u zgjerua dhe krijoi komitete e nënkomitete në disa qytete të Shqipërisë. Sipas raporteve

38. Hamit Kaba, Ethem Çeku, **Shqipëria dhe Kosova në Arkivat Ruse 1946-1962**, Prishtinë: Brezi 81, 2011, f. 35.

të Sigurimit të Shtetit, organizata u lidh edhe me Ballin Kombëtar. Qëllimi i organizatës ishte, sipas Sigurimit të Shtetit, që me ndihmën e anglo-amerikanëve të rrëzonin me dhunë pushtetin. Krahas deputetëve në organizatë u përfshinë dhe një sërë figurash e personalitete të tjera, si: Sulo Konjari, Ramazan Tabaku, Riza Alizoti, Foto Bala, Abdyl Kokoshi, Syrja Selfo, Mestan Ujaniku³⁹ e shumë të tjerë duke e çuar numrin e të arrestuarve në më shumë se 100 vetë. Shumica e deputetëve u akuzuan se kishin nxitur dhe organizuar Kryengritjes e Postribës. I akuzuari i parë ishte deputeti Riza Dani. Më 23 dhjetor, Kuvendi Popullor vendosi t'i heqë atij mandatin dhe imunitetin parlamentar. Bashkë me të, mandati iu hoq edhe 3 deputetëve të tjerë të Shkodrës Kol Prelës, Zef Haxhisë, ndërkohë që Hysni Pejës i ishte hequr më herët⁴⁰. Ndonëse u arrestua më herët se deputetët e tjerë, gjyqi ndaj Riza Danit dhe disa deputetëve të tjerë u zhvillua më vonë.

Më 15 maj 1947, Ministria e Punëve të Brendshme i kërkoi Presidiumit të Kuvendit Popullor që të hiqte imunitetet e deputetëve opozitarë Shefqet Beja, Kol Kuqali, Selaudin

39. Mestan Ujaniku ishte një nga drejtuesit kryesorë të formacioneve partizane në zonën e Skraparit. Gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore, ai kishte pasur më shumë se një herë përplasje me drejtuesit komunistë qoftë lokalë, qoftë dhe ata në qendër. Pavarësisht kësaj, si njeri me reputacion ai u përfshi në listat e Frontit për përfaqësues të Asamblesë Kushtetuese, por humbi kundrejt kandidatit tjetër Baba Fejzo Dervishit. Përfshirja e tij në dëshmon dhe njëherë për nevojën e udhëheqjes komuniste për të eliminuar të gjithë ata që nuk ishin nën kontrollin e strukturave drejtuese komuniste.

40. Në mars 1946, Kuvendi Popullor kishte votuar për heqjen e mandatit të Hysni Pejës, ndërkohë kishte refuzuar dorëheqjen për arsye shëndetësore të Zef Haxhisë, duke kërkuar që ai të paraqitej përpara Kuvendit dhe të tregonte arsyet e vërteta për dorëheqjen. Është fakt se deputeti i Shkodrës, Zef Haxhija nuk ka ndjekur asnjë nga seancat e Asamblesë Kushtetuese/Kuvendit Popullor gjatë gjithë vitit 1946, duke e bërë efektive dorëheqjen e tij.

Toto, Enver Sazani, Irfan Majuni, Faik Shehu, Sheh Karbunara, Kostandin Boshnjaku, Kadri Hoxha dhe Islam Radovicka⁴¹. Vendimi për këtë akt ishte marrë një ditë më parë në një mbledhje urgjente të Byrosë Politike të KQ të PKSH⁴². Heqja e imunitetit parlamentar në Kuvendin Popullor u krye pa debat të mirëfilltë parlamentar, në një situatë të tensionuar dhe aspak normale. Ndërkohë që një pjesë e tyre ishte arrestuar para heqjes së mandatit.

Për të provuar akuzat mbi ish-deputetët gjatë procesit të hetimit u përdorën akte të rënda dhune fizike e psikologjike. Deputeti Kol Kuçali, zëvendës drejtori i Bankës së Shqipërisë dhe baba i dy djemve dëshmorë të Luftës Antifashiste vdiq më 30 maj 1947, pas 10 ditë torturash, pa arritur të nënshkruajë deklaratën e kërkuar nga hetuesit. Të njëjtin fat pati edhe kunati i tij, Loni Adhami, i cili u torturua dhe vdiq më 10 qershor 1947. Torturat dhe ndëshkimet fizike ishin fenomene të zakonshme që u përdorën në hetuesi për të nxjerrë deponime shpesh të paracaktuara. Riza Dani dhe Kostandin Boshnjaku në asnjë rast nuk i pranuan akuzat e ngritura, ndërsa të tjerë si, Shefqet Beja i mohuan gjatë gjyqit pohimet që kishin bërë në hetuesi duke deklaruar se ato ishin marrë në kushte presioni fizik dhe psikologjik⁴³.

Deputetët, së bashku me personat e tjerë të arrestuar, si anëtarë të Organizatës Nacional-Demokratike, u gjyquan në

41. **AQSH**, F. 489, V. 1947, D. 60, fl. 1, Vendim i Presidiumit të Kuvendit Popullor për heqjen e imunitetit të 10 deputetëve, 15 maj 1947.

42. **AQSH**, F. 14/AP org. udh., V. 1946, D. 15, fl. 1, Nga procesverbali i mbledhjes së BP të KQ të PKSH, 14 maj 1947.

43. **AMB**, F. 1 hetimore-gjyqësore, V. 1946, D. 2224, fl. 17, Nga deponimet e Shefqet Bejës në gjyqin e Organizatës Nacional-Demokrate, 4 shtator 1947.

dy procese të veçanta gjyqësore, të mbiquajtura si grupi i Shefqet Bejës dhe ai i Riza Danit. Gjykimi për grupin e parë filloi më 4 shtator 1947⁴⁴, ndërsa për grupin e dytë më 31 dhjetor 1947⁴⁵. Të dyja gjyqet u zhvilluan në sallën e kinemasë “Nacional”, më pas “17 Nëntori” dhe të dyja transmetoheshin me altoparlantë për t’i dëgjuar populli i mbledhur në sheshet e qytetit. Në grupin e Shefqet Bejës u gjykuan 24 vetë, nga të cilët 16 u dënuan me vdekje (midis tyre deputetët Shefqet Beja, me varje, Irfan Majuni, Selaudin Toto, Enver Sazani, Sheh Ibrahim Karbunara me pushkatim), ndërsa në atë të Riza Danit u gjykuan 19 vetë, nga të cilët 7 me vdekje (midis tyre Riza Dani, Faik Shehu, Islam Radovicka). Njëkohësisht me këto dy procese zhvillohej edhe një tjetër me dyer të mbyllura, në të cilën gjykohej deputeti tjetër i Kuvendit Popullor, Kadri Hoxha.

Akt-akuzat në të dyja proceset kundër deputetëve dhe të akuzuarve të tjerë të formuluar dhe të mbrojtura përkatësisht nga zëvendësprokurori Josif Pashko dhe prokurori ushtarak, Nevzat Hazdendari bashkoheshin në këto pika të përbashkëta: ata akuzoheshin se kishin krijuar një grup ilegal që në muajin shkurt të vitit 1945; pak kohë pas krijimit të organizatës ilegale kishin krijuar një Komitet

44. **AMB**, F. 1 hetimore-gjyqësore, V. 1946, D. 2224, fl. 1, Procesverballi i gjyqit të Shefqet Bejës, Enver Sazanit, Sheh Ibrahim Karbunarës, Selaudin Totos, Irfan Majunit, Tefik Delliallisit, Hysen Shehut, Salim Kokalarit, Sulo Konjarit, Ramazan Tabakut, Gjovalin Vlashit, Rustem Sharrës, Xhevat Xhafës, Rram Markut, Beqir Çelës, Riza Alizotit, Sulo Klosit, Saggioti Paolo, Foto Balës, Abdyl Kokoshit, Shefki Minarollit, Pertef Karagjozit, Mehmet Prishtinës, Agathokli Xhitonit, 4 shtator 1947.

45. **AMB**, F. 1 hetimore-gjyqësore, V. 1946, D. 1393, fl. 3, Nga procesverballi i gjyqit të Konstandin Boshnjakut, Riza Danit, Faik Shehut, Islam Radovickës, Uan Filipit, Isuf Hysenbegasit, Surja Selfos, Demir Kallararit, Hilmi Hysit, Bexhet Shehut, Adem Belit, Hivzi Kokalarit, Mestan Ujanikut, Halit Gjelenës, Kamber Backa, Ibrahim Hasani, Arif Gjyli, Nexhmi Ballka, Hasan Reçit, 31 dhjetor 1947.

Qendror të saj, të kryesuar nga Shefqet Beja; grupi ishte i lidhur dhe kishte ndihmuar kriminelët e arratisur, me të cilët do të organizohej një kryengritje për të rrëzuar “pushtetin popullor”; grupi kishte qenë nxitësi dhe organizatori i Lëvizjes së Shkodrës (Kryengritja e Postribës) të datës 9 shtator 1946; të akuzuarit ishin lidhur me Misionin Amerikan në Shqipëri dhe se aspironin një demokraci perëndimore etj⁴⁶.

Ajo që mund të thuhet qartazi është se as në gjyq, e as më pas nuk janë gjetur ende të dhëna e fakte që vërtetojnë ekzistencën e një grupimi politik ilegal. Mënyra se si është ndërtuar grupi dhe tipologjia e të akuzuarve në të, të jep më shumë idenë e një montazhi politik për të futur në një “thes” individët problematikë për regjimin. Me gjithë dhunën e ushtruar gjatë hetuesisë, gjyqi nuk prodhoi fakte dhe prova në mbështetje të akuzave. Mungesa e profesionalizmit në përgatitjen e procesit shqetësoi dhe drejtuesit më të lartë komunistë. Nako Spiru gjatë takimit me sekretarin e parë të ambasadës së BRSS në Shqipëri shprehet se “si pasojë e dobësisë së punonjësve, të cilëve u është ngarkuar zhvillimi i këtij procesi, ky i fundit po merr një drejtim të pajustificuar”⁴⁷. Deponimet e nxjerra përmes torturave i

46. **AMB**, F. 1 hetimore-gjyqësore, V. 1946, D. 2224, fl. 1, Procesverbali i gjyqit të Shefqet Bejës, Enver Sazanit, Sheh Ibrahim Karbunarës, Selaudin Totos, Irfan Majunit, Tefik Delliallisit, Hysen Shehut, Salim Kokalarit, Sulo Konjarit, Ramazan Tabakut, Gjovalin Vlasiit, Rustem Sharrës, Xhevat Xhafës, Rram Markut, Beqir Çelës, Riza Alizotit, Sulo Klosit, Saggioti Paolo, Foto Balës, Abdyl Kokoshit, Shefki Minarollit, Pertef Karagjozit, Mehmet Prishtinës, Agathokli Xhitonit, 4 shtator 1947; si dhe **AMB**, F. 1 hetimore-gjyqësore, V. 1946, D. 1393, fl. 3, Nga procesverbali i gjyqit të Konstandin Boshnjakut, Riza Danit, Faik Shehut, Islam Radovickës, Uan Filipit, Isuf Hysenbegasit, Surja Selfos, Demir Kallarati, Hilmi Hysit, Bexhet Shehut, Adem Belit, Hivzi Kokalarit, Mestan Ujanikut, Halit Gjelenës, Kamber Backa, Ibrahim Hasani, Arif Gjyli, Nexhmi Ballka, Hasan Reçit, 31 dhjetor 1947.

47. Hamit Kaba, Ethem Çeku, **Shqipëria dhe Kosova në Arkivat Ruse 1946-1962**, Instituti i Historisë/ASA, Tiranë: Botimet Flamuri, 2017, f. 59-60.

bëjnë ato pak ose aspak të besueshme, pavarësisht se janë firmosur nga shumica e deputetëve. Përdorimi i termave kundërrevolucion, përmbysje e pushtetit me dhunë etj, nuk kanë qenë pjesë e artikulimit politik dhe e formimit të deputetëve të këtij fraksioni, me prirje e formim përgjithësisht perëndimor.

Gjithë procesi në vetvete është një pasqyrim i situatës së brendshme, por edhe zhvillimeve ndërkombëtare, me të cilat Shqipëria ishte e lidhur. Ndryshe nga vendet e tjera të Evropës Lindore e Qendrore nuk arriti të vendoste marrëdhënie diplomatike as me SHBA dhe as me Britaninë e Madhe. Misionet e tyre u larguan nga Shqipëria gjatë vjeshtës së vitit 1946, në një klimë armiqësore, akuzash e denigrimesh⁴⁸. Arrestimet, hetimet dhe dënimet e dhëna ndaj tyre ndodhën në një kohë të keqe, 'larg syve' të përfaqësuesve të qeverive britanike e amerikane, të larguar nga Shqipëria, përkatësisht në muajin prill dhe në nëntor të vitit 1946.

Mosvendosja e marrëdhënieve diplomatike të Shqipërisë me SHBA dhe Britaninë e Madhe, refuzimi i qeverive të tyre për të pranuar Shqipërinë në Kombet e Bashkuara (KB), në Këshillin e UNRRA-s, si dhe mbështetja e kërkesës së qeverisë greke për të paraqitur pretendimet e saj për Shqipërinë e jugut në Konferencën e Paqes apo në Këshillin e Ministrave të Jashtëm, i dhanë propagandës

48. Më 13 shkurt 1947, nënsekretari amerikan i Shtetit, Dean Acheson i shprehu ambasadorit jugosllav, të ngarkuar të "mbronte" edhe interesat e Shqipërisë në SHBA zemërimin për sjelljen e qeverisë shqiptare ndaj misionit amerikan, të larguar pak muaj më parë. "Shqiptarët kanë vepruar si të pacipë, ishte shprehur ai, ... ndërkohë që e dinin mirë se ishte e domosdoshme të sillleshin në mënyrë të civilizuar dhe të plotësonin detyrimet e tyre", në: **Foreign Relations of the United States (FRUS)**, Volume IV, **Eastern Europe; The Soviet Union**, Washington: 1972, pp. 760 -761.

së qeverisë shqiptare një “bonus”, që ajo do ta përdorte kundër kujt do qoftë që kundërshtonte programin e saj. Situata e krijuar e rëndoi më tej gjendjen e deputetëve të akuzuar. Dokumentacioni amerikan i njohur prej nesh, nuk e mbështet pretendimin e akuzës, se deputetët e këtij grupimi, që kishin si synim “përmbysjen me dhunë të regjimit në Shqipëri” dhe se ata mbështeteshin nga Misioni Amerikan në Tiranë. SHBA financuan 72% të programit të UNRRA-s, nga i cili përfitoi edhe Shqipëria⁴⁹. Makineritë dhe pajisjet kryesore që u përdorën për tharjen e kënetës së Maliqit u sollën po nga UNRRA. Në bisedën e lartpërmendur të Nako Spirut me Gagarinovin ai nuk do të hezitonte të pranonte se nuk kishte prova që i lidhnin të akuzuarit me SHBA: “... grupi i kriminelëve që ndodhet në bankën e të akuzuarve [gjyqi i deputetëve] ... nuk është grup agjentësh të shitur te anglo-amerikanët, por është një grup që ka zhvilluar luftë parimore politike kundër regjimit ekzistues”⁵⁰.

SHBA as nuk kishin pasur dhe as nuk kishin ndonjë interes ekonomik në Shqipëri, sikurse ndodhte me disa vende të Evropës Lindore. Ballkani, deri në mesin e vitit 1947, nuk konsiderohej zonë e interesit amerikan dhe aq më pak Shqipëria. Situata do të ndryshonte në vitin 1947, pas shpalljes së doktrinës Truman dhe planit Marshall. Dokumentacioni i njohur tregon se Shqipëria, me përjashtim të pak rasteve, mbeti në periferi të interesave amerikane gjatë gjithë periudhës së Luftës së Ftohtë.

49. Hamit Kaba, **UNRRA në Shqipëri 1944-1947**, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: Shkenca, 2000.

50. H. Kaba, E. Çeku, **Shqipëria dhe Kosova në Arkivat Ruse 1946-1962 ...**, f. 59-60.

Zhvillimet ndërkombëtare dhe impakti i tyre në Shqipëri

Masat represive të ndërmarra nga qeveritë komuniste në Shqipëri dhe në vendet e anës tjetër të 'perdes së hekurt', duke filluar nga viti 1947 e mbrapa duhen parë e studiuar si pjesë e Luftës së Ftohtë. Shqipëria u përfshi në grupimin e vendeve socialiste të Europës Lindore e Qendrore, të kryesuar nga Bashkimi Sovjetik - kundërshtarë e Bllokut të vendeve Perëndimore të udhëhequr nga SHBA. Lufta ndërmjet të Mëdhenjve dhe rreshtimi i Shqipërisë me lindjen komuniste pati pasoja mbi Shqipërinë.

Procese dhe akuza pak a shumë të ngjashme sikurse të Shqipërisë, ndodhën edhe në vendet e tjera komuniste të Europës në vitin 1947. Në Bullgari, Rumani, Hungari, Poloni e Çekosllovakia po zhbëhej pluralizmi tradicional, ndërsa disa parti e grupe opozitare u goditën, duke përdorur etiketën e mbështetjes nga amerikanët e britanikët. Në parlamentin bullgar u goditën elementët demokratë dhe u përjashtuan partitë jo komuniste, ndërsa zgjedhjet u kthyen në farsë. Asambleja Kombëtare e Bullgarisë nxori jashtë ligjit partinë e Bashkimit Agrar, ndërsa drejtuesin e saj Nikola Petrov e dënoi me vdekje më 23 shtator 1947⁵¹. Në këtë vit Bullgaria u përfshi në procesin e komunistizimit. Në vend vazhdonin arrestimet, internimet, burgimet dhe dënimet. Pas miratimit të kushtetutës së tipit sovjetik u riorganizua qeveria, nga e cila u dëbuan ministrat jo

51. **FRUS**, 1947, Volume IV, Eastern Europe; The Soviet Union, Washington: 1972, p.183.

komunistë, të cilët u zëvendësuan me disa të tjerë, të cilët ishin trajnuar në Moskë. Protestat e përfaqësuesve amerikanë e britanikë për dhunimin e vendimeve të Konferencës së Jaltës, drejtuar qeverive të vendeve të Evropës Lindore dhe qeverisë sovjetike, nuk patën efekt. Në korrik 1947 qeveria rumune arrestoi Maniu-n dhe udhëheqësit e tjerë të partisë fshatare⁵². Në Hungari partitë jo komuniste i kishte kapur paniku dhe frika. Partia Socialdemokrate dhe partia e pronarëve të vegjël po i prisnin me shqetësim zgjedhjet e ardhshme. Partia Socialdemokrate ishte më afër me Partinë Komuniste, por programi i saj ishte i tipit laburist. Si SHBA ashtu edhe Britania e Madhe u munduan të ruanin influencën e tyre mbi këto parti. Në korrik 1947, Partia e Pronarëve të vegjël kërkoi mbështetje financiare nga burime amerikane, për të përballuar fushatën e ardhshme elektorale. Përpjekje indirekte për të siguruar fonde nga SHBA u bënë edhe nga Partia Socialdemokrate dhe nga grupet e vogla opozitare. Por, me gjithë këmbënguljen e tyre ato nuk mundën të siguronin fondet e kërkuara. Ministri amerikan në Budapest do të bënte të njohur qëndrimin refuzues të SHBA: “politika e qeverisë amerikane nuk duhet të ndërhyjë në çështjet e brendshme të vendeve të tjera”⁵³. Modeli sovjetik u ndërtua edhe në Jugosllavi. “Qeveria, shkruante ambasadori amerikan në Beograd më 7 shtator 1947, ka eliminuar në mënyrë sistematike udhëheqësit e opozitës, por opozita e fshehtë ekziston në një masë të madhe ndërmjet fshatarësisë dhe ndërmjet elementëve katolikë romanë”⁵⁴. Ambasadori amerikan në Beograd, C. Cannon, duke analizuar

52. **FRUS**, 1947, po aty, p. 351.

53. **FRUS**, 1947, po aty, Chapin to Secretary of State, 29 korrik 1947, p. 351.

54. **FRUS**, 1947, po aty, p. 840.

me kujdes gjendjen e Jugosllavisë e parashikoi ndarjen e saj në një kohë të pacaktuar nga Bashkimi Sovjetik. “Nacionalizmi jugosllav mundet që një ditë të konfliktohet me sovjetikët, por kjo, - nënvizonte ai, - nuk ka gjasa të ndodhë tani, përderisa ruhet ndarja akute Lindje-Perëndim”⁵⁵. Jugosllavia në vitin 1947, kishte nënshkruar 17 marrëveshje tregtare, duke përfshirë edhe Britaninë e Madhe, Italinë e Turqinë. Ajo, sipas përcaktimit të Cannon ishte i vetmi shtet brenda Bllokut Komunist, i cili gëzonte liri relative ndërhyrjeje në punët e brendshme të saj nga BS⁵⁶.

Lufta e Ftohtë diktoi “lojën në grup”, të vendeve që bënin pjesë në Bllloqet përkatëse. Acarimi i marrëdhënieve u shoqërua me spastrime, dënime e “shtrëngime të radhëve” në vendet e Bllokut Komunist. Por, edhe në disa vende perëndimore si Franca e Italia, ministrat komunistë u përjashtuan nga qeveria, ndërsa CIA nuk hezitoi të mbështeste fort partitë e djathta për të fituar në zgjedhjet e ardhshme.⁵⁷ Lufta e Ftohtë nuk lejonte më hapësira për veprime të pavarura. Viti 1947 shënoi ndarjen përfundimtare të ish-aleatëve lindorë e perëndimorë të LDB dhe konturimin e dy Bllloqeve, në armiqësi me njeri-tjetrin. Këtij konturimi të botës së pasluftës nuk i shpëttoi as Shqipëria. Viktimë e saj u tij u bë edhe opozita shqiptare, e cila bashkëjeto me gjatë se të tjerët me komunistët.

Likuidimi i opozitës me aspirata perëndimore në vitin 1947-1948, do të pasohet më vonë me luftën brenda “llojit”- brenda radhëve të PKSH - PPSH. Proceset gjyqësore do të vazhdonin për dekada të tëra në Shqipëri.

55. FRUS, 1947, po aty, p. 842.

56. FRUS, 1947, po aty, p. 842.

57. Bridged Kendall, **The Cold War-A New Oral History of Life Between East and West**, London: Penguin Random House UK, 2017, pp. 37-39.

III. KUSH ISHIN TË GJYKUARIT?

1. Shefqet Beja

35 vjeç, tregtar, demokrat e patriot. Lindur në Durrës e banues në Tiranë. Pjesëmarrës aktiv në Lëvizjen Nacionalçlirimtare, ekonomist e financier i aftë, politikan i zoti. Kontribuoi tepër në nxjerrjen e gazetës “Bashkimi” që mbeti organi kryesor i Frontit Nacionalçlirimtar, n/president i këtij Fronti. Deputet i legjislaturës së parë. Dënohet me varje.



2. Sulo Ismail Klosi

36 vjeç, i ati, Ismail Klosi, hapi shkollën e parë shqipe në Mallakastër. Njëri nga të katër udhëheqësit e rezistencës kundër Haxhi Qamilit. Kapet tradhtisht në Berat e pushkatohet nga ky i fundit në moshën 27-vjegare. (Dëshmorët e Beratit 1915). I biri Suloja merr pjesë në Lëvizjen Antizogiste të Fierit (1935), kapet dhe dënohet me vdekje, dënim që muaj më vonë i kthehet në burgim të përjetshëm, pastaj lirohet me kusht që të



kthehet në Francë ku vazhdonte studimet. Diplomohet në Fakultetin e Gjeologjisë së Naftës në Strasburg dhe kthehet të punojë në zonat veriore të Shqipërisë. Gjatë luftës është i lidhur me forcat nacionaliste. Viti 1947 e gjen kryeinxhinier në Rubik. Dënohet me varje.

3. Riza Alizoti

37 vjeç, kryen filloren në Robert-Kolegjin e Stambollit. Vazhdon Teknikën e Fultcit në Tiranë, një vit kurs të lartë në Robert-Kolegj dhe studimet e larta në Oksford. Specializohet për shfrytëzimin e minierave në Strasburg, zotëron gjuhët anglisht, frëngjisht, turqisht. Punoi gjithë kohën në Kuçovë, para dhe mbas Çlirimit, për të vënë në shfrytëzim Kuçovën e rënë nga lufta. Dënohet me varje.



4. Sheh Ibrahim Karbunara

67 vjeç, një ndër ata patriote që me Ismail Qemalin firmosën Shpalljen e Pavarësisë (1912). Organizator dhe delegat i Kongresit të Lushnjës, anëtar i opozitës popullore dhe mik i Nolit, Gurakuqit e Currit. Si



antizogist arratiset më 1924, emigrant politik në Bari. Kthehet në teqenë e tij në Lushnje (1939) e si nacionalist ndihmon në bashkimin e forcave politike për të çliruar Shqipërinë. Deputet i legjislaturës së parë. Dënohet me pushkatim me gjithë të birin.

5. Dr. Enver Sazani

37 vjeç. Mbaron shkëlqyeshëm gjimnazin e Korçës. Kryen studimet e larta për mjekësi, dy vjet në Monpelie, pjesën tjetër në Lion. Specializohet dy vjet të tjera për patologji - radiologji. Anëtar i degës së Çlirimit Nacional të Shqiptarëve të Francës (Lyon -1933). Partizan i Çetës Krujë - Ishëm dhe i Çetës së Pezës. Drejtor i Spitalit Ushtarak. Deputet i legjislaturës së parë. Dënohet me pushkatim.



6. Salim Kokalari

50 vjeç. Tre kushërinj (Muntaz, Vesimi e Syrja Kokalari) të pushkatuar me 1944 pa gjyq (lufta e Tiranës), kushërira Musine Kokalari e dënuar me 20 vjet burgim, një vit para arrestimit të tij.



Dy vëllezërit i vdesin, njeri në burg (Ifziu)tjetri në internim (Isai). Salimi vetë kryen filloren në Gjirokastrë. Në vitin 1916 emigron në Amerikë. Në vitet 1920-1924 është pedagog në Liceun Francez të Gjirokastrës. Kryen dy vjet studime në Francë për pedagogji. Merr pjesë aktive në Lëvizjen e Vlorës (1932) dhe të Fierit (1935). Pas dështimit të kryengritjes dënohet me varje në litar. I falet jeta dhe bën disa kohe burg. Gjatë pushtimit italian mbështet Luftën Nacionalçlirimtare. Është anëtar i Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, dënohet me vdekje.

7. Selaudin Toto

33 vjeç. Vëlla i Ethem dhe Ismet Totos, të vrarë nga Zogu si kundërshtarë të tij. Kryen Shkollën Teknike të Fulcit shkëlqyeshëm. Kryen studimet e larta për matematikë-fizikë në Torino. Për aftësitë e veçanta ftohet nga profesori i tij, atomisti i famshëm



Enrico Fermi si bashkëpunëtor çka për motive familjare e refuzon. Kthehet në atdhe me diplomën “eccellente”. Internohet në 1941 si nacionalist kundër pushtuesit fashist, në Itali. Themelon Institutin e Shkencave Shqiptare dhe që kryetari i parë i këtij instituti. Shkroi i pari artikujt mbi energjinë atomike në Shqipëri. Përktheu me elegance “Njëzet vjet ngatërresa në Ballkan” të Miss Edith Durham. Deputet i legjislaturës së parë. Dënohet me pushkatim.

Do te vazhdonim kështu deri tek më i riu 22-vjegari Muhamet Prishtina që ndoshta do të flijohej në atë moshë të njomë vetëm e vetëm pse ishte djali i patriotit Jahja Prishtina, njëri nga anëtarët themelues të Komitetit për Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës dhe nip i kryetarit të këtij Komiteti, patriotit Rexhep Kadri Prishtina.

Të mos harrojmë dhe të përulemi para Paolo Sagiotit, 40 vjeç nga Gova e Italisë që, pasi kreu studimet ne Institutin Industrial, erdhi më 1931 për të punuar në AIPA e për të gjetur “pushkatimin” në Kuçovë.

Të tjerët ishin:

Irfan Majuni, 36 vjeç nga Dibra banues në Tiranë, nëpunës, i martuar me fëmijë. Deputet i legjislaturës së parë. Dënuar me vdekje.

Tefik Deliallisi, 37 vjeç nga Shijaku, banues në Durrës, mësues, i martuar me fëmijë. Dënuar me vdekje.

Hysen Shehu, 35 vjeç (djali i Sheh Karbunarës), i martuar e me fëmijë. Dënuar me vdekje.

Beqir Qela, 34 vjeç nga Durrësi, mësues, i martuar e me fëmijë. Dënuar me vdekje.

Abdyl Kokoshi, 37 vjeç nga Vlora, me arsim të lartë (fakultet drejtësie), banues në Tiranë, i martuar e me fëmijë. Dënuar me vdekje.

Pertef Karagjozi, 39 vjeç nga Gjirokastra, banues në Tiranë, nëpunës, i martuar e me fëmijë. Dënuar me vdekje.

Agathokli Xhitomi, 59 vjeç, nga Përmeti banues në Përmet, shkrues publik, i martuar e me fëmijë. Dënuar me vdekje.

Me burgim të përjetshëm u dënuan: Ramazan Tabaku 46 vjeç, telegrafist nga Tirana, Gjovalin Vlashi 24 vjeç, avokat nga Durrësi, Foto Bala 37 vjeç profesor nga Himara (banues në Korçë), Ram Marku 46 vjeç nga Shateli i Shijakut. Së fundi, me 20 vjet burgim: Rustem Sharra 40 vjeç, tregtar nga Kavaja, Xhevat Xhafa 34 vjeç, mësues nga Kavaja, Shefki Minarolli 44 vjeç hotelier nga Pogradeci (banues në Elbasan) dhe 15 vjet Sulo Konjari farmacist nga Gjirokastra.



Paolo Sagioti



Irfan Majuni



Tefik Deliallisi



Hysen Shehu



Beqir Çela



Pertef Karagiozi



Agathoikli Xhitomi



Rustem Sharra



Shefki Minarolli

Por në këtë inskenim kriminal u përfshinë edhe shumë intelektualë të tjerë që vdiqën gjatë torturave ose u vranë në hetuesi (Kolë Kuçali, Syrja Selfo etj.), që u dënuan ose u pushkatuan në gjyqin e dytë të këtij procesi (Kostë Boshnjaku, Riza Dani, etj.), apo në procese të mëparshme (Musine Kokalari, Gjergj Kokoshi Suat Asllani, Sami Qeribashi, Irfan Pustina, etj.)



Ramazan Tabaku



Gjovalin Vlashi



Foto Bala



Ram Marku



Hasan Kalaja



Llazar Papapostoli



Stefan Bumçi



Sulo Konjari




Muhamet Prishina



Gjyqi i Deputetëve, grupi i parë, Salla, kinema Nacional



Trupi Gjykses, kryetar Niko Çeta



**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHITËTIT**